


Milazim Krasniqi


Dhuna dhe qytetërimi
perëndimor
/Islam si fillim i historisë/





- Dr. Milazim Krasniqi
- Dhuna dhe qytetërimi perëndimor
- /Islami si fillim i historisë/





- Dr. Milazim Krasniqi
- Dhuna dhe qytetërimi perëndimor
- /Islam si fillim i historisë/



© LOGOS - A

2 0 0 6



S H K U P

P R I S H T I N Õ

T I R A N Õ

Përbajtja:

Parathënie.....	9
A ka gjasa rifillimi paqësor i historisë	13
Dhuna si “pjesë e brendshme” e qytetërimit perëndimor.....	33
Arti antik greko-romak si prodhues i ideve të dhunës.....	47
“Bukuria amerikane” si tragjedi jetësore	63
Toleranca e rreme ndaj të mundurve	69
Shtylla judeo-kristiane: “vëllezër sipas Krishtit”	79
Dhuna e inicuar nga idetë e rebeluara ndaj programit hyjnor.....	85
A po mbetet i pakuptuar mesazhi i Alsajmerit nga ata të cilëve u drejtohet?	99
Mesazhi i qytetërimeve të vdekura	113
Mesazhi i mumieve të Faraonit dhe të Leninit për ata që mendojnë	121
Mesazhi i kuajve të heronjve.....	129
Përfundime.....	133
Bibliografia:.....	137
Shënime biografike	139
Treguesi i emrave:	142

Parathënie

Falënderimet i takojnë Allahut të Gjithëmëshirshëm që, kahas të mirave të panumërtë me të cilat e ka begatuar jetën time, më ka mundësuar të merrem edhe me deformimet që janë shfaqur në historinë e njerëzimit dhe me përkushtimin që të sugjeroj zgjidhje për evitimin e pasojave më të rënda për fatet tona në të ardhmen, nëse nuk ndalet trendi i dhunës dhe i shkëputjes nga *programi hyjnor* me të cilin jemi të obliguar të jetojmë në këtë botë. Pa fryshtimin me burim islam kurrë nuk do të arrija të kuptoja esencën e deformimeve dhe nuk do të mund të propozoa zgjidhje të drejta.

Për ambientin e ngrohtë dhe motivues për punë, pa të cilin nuk do të ishte e mundur ta përballoja punën studimore, jam mirënjojës ndaj familjes sime.

Këtë studim kam filluar ta skicoj në vitin 2001, kur e kam lexuar një raport të Agjencisë Rojters, të transmetuar nga gazeta “Epoka e re”, për një konferencë të psikanalistëve dhe psikologëve, të cilët kishin ardhur në përfundim se dhuna është pjesë e brendshme e qytetërimit perëndimor dhe se ajo ishte edhe një faktor i progresit të këtij qytetërimi. Prej atëherë kam mbledhur shënimë, citate e dokumente, me shpresë se do të mund të jap një përgjigje më të logjikshme nga ajo e ekspertëve që i citojnë Rojtersi. Por, në shumësinë e punëve si shkrimitar, gazetar, mësimdhënës dhe si thirrës në Islam, sistemimi i materialeve për këtë studim më mbetej vazhdimisht “për

një kohë tjetër.” Megjithatë, duke i parë zhvillimet në skenën ndërkombëtare, ku dhuna po trashet gjithnjë e më shumë, u përqendrova në këtë punë i bindur se mund të jetë një kontribut për vetëdijesimin tonë përrreziqet që ka një botë e mbushur me dhunë dhe një qytetërim, i cili krahas vlerave të konsiderueshme që i ka krijuar gjatë historisë, është bërë edhe prodhuesi kryesor i dhunës. Bile, edhe përgjigja ndaj dhunës me një dhunë joproportionale, në fakt lë mbresën se kërkohet pretesti që dhuna që e shpreh fuqinë ushtarake, ekonomike, teknologjike dhe kulturore, të manifestohet për ta zgjruar ndikimin, intervenimin dhe dominimin e Perëndimit ndaj botës tjetër.

Por, do të mbeten të zhgënjer ata që do të provojnë me keqdashje që në këtë studim të gjejnë një qasje të patentuar antiperëndimore. Unë vetë kulturalisht i përkas në një pjesë të madhe këtij qytetërimi dhe nuk kam si t'i mohoj arritjet fantastike që ka kultura dhe qytetërimi perëndimor në shumë aspekte të artit dhe të shkencës, po edhe të shtetit social dhe të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Por, në këtë studim e kam fokusuar vetëm këtë segment që është gjenerator i dhunës, pra, jo tërë qytetërimin perëndimor me vlerat e tij. Mesazhi që del nga ky studim i cili është i hartuar me metodologjinë e idealizmit islam, është se duhet të ndodhë një transformim i natyrës së këtij qytetërimi në segmentin e tij të dhunshëm, nëse vërtet synohet arritja e paqes globale dhe shpëtimi i këtij qytetërimi nga krizat dhe nga katandisja.

Për bindjen time të plotë, kjo është e mundur vetëm nëse qytetërimi perëndimor, me shumësinë e vlerave të tij, arrin në pikën e një partneriteti me Islamin, përkatësisht nëse ndërlidhet me programin hyjnor, si të vetmin program unik, të qëndrueshëm dhe shpëtimtar për njerëzit e për njerëzimin në të dyja botët.

Nëse kjo thirrje do të shërbejë sado pak për reflektim, për të hequr dorë nga dhuna dhe për ta kuptuar të vërteten e programit hyjnor, do të jem i lumtur dhe falënderues ndaj Krijuesit që më ka dhënë mundësinë e thirrjes në pajtim, në paqe dhe në rrugën e vërtetë.

*Dr. Milazim Krasniqi
Prishtinë, tetor 2005*

A ka gjasa rifillimi paqësor i historisë

Qytetërimi perëndimor ka njojur zhvillim të jashtë-zakonshëm ekonomik, ushtarak, teknologjik, arsimor dhe kulturor, qysh nga shkëputja prej epokës së errët mesjetare, ku dogmat fetare ia zinin frymën mendimit dhe veprimit të bazuar në dije. Zhvillimi nuk ka qenë linear, po ka qenë me ngritje e me rënie, me ç'rast rëniet nga njëherë e kanë rrrezikuar edhe vetë qytetërimin siç ndodhi në Luftën e Parë Botërore dhe në Luftën e Dytë Botërore. Pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, me energjitet që u çliruan, qytetërimi perëndimor, i udhëhequr nga aleanca anglo-amerikane, u bë dominues në pjesën më të madhe të botës, duke shfaqur ambicjen agresive që modelin e vet ta imponojë si model global për tërë botën.

Partizanët që trumbetojnë fitoren përfundimtare të këtij qytetërimi, e kanë shpallur edhe “fundin e historisë” (Fukujama), duke konkluduar se këtej e tutje historia e njerëzimit do të jetë e kontrolluar dhe e programuar në bazë të sistemit të vlerave të Perëndimit. Si përplotësim të teorisë për fundin e historisë, u lansua edhe parashikimi për “përplasjen e qytetërimeve” (Hantington), duke krijuar një tabelë të konflikteve të mundshme, përkatësisht të konflikteve të sugjeruara, si përpjekje për ta imponuar dominimin e qytetërimit perëndimor mbi qytetërimet e tjera, veçmas të atyre që perceptohen me shkallë më të lartë të rrrezikut potencial, sikundër trajtohet Islami.

Po të shikohet tabela e intervenimeve dhe e agresioneve të sotme të Perëndimit, përftohet lehtësisht përfundimi se disa nga këto intervenime dhe agresione janë në bazë të sugjerimeve “teorike” për përplasjen e Perëndimit me Islamin, me synim që fitorja e Perëndimit të bëhet përfundimtare dhe që të shuhet gjasa e çfarëdo rivaliteti ndaj tij. E keqja e kësaj është se bëhet përpjekje e hapur që epërsia të imponohet dhe të mbahet me dhunë, me çka vazhdohet tradita e gjatë e natyrës së dhunshme të identitetit politik e kulturor të qytetërimit perëndimor.

Ja si duket një tabelë provizore e intervenimeve dhe agresioneve të viteve të fundit ndaj vendeve me popullsi muslimane: krijimi i shtetit të Timorit Lindor me procedura të shpejtuara ishte dhe mbetet në funksion të përsionit mbi Indonezinë – shtetin me numër më të madh të muslimanëve në botë. Kjo ndërhyrje, e bashkuar me etiketat për rrezikun e “fundamentalizmit islamik”, do të shërbejë si amortizuese e zhvillimit edhe ndaj Malezisë dhe Filipineve, ku gjithashtu ka tendosje në baza fetare.

Kashmiri vazhdimisht përdoret si vatër potenciale e konfliktit, me çka edhe Pakistani, si i vetmi shtet me shumicë muslimane që ka armë bërthamore, mbetet i gozhduar në një konflikt rajonal, për të mos dalë në skejnën botërore si një fuqi globale.

Lufta e Rúsise kundër Çeçenisë po ashtu e ka bllokuar atë shtet në një konflikt rajonal që, nga ana tjetër, ka për qëllim dobësimin maksimal të muslimanëve të Kaukazit.

Agresioni ushtarak i Shteteve të Bashkuara të Amerikës kundër Irakut është projekti më ambicioz në tërë këtë konflikt të instruktuar si konflikt i qytetërimeve, sepse ai synon futjen e kontrollit më të madh në botën arabe, ku krahas rr jitjes së mundësive të eksplotimit të naftës, rritet edhe ambicia për ridisenjimin gjeopolitik të tërë rajonit, duke e imponuar me dhunë modelin perën-

dimor të jetës e të organizimit shtetëror e kulturor, që në vete përmban koncepte deislamizuese. Filmi dokumentar “11/7” i Majkëll Murit e ka zbuluar një makineri të tërë të politikës dhe të industrisë, e cila ishte e interesuar ta sajonte pretekstin e agresionit ushtarak kundër Irakut. Sipas këtij dokumentari, insistimi i politikës zyrtare ishte që të krijohej një lidhje ndërmjet “sulmeve të 11 Shtatorit që i kishte bërë ‘Al-Kaida’ e Osama bin Ladenit dhe Irakut”, edhe pse realisht asnjë lidhje ndërmjet tyre kurrë nuk u provua. Kur nuk u arrit krijimi i një preteksti të tillë, atëherë u sajua gënjeshtra për armët e shkatërrimit masiv, të cilat gjoja i posedonte Iraku dhe, në bazë të kësaj akuze, filloi agresioni ushtarak që po vazhdon edhe sot në formën e pushtimit dhe të kërcënimit për tërë rajonin.

Sa i përket Ballkanit, intervenimi ka qenë më i sofistikuar. Në fillim është lejuar që agresioni ushtarak i Serbisë të realizojë spastrimin etnik dhe gjenocidin në Bosnjë e Hercegovinë mbi popullsinë muslimane, e pastaj ka pasuar intervenimi i NATO-s, për ta ndarë kështu Bosnjën në vija etnike (duke i mbajtur muslimanët të lidhur me kroatët në një federatë me ndikim të shtetit kroat). *De facto*, me Marrëveshjen e Dejtonit Bosnjë e Hercegovina në njérën anë është ndarë (me krijimin e Republika Sërpksa), ndërsa në anën tjetër është gjymtuar (me krijimin e një federate jofunksionale boshnjako-kroate) dhe, së fundmi, asaj i është imponuar një ombrellë e protektoratit ndërkombëtar (edhe pse formalisht është shtet i pavarur!). E njëjtë skemë ka ndodhur edhe në Kosovë, me ndryshim se këtu kohëzgjatja e konfliktit dhe numri i të vrarëve ka qenë më i vogël se në Bosnjë e Hercegovinë. Protektorati mbi Kosovën është i plotë dhe gjasat që Kosova të bëhet shtet i pavarur dhe sovran po zgjedhjen përditë e më shumë, gjithë në favor të krijimit të në kuazishteti, me “pavarësi të kushtëzuar”, me një entitet

serb të fuqishëm dhe paralizues në veri. Në fakt, Kosovës duket se i është rezervuar fati i një baze të madhe ushtarake të NATO-s për të cilën nuk ka nevojë të paguhet asnjë cent. Nuk është e pabesueshme se një pjesë e skenarit të këtillë mund të parashek edhe *deislamizimin* e këtyre territoreve, gjithë këtë nën arsyetimin se këto territore janë në Europë, ndërsa Europa është vetëm kristiane. Loja e nisur me ndërtimin e disa kishave katolike në disa fshatra të lënë dhe me vënien e gurthemelit të një katedraleje në Prishtinë, flet pikërisht në favor të këtyre tendencave.

Në këtë kontekst, futen edhe zhagjtjet prej disa deceniesh të anëtarësimit të Turqisë në Bashkimin European, përfshirë këtu edhe presionet e kohëve të fundit që i bëhen për njohjen e Qipros, gjë që ka si synim që atë ta mbajë sa më larg nga Europa, ashtu si pati deklaruar ish-kancelari gjerman, Helmut Kol se “Turqia muslimane nuk mund të bëhet pjesë e Europës kristiane”. Edhe pas hapjes formale të negociatave më 3 tetor 2005, burrësh-tetas europianë deklarojnë se Turqia mbetet larg anëtarësimit në Bashkimin European duke përmendur me këtë “së paku pesëmbëdhjetë vitet e ardhshme”. Ndërkaq presidenti i Francës, Zhak Shirak, ka shkuar edhe më larg në zbulimin e letrave, kur ka deklaruar se “Turqia duhet të bëjë ‘ndryshime kulturore’ për të dëshmuar vlerat që e lidhin me kontinentin evropian”. Është krejt e qartë se Shiraku me ndryshimin e vlerave kulturore, nënkupton largimin e Turqisë nga vlerat islame. Ministri i jashtëm i Turqisë, Abdullah Gyl, ka denoncuar këtë lojë kur ka deklaruar se “në kohën e Luftës së Ftohtë, ne ishim ata që i mbronim interesat e Europës, ndërsa matanë perdes së hekurt ishin shtetet që tash janë në Bashkimin European dhe që tash vendosin përfatim tonë”. Por, argumentet si ky, nuk i merr parasysh strategjia që proklamon rrezikun nga Islami dhe përplasjen e qytetëri-

meve dhe e cila synon t'i zgjidhë çështjet me imponim e me dhunë të hapur.

Këto projekte asfiksuese ndaj botës muslimane janë në zbatim, ndërsa çfarë pret në sirtarët e strategjive të fshehta, tash për tash nuk është e mundur të dihet. Ka indikacione se qeveria e Pekinit po i shton presionet ndaj muslimanëve në atë vend për ta zbehur kështu identitetin e tyre fetar. Por, kjo politikë e mbapshtë e qeverisë kineze, nëse eskalon edhe më tej, mund të shfrytëzohet nga Perëndimi për ta përdorur krizën si mjet presioni mbi Kinën, gjoja për ta përfshirë atë në koalicionin ndërkombëtar kundër fundamentalizmit islamik, e në anën tjetër për të shtypur sa të jetë e mundur më shumë identitetin islam në Azi.

Politika e intervenimeve dhe e agresioneve të Perëndimit ndaj muslimanëve dhe veçmas ndaj botës arabe, që në realitet po merr karakteristikat e një kryqëzate globale kundër Islamit, është e mbështetur mbi dy pretekste. I pari ka të bëjë me terrorizmin që u shfaq si një projekt me potenciale mjaft shkatërrimtare ndaj caqeve të Perëndimit. Sulmet terroriste të 11 shtatorit 2001 kundër Qendrës Tregtare në Nju-Jork ishin kulminacioni i një serie sulmesh kundër caqeve amerikane dhe aleatëve amerikanë në vende të ndryshme, përfshirë edhe vendet arabe. Pas sulmit me bombë në Qendrën Tregtare Botërore në vitin 1993, pasuan sulme terroriste në Somali, në Riad, pastaj në bazën ushtarake amerikane në Kobar të Arabisë Saudite, për të vazhduar me sulmet në Jemen, në Tanzani, në Keni etj. Organizatat militante dhe terroriste arabe që u krijuan në gjysmën e dytë të shekullit XX në fillim e kanë pasur objektiv luftën kundër regjimeve në shtetet arabo-islame, Egjipt, Siri, Irak, Iran, që konsideroheshin prej tyre si regjime kukulla në duart fuqive të huaja perëndimore. Shumë më vonë, në vitin

1998, u bë bashkimi i disa organizatave militante dhe terroriste, atëherë kur në krye të tyre doli Osama bin Ladeni, i njohur si veteran i luftës fitimtare të koalicionit të pashpallur afgano-amerikan në Afganistan. Pra, nëse “Al Kaida” konsiderohet organizata më reprezentuese e terroristëve, ajo nuk ka më shumë se shtatë vjet si organizatë me objektivat dhe me potencialet e tashme. Kjo do të thotë se terrorizmi i tipit binladenist është formë e re e organizimit militarist, sikundër që doktrina e tij është krejt e re në sfondin e vlerave të muslimanëve dhe në esencë e huaj për këto vlera.

Në proklamatën e Al Kaidës thuhet: “Ne u bëjmë thirrje muslimanëve për këtë: vrasja e amerikanëve dhe e aleatëve të tyre, civilë dhe ushtarakë, është detyrë e çdo muslimani që mund ta bëjë këtë në çdo vend që kjo është e mundur të realizohet”. Në bazë të kësaj proklamate, u lejua vrasja e çdokujt që është amerikan ose që ka të bëjë me amerikanët, pra edhe vrasja e muslimanëve. Terminologjia e përdorur në këtë citat (amerikanët dhe aleatët e tyre) tregon qartë se objktivi është politik, nacional dhe ideologjik, e jo fetar. Po të ishte fjala për platformë fetare, terminologjia mund të ishte tjetër, fjala vjen, të krishterët, protestantët, çifutët ose në rend të parë do të mund të viheshin në shenjestër politeistët/ateistët.

Shikuar nga pikëpamja e pastër fetare, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, janë njëri ndër shtetet, ku liritë fetare janë më të respektuara, duke përfshirë edhe liritë fetare të muslimanëve. Rivalitetet fetare nuk kanë të bëjnë me shtete e shtetas, po me qëndrimin që mbahet ndaj Zotit, ndaj engjëjve të tij, ndaj shpalljeve të Tij, ndaj të dërguarve të Tij dhe me qëndrimin që mbahet ndaj botës së amshueshme, ahiretit. Prandaj, është krejt e qartë se doktrina binladeniste nuk bazohet në këto aspekte fetare, por bazohet në argumente politike, nacionale dhe

ideologjike, që në instancë të fundit burimin e kanë te nacionalizmi panarab. Përndryshe është e pakonceptueshme që në emër të Islamit të bëhet thirrje për vrasjen joselektive të njerëzve vetëm pse janë amerikanë ose pse janë aleatë të amerikanëve. Islami e ndalon kategorikisht vrasjen e njerëzve, të gjitha krijesave njerëzore të pafajshme. Në Islam nuk konsiderohet fajtor njeriu nëse i përket një populli, sepse edhe popujt janë të krijuar nga vullneti i Zotit. Prandaj, paketimi i fajësisë për popuj të tërë, nuk ka të bëjë me mesazhin islam.

Sidoqoftë, kundërgoditja amerikane ndaj Al Kaidës në Afganistan shënoi përpjekjen për neutralizimin e potencialeve të saj terroriste dhe me këtë rast, së paku në fillim, pati një qasje joselektive në caqet e sulmuara, si edhe në terminologjinë e përdorur. Megjithatë, në rastin e Al Kaidës dhe të të gjitha organizatave terroriste, duhet pasur parasysh dy gjëra: e para, se këto organizata e kanë huazuar terrorizmin nga praktikat perëndimore dhe e kanë promovuar si aksion me qëllime politike. Zgjidhjet e padrejta territoriale e nationale që kanë lënë prapa vetes kolonizatorët anglezë e francezë, kanë shkaktuar shumë çrregullime në organizimin e fiseve dhe të popujve arabë. Nga taktikat e lehtësimit të sundimit të kolonizatorëve europianë janë shkatërruar lidhjet e natyrshme territoriale, fisnore e kulturore. Edhe krijimi i Izraelit në tokat arabe dhe në kundërshtim me vullnetin e popullsive që banonin në ato territore, ka provokuar një reagim që me kohë ka marrë format e kundërpërgjigjeve të dhunshme. Militarizimi ekstrem i Izraelit, i sponsorizuar nga Perëndimi, i ka detyruar lëvizjet e ndryshme arabe dhe palestinezë, që të përdorin edhe diversionet dhe aktet terroriste (si ajo në Lojërat Olimpike në Mynih), për ta tërhequr kështu vëmendjen e botës për padrejtësitë që ushtron ndaj tyre shteti izraelit, i cili

mban të pushtuar madje edhe xhaminë e shenjtë *el-Aksa*. Për shkak të këtyre punëve të mbrapshta që i kanë lënë prapa vetes kolonizatorët anglezë e francezë, është e qartë se baza ideologjike e organizatave terroriste, është nacionalizmi kombëtar palestinez e arab, sado që në këto raste mund të shfaqet i kamufluar me terminologji dhe me retorikë fetare. Udhëheqësit e organizatave të tilla shpeshherë kanë theksuar se do ta detyrojnë Amerikën të largohet nga tokat arabe dhe se do të përdorin çdo mjet që ta pengojnë eksplloatimin e pasurive të tyre nga ShBA-të (si pasuese e ish kolonizatorëve evropianë). Al Kaida dhe asnje organizatë tjeter nuk ka publikuar ndonjë platformë të detajuar, e cila do të mund të cilësohet si platformë e xihadit për fitoren e kauzës së Islamit në botën e sotme. Angazhimi i këtyre organizatave mbetet esencialisht brenda një platforme të nacionalizmit arab në rritje, që është ashpërsuar si përpjekje për ta çrrënjosur neokolonializmin që i karakterizon raportet e shteteve arabe me ShBA-të, po edhe me Europën, pas agresionit të fundit ushtarak kundër Irakut.

Për hir të së vërtetës duhet thënë se edhe vetë nacionalizmi arab, sikundër edhe terrorizmi, është produkt i ndikimeve ideologjike dhe politike të Perëndimit mbi popujt arabë, sepse Islami nuk e njeh nacionalizmin si ideologji. Edhe lufta arabo-izraelite e viteve të gjashtëdhjeta është e shkaktuar nga ideologjitet e kundërvëna nationale të hebrejve e të arabëve. Retorika militante e ish-presidentit të Egjiptit, Xhemal Abdunaser, po edhe e Hafëz Asadit, e Jaser Arafatit, e Zhorzh Habashit dhe e liderëve të tjerë arabë, që theksin e vinin te mosnjohja e të drejtës për ekzistencën e shtetit të Izraelit (e jo në luftën kundër judaizmit si fe monoteiste), ishte me burim dhe motivim nationalist arab. Aleancat e këtyre shteteve me Bashkimin Sovjetik nuk ka gjasa të shihen në dritën e

ndonjë motivimi islam të luftës së tyre kundër Izraelit dhe kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës e të Perëndimit në përgjithësi. Kur ata dështuan në përpjekjet e tyre për ta mundur Izraelin, sepse ishin të vendosura në baza ideologjike të gabueshme dhe me aleanca të gabueshme, në botën arabe shpërtheu pakënaqësi nga e cila lindën edhe organizata militante dhe terroriste. Njëra prej atyre organizatave arriti ta vriste nënshkruesin e marrëveshjes paqësore me Izraelin në Kemp Dejvid, Anvar es-Sadatin. Pra, organizatat terroriste që veprojnë në botën arabe dhe në vende të tjera me popullsi muslimane, edhe terrorizmin edhe nacionalizmin i kanë huazuar nga Perëndimi dhe e përdorin për ta çuar në vend kauzën kombëtare arabe në raport me Izraelin dhe me Amerikën. Si të tilla, pra, si prodhuese të dhunës e të kimeve kundër njerëzve të pafajshëm, ato kurrsesi nuk mund ta prezantojnë Islamin. Si pasojë e këtyre vepri-meve, Islami nuk është armik i Perëndimit. Por, përkundrazi, sikundër do të shihet më vonë, Islami është oferta më zemërgjerë dhe më shpëtimtare për të ardhmen e Perëndimit dhe të njerëzimit në përgjithësi.

Preteksti i dytë në të cilin mbështetet Perëndimi, veçmas Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në politikat e ndërhyrjeve në botën arabe, ka të bëjë me idenë e demokratizimit të atyre shteteve dhe të rajonit në përgjithësi. E vërteta është se shtetet arabe, shumica prej tyre, qeverisën nga regjime autarkike, tiranike dhe nga dinasti të trashëgueshme që nuk respektojnë standarde demokratike, përfshirë edhe zgjedhje të lira. Në shumicën e shteteve arabe nuk respektohen as liritë dhe të drejtat themelore të njeriut. Këto regjime nuk janë aspak të bazuara në Islam (Përkundrazi, ndjekja më e ashpër ndaj aktivistëve që angazhohen për rizgjimin islam është bërë dhe bëhet ende në disa shtete arabe, si në Egjipt, Algjeri,

Siri.) Dihet se në praktikat e shtetit islam, që nga koha e halifit të parë, ka qenë praktikë zgjedhja e halifes, e jo trashëgimia në bazë të farefisnisë ose të zgjedhjeve të manipuluara. Kështu e dimë nga historia se kur janë shtuar kërkesat që kriteri i farefisnisë të merrej për bazë për zgjedhjen e halifit dhe kur ka ndodhur kontestimi i legjitimitetit të halifit së zgjedhur, është paraqitur lufta vëllavrasëse shumë tragjike ndërmjet vetë muslimanëve, në të cilën siç dihet viktima kanë qenë edhe dy nga *halifët e drejtë*, Othmani dhe Aliu.¹

Regjimet aktuale në shtetet arabe do të duhej të ndryshonin, por kjo duhet të bëhet nga populli i shteteve respektive dhe me mjete adekuate politike, demokratike e islame, e jo me pushtimin e tyre, siç ndodhi me Irakun. Lufta kundër atyre regjimeve nuk duhet të përzihet me luftën kundër Islamit, sepse ato regjime nuk e prezantojnë Islamin.

Sado që fuqia ushtarake e Perëndimit sot për sot është e madhe dhe agresiviteti i tij ndaj Islamit është evident, rezultatet në planin moral, nuk janë në përpjesëtim me rezultatet ushtarake. Sot ShBA-të në shumicën e shteteve të botës, duke përfshirë edhe shtetet e bllokut perëndimor, përjetohen si një fuqi arrogante që paraqet një hegemoni kërcënuese. Edhe kundërthëniet me Europën në disa plane janë evidente. Por, ajo që është më rëndësi esenciale, kjo fuqi e pakonkurrencë e Perëndimit, nuk ka një fuqi integruese morale që do ta përhapte si mesazh për botën. Ideja e përhapjes së demokracisë, si dritë shpëtimtare dhe mbrojtja e të drejtave dhe të lirive të njeriut, në sfondin e intervenimeve dhe agresioneve të hapura kundër qytetërimeve të tjera, po konsumohet me shpejtësi. Demokracia është promovuar në shumë shtete

¹ Për këtë çështje konsultoje librin e Hasan Ejjubit *Katër kalifët e drejtë*, Furkan-ISM, Shkup, 2003.

të botës, përfshirë edhe shtetet e dikurshme totalitare dhe shtetet e botës muslimane, por ajo nuk i ka zgjidhur problemet e mëdha sociale, kulturore e morale të atyre shoqërive. Në anën tjetër, vetë shoqëritë që jetojnë nën ombrellën e shteteve perëndimore, kalojnë nëpër kriza të ndryshme, me ç'rast krizat morale përditë e më shumë po ua thithin energjitet e po ua marrin frymën. Edhe kësaj here, si shumë herë të tjera, në historinë e njerëzimit po vërtetohet se fuqia ushtarake dhe ekonomike, si dhe mirëqenia sociale nuk i zgjidhin problemet e shumta morale, shpirtërore e kulturore të njerëzve. Përkundrazi, nëse ajo fuqi është e bazuar në dhunë dhe nëse pretendon që ekspansionin ta shtrijë me dhunë, ajo rrezikon të futet në krizë dhe të katandiset në shpërbërje. Kjo u ka ndodhur disa qytetërimeve që njihen në histori dhe të tjerave për të cilat na njoftojnë *Shpalljet Hyjnore*.

Për këtë arsyе mendojmë se sot qytetërimi perëndimor është në një udhëkryq: a do të vazhdojë ta ushtrojë fuqinë e tij në mënyrë arrogante dhe agresive ndaj qytetërimeve të tjera, veçmas ndaj Islamit, me ambicien që t'i nënshtrojë, apo do të ndalet dhe do të pranojë partneritet me to e do të promovojë koekzistencë të mirëfilltë paqësore? Me dilemat e kësaj natyre merren intensivisht edhe dijetarët amerikanë dhe europianë, ndër të cilët edhe Zbigniev Brzhezhinski, mbasë njëra nga mendjet më vizionare të gjeopolitikës dhe të gjeostrategjisë në botën e sotme. Në studimin e tij *Zgjedhja: dominim global apo udhëheqje globale*, Brzhezhinski konkludon se “Besimi parësor në praktikat unilaterale të fuqisë sovrane, veçanërisht nëse shoqërohet nga një përkufizim egoist i kërcënimeve që po shfaqen, mund të sjellë vetizolim, paranojë të shtuar kombëtare dhe prekshmëri gjithnjë e më të madhe nga shpërndarja globale e virusit antiamerikan”.²

² Zbigniev Brzhezhinski, *Zgjedhja: dominim global apo udhëheqje globale*, përkthim i Adnan Kikës, dorëshkrim.

Për mendimin tonë, shansi më i madh i Perëndimit dhe veçmas i Shteteve të Bashkuara si superfuqi e vetme, do të jetë nëse zë e transformohet rrënjosht brenda programit të shpallur hyjnor që vlen për të gjithë njerëzit e për të gjitha kohët, duke shmangur kështu nga vetja fundamentalin politetist të trashëguar nga kultura antike greke dhe karakterin ateist që ka gjetur shtrirje të madhe në kohën tonë. Në këtë aspekt mendojmë se po të bashkohej qytetërimi perëndimor me Islamin, duke e përqafuar Islamin si botëkuptim për botën, e duke u transformuar kështu brenda vlerave universale të tij, ky qytetërim do të mund të zhvillohej në drejtim të duhur, duke hequr dorë nga dhuna e duke i bërë kështu një shërbim të madh njerëzimit.

Oferta e Islamit si shpallje është gjithmonë e hapur, sepse Islami është shpallje për tërë njerëzimin dhe për të gjitha kohërat. Pra, zgjidhja tjeter nga kjo që po e shohim si dhunë e një qytetërimi dhe si provokim konflikti me qytetërimet e tjera, me theks ndaj Islamit, është pranimi i Islamit si program universal i rregullimit të botës, me paqen globale të ndërtuar sipas udhëzimeve me burim hyjnor.

Ndërkaq, nëse vazhdon të mbahet orientimi i qytetërit perëndimor, ku dhuna është në themel të progresit të tij, me siguri që mund të ndodh ajo që u ka ndodhur edhe disa qytetërimeve të tjera, që janë zhdukur kur e kanë tepruar dhunën dhe kur nga fuqia që e kanë pasur, kanë filluar t'i sfidojnë edhe ligjet e Krijuesit të Botëve. Fatet e njësive të veçanta që inkuadrohen në rrjedhën e qytetërit perëndimor, që nga Greqia antike, Perandoria e Romës, Perandoria e Bizantit e deri te Rajhu i Tretë Gjerman, që janë shquar për përdorimin dhe prodhimin e dhunës, derisa janë katandisur edhe vetë nga dhuna, janë shembuj që vazhdimisht duhen pasur parasysh. Prandaj ky studim

është thirrje për të reflektuar, për t'i korrigjuar gabimet dhe për ta pranuar zgjidhjen e vetme shpëtimtare për gjithë botën dhe njerëzimin.

Hapi i parë në këtë drejtim do të duhej të ishte dallimi i qartë ndërmjet Islamit si Shpallje Hyjnore që i përket gjithë njerëzimit dhe praktikave të ndryshme të musulmanëve, kryesisht të arabëve, të cilët shumicën e veprimeve të tyre nuk i kanë të bazuara në Shpalljen Islame, ose e bëjnë instrumentalizimin e Islamit sipas nevojave politike, nationale dhe ideologjike. Në këtë mes, në rend të parë hyn dhuna e motivuar fetare ose etnike që nuk është aspak e bazuar në Kur'anin famëlartë. Vrasja e njeriut të pafajshëm në Islam është një krim i rëndë. Vrasësin e tillë Zoti e ka krahasuar me vrasjen e tërë njerëzimit:

Për këtë (shkak të atij krimi) Ne u shpallen (ligj) beni israileve se kush e mbyt një njeri (pa të drejtë), pa pasë mbytur ai ndonjë tjeter dhe pa pasë bërë ai ndonjë shkatërrim në tokë, atëherë (krimi i tij) është si t'i kishte mbytur gjithë njerëzit. E kush e nojall (bëhet shkak që të jetë ai gjallë) është si t'i kishte nojallur (shpëtar) të gjithë njerëzit. Atyre (beni israileve) u erdhën të dërguarit Tanë me argumente, mandej edhe pas këtij (vendimi) shumë prej tyre e taprojnë (kalojnë kufijtë në mbytje) në këtë tokë. (Kur'ani, el-Maide: 32).

Vrasja e besimtarit është krim për të cilin Zoti paralajmëron ndëshkim të rëndë:

Kush e mbyt një besimtar me qëllim, dënim i tij është xhehenemi, në të cilin do të jetë përgjithmonë. Allahu është i hidhëruar ndaj tij, e ka mallkuar dhe i ka përgatitur dënim të madh. (Kur'ani, en-Nisa': 93)

Siq shihet, Zoti qysh në rastin e beni israileve (hebrejnve) e ka kumtuar urdhrin se vrasja e njeriut të pafajshëm është e kategorizuar si krim ndaj tërë njerëzimit, ndërsa vrasja e besimtarit dhe njeriut të pafajshëm në

përgjithësi, dorasin e shpie pashmangshëm në humbje dhe ndëshkim të përjetshëm.

Nga aksiomat kur'anore është tërësisht e qartë se kushdo që vret njerëz të pafajshëm dhe besimtarë, nuk ka të bëjë fare me Islamin. Po ashtu është edhe me vetëvrasjen. Kushdo që me vetëvrasjen e vet shkakton edhe vdekjen e njerëzve të pafajshëm në ndërtesa, në metro, në rrugë e kudo tjetër, nuk është i udhëzuar në Islam dhe nuk është përfaqësues i muslimanëve, sepse vetëvrasja në Islam është kategorikisht e ndaluar:

Fatkeqësisht, dhuna që sot në emër të Islamit e bëjnë grupe të ndryshme guerile dhe terroriste është e motivuar si hakmarrje ndaj veprimeve të dhunshme të disa shteteve perëndimore dhe Izraelit. Por, kjo do të thotë se këto grupe guerile dhe terroriste kanë rënë në kurthin e kundërshtarëve të Islamit, të cilët dhunën e kanë në themel të qytetërimit të tyre. Përgjigja ndaj dhunës me dhunë joselektive, pra me dhunë që nuk u drejtohet autorëve konkretë të dhunës kundër muslimanëve, po kujdo që i përket një feje ose një qytetërimi tjetër, nuk është përgjigje në bazë të parimeve islame, po në bazë të praktikave të strategjive luftarake që janë përdorur në luftëra fetare, ideologjike, nationale e botërore për arritjen e objektivave në bazë të formulës makiaveliste “Qëllimi e arsyeton mjetin”. Duke qenë produkt i një kundërpërgjigjeje të dhunshme ndaj eksploatimit, neokolonializmit dhe neoimperializmit, terrorizmi nuk është dhe nuk mund të jetë kurrë pjesë përbërëse e vlerave të Islamit. Prandaj, terrorizmi mbetet i huaj për Islamin i cili është shpallje hyjnore.³ Ai mbetet i huaj për muslimanët që jetojnë në bazë të udhëzimeve kur'anore. Bota perëndimore mund ta kuptojë këtë të vërtetë nëse nuk e sheh

³ *Hutbeja lamtumirëse*, Zëri Islam, Prizren.

Islamini si armik global, por si një partner dhe, më tutje, si një ofertë gjithnjë të hapur për t'u korriguar e për t'u zhvilluar në një rrugë më paqësore e më njerëzore.

Islami si Shpallje Hyjnore nuk është pronë vetëm e arabëve dhe as vetëm e atyre që momentalisht janë muslimanë. Megjithatë tendenca për ta përvetësuar Islamini si pronë nationale dhe kulturore arabe ka pasur njëfarë zhvillimi. Kjo ka ndodhur pas mbylljes së ciklit të zgjerimit të Islamit dhe veçmas pas traumës së marrë në Spanjë. Kur janë eliminuar mundësitë e zgjerimit të mëtejshëm në bazë të programit universal të Islamit, është shfaqur përpjekja e arabëve për ta pasur njëfarë autorësie mbi interpretimin e Islamit dhe mbi format e organizimit të jetës sociale dhe kulturore të muslimanëve. Por, kjo mbyllje ka filluar të prodhojë ngecje dhe dekadencë që po zgjat tash e sa shekuj. Modeli i organizimit social dhe kulturor i arabëve nuk ka gjasa të jetë konkurrues dhe aq më pak model që u afrohet qytetërimeve të tjera si ofertë për pranimin e Islamit si shpallje universale. A mund të imagjinohet sot që shtete si Egjipti, Siria, Irani, Sudani, Algjeria, Jemeni, Jordania, a ndonjë tjetër, ku liritë politike, të drejtat e njeriut e madje edhe liritë e plota fetare, janë të dozuara, të bëhet model për botën perëndimore? Kjo është e pamundur. Atëherë pse të mos mendohet se është e mundur që pikërisht qytetërimi perëndimor, i transformuar nga pranimi i Islamit, të jetë bartës i një lulëzimi të ardhshëm edhe të Islamit ndër arabë dhe ndër muslimanët në tërësi? Aq më tepër që kjo pjesërisht ka ndodhur një herë në truallin europian, në sheku i XIX-XIV, kur rrezatimi i Islamit nga Andaluzia islame përfshiu kulturën europiane dhe i dha impulse të jashtëzakonshme zhvillimit të saj.⁴

⁴ Grup autorësh, *Arapsko-islamski uticaj na evropsku renesansu*, Sarajevë, 1987.

Kjo ka ndodhur edhe në truallin e sotëm turk, ku Islami e transformoi qytetërimin e rrëgjuar bizantin, duke e kombinuar me qytetërim islam, e duke përfthuar një simbiozë interesante, veçmas në arkitekturë.⁵

Ne besojmë se kjo është e mundur edhe sot, sepse Islami është pronë shpirtërore e të gjithë njerëzimit, e të gjitha qytetërimeve. Mjafton që të dëshirojnë të lartësohen në pajtim me Vullnetin Hyjnor, i cili obligon të adhurohet një Zot i vetëm dhe sakaq e gjejnë pajtimin e plotë me Islamin Hyjnor i cili është i aftë të sigurojë edhe paqen globale si *modus vivendi* shpëtimtar për tërë njerëzimin.

Në letrën dërguar papës së Romës, Muhamedit a.s., jepte këtë vision për bashkëjetesën e të gjithë njerëzimit: “Paqja qoftë mbi atë që i beson Allahut. Unë besoj se Isa/Jezusi (a.s), djali i Merjemes/Marisë ishte shpirt prej Allahut dhe fjalë e Tij. Allahu e futi atë në Merjemen e devotshme. Unë i besoj Allahut, të gjithë librave të Tij dhe urdhërave të Tij, të cilët m’i shpalli mua dhe të cilat Ai ia ka shpallur Ibrahimit (a.s), Ismailit (a.s), Is’hakut (a.s), Jakubit (a.s), dhe pasardhësve të tyre. Unë gjithash tu besoj në atë që Allahu i shpalli Musait (a.s), Isait (a.s) dhe pejgamberëve të tjera. Në fe dhe besim ne nuk bëjmë ndonjë dallim në pranimin e pejgamberëve. Ne jemi muslimanë (që do të thotë të nënshtuar ndaj Allahut). Paqja qoftë mbi atë që e pason udhëzimin”.⁶

Toni pajtues dhe unifikues i kësaj letre edhe sot paragjet bazën e pajtimit ndërmjet feve e njerëzve. Mjafton për

⁵ Shih: Mark Mazover, *Ballkani: Një histori e shkurtër*, Skanderbeg Books, Tiranë, 2003.

⁶ *Letrat e Muhamedit a.s.*, Logos-A, Shkup, 2004. Ata që duan ta njohin Islamin, duhet ta lexojnë Kur'anin dhe sunetin e Pejgamberit të fundit, Muhamedit, a.s., e të mos e vlerësojnë Islamin në bazë të komunikatave që i lëshojnë në internet grupet e ndryshme militante e terroriste, fjalët dhe veprimet e të cilëve nuk kanë të bëjnë me Islamin Hyjnor.

këtë vullneti i duhur i besimit në një Zot të vetëm, në shpalljet e shenjta dhe në të gjithë të dërguarit e Zotit. Për një objektiv të tillë fatlumë, që do të ishte zgjidhje e mirë për njerëzimin, qytetërimi perëndimor do të duhej të hiqte dorë nga sloganet propagandistike për “fundin e historisë” dhe për përplasjen e qytetërimeve si një epilog i pashmangshëm. Për më tepër, do të duhej të hiqte dorë nga strategjia sipas së cilës dhuna si mjet për arritjen e qëllimeve është legjitime. Dhe, më kryesorja, do të duhej të hiqte dorë nga botëkuptimi sipas të cilit dhuna është pjesë përbërëse e natyrës njerëzore dhe se dhuna është faktor i progresit të zhvillimit të këtij qytetërimi. Ne shohim një zhvillim vërtet impresiv të qytetërimit perëndimor, por duhet të shtrohet pyetja se në çfarë shkalle (akoma më të lartë) do të ishte ky qytetërim dhe mbarë njerëzimi pa dhunën e pushtimeve romake, pa kryqëzatat, pa masat çnjerëzore të inkvizicionit, pa masakrat e luftërave fetare për shkak të dogmave, pa kasaphanat e dy luftërave botërore që u zhvilluan në truallin europian, pa shkatërrimet e mëdha të revolucioneve e të luftërave rajonale që po i shterin fuqitë e Perëndimit dhe të mbarë botës.

Historia e gjatë e dhunës së bashkëdyzuar me qytetërimin perëndimor vërtet është e çuditshme. Në rastet kur shtetet e mbarsura nga idetë e këtij qytetërimi kanë poseduar fuqi të madhe, me anë pushtimesh, konvertimesh të dhunshme fetare, eksplotimesh të pasurive etj. e kanë zbruzur dhunën e tyre kundër popujve e qytetërimeve të tjera. Perandoria e Romës pati pushtuar shumë popuj, duke i ekspozuar pastaj ndaj romanizimit, përkatësisht shfrytyrimit etnik e kulturor me anë të fuqisë administrative, ushtarake dhe kulturore. Të njëjtën strategji e pati edhe Bizanti. Shtetet mesjetare europiane, si Spanja, praktikuan asimilimin e dhunshëm dhe dëbimin e popujve jokristianë. Ndërkaq në tokat e reja u prakti-

kua konvertimi i dhunshëm dhe asgjësimi fizik i atyre që refuzonin kryqin e krishterë. Janë të njoitura mizoritë e kolonizatorëve spanjollë, të cilët indianëve ua pritnin nga një këmbë që të mos iknin, ndërsa një numër të indianëve ua hidhnin qenve!⁷

Mirëpo, kur nuk kanë pasur fuqi të mjaftueshme për t'i vazhduar ekspansionet ose kur interesat e tyre koloniale e imperiale janë ndeshur, atëherë dhunën e kanë drejtuar kundër njëri-tjetrit, duke shkaktuar gjakderdhje të tmerrshme. Në të dyja rastet dhuna ka qenë në funksion të arritjes së objektivave sipas sloganit “Qëllimi arsyeton mjetin”.

Në kohën e sotme, të mundësive të frikshme që paraqesin armët e shkatërrimit në masë, të cilat përditë e më shumë po përhapen dhe një ditë mund të bien edhe në duart e forcave që nuk e kanë parasysh “ekuilibrin e frikës”, shtrohet pyetja: a mund të ndodhë ndarja e vërtetë, faktike, e dhunës nga vlerat e qytetërimit perëndimor? A mund të shndërrohet ky qytetërim i jashtëzakonshëm në lider të vërtetë të paqes globale, e jo të imponimit global?

Për të gjetur një përgjigje sa më të saktë, fillimisht duhet të bëhet hulumtimi i strukturës së dhunës së qytetërimit perëndimor (shtyllat greko-romake dhe judeo-kristiane) në ndërlidhje me pasojat që ka lënë prapa dhe që i prodhon edhe sot. Në këtë kontekst nëse analizohen me kujdes disa shtylla të vlerave kulturore dhe filozofike të këtij qytetërimi (koncepti jometafizik për vdekjen, vlerësimi i gabueshëm i mesazheve të qytetërimeve të zhdukura, viruset e fshehura, por të pashëruara plotësisht të racizmit, vlerësimi i gabueshëm i figurave historike dhe i simbolikave që lidhen me luftërat), mund të zbulojnë deformimin që ka sjellë në qytetërimin perëndimor botëkuptimi humanist i shkëputur tërësisht nga programi hyj-

⁷ Explorer 2, 20.IX.2005.

nor që Krijuesi Ynë e ka rezervuar për njeriun. Gjithë kjo do të ndihmonte në vetëdijesimin për nevojën e ndryshimit të botëkuptimit të njeriut perëndimor për dhunën si mjet legitim për arritjen e objektivave dhe për dhunën si pjesë përbërëse e progresit të këtij qytetërimi. Përveç kësaj, në rast se kjo do të ndriçohej si duhet, atëherë do të mund të hapej kapitulli i ri i historisë së këtij qytetërimi, si një fillim i historisë, pa dhunën si pjesë përbërëse të saj, e prej andej edhe për çrrënjosjen e akteve të dhunës edhe në të gjitha qytetërimet e tjera. Një botë pa dhunë, e njerëzve dhe e qytetëriimeve të ndryshme, që komunikojnë për t'u njojur më mirë mes vete, do të ishte shkalla më e lartë e vetërealizimit të njerëzimit në këtë botë, krejt kjo në pajtim me vullnetin e Krijuesit të Botëve, të sublimuar në Shpalljen Hyjnore përfundimtare, në Kur'anin famëlartë. Pra, po të shikohet nga ky aspekt, **historia ende e pret fillimin paqësor të saj.**

Për t'iu krijuar hapësira një historie të re, duhet të bëhet korrigimi i vlerave të deformuara kulturore e qytetëruese, të cilat i prodhojnë konceptet, idetë dhe vlerat e dhunës në gjirin e qytetërimit perëndimor. Këtu do t'i tematizojmë disa prej tyre.

Dhuna si “pjesë e brendshme” e qytetërimit perëndimor

Shoqata Gjermane e Psikanalizës, Psikosomatikës dhe Psikologjisë (GDPT) në vitin 2001 organizoi një konferencë me titull “Dhuna dhe qytetërimi”. Edhe pse nuk i kemi pasur në dispozicion të gjitha materialet dhe përfundimet e kësaj konference, nga ajo që ka qenë e mundur të mësohet nga mediat, është e qartë se konferenca ka nxjerrë disa konkluzione lidhur me raportin ndërmjet dhunës dhe qytetërimit perëndimor. Ndër këto konkluzione mund të llogaritet mendimi i Alf Gerlahut, i cili është cituar të ketë thënë se “dhuna nuk është një dukuri që vjen nga jashtë, që është e huaj dhe e pashpjegueshme, por duket se ajo është pjesë e brendshme dhe ndoshta me një rëndësi të madhe në qytetërimin tonë të orientuar drejt progresit”. Në këtë konkluzion të këtij eksperti lidhur me dhunën, dalin në shesh tri çështje: e para, dhuna nuk është një dukuri që vjen nga diçka jashtë njeriut, por është brenda tij, e dyta, ajo nuk është e pashpjegueshme, e treta, dhe më e rëndësishmja, ajo ka rëndësi për qytetërimin, i cili është i orientuar drejt përaparimit. Të tri konstatimet kanë defekte serioze.

Pohimi se dhuna është brenda njeriut është i bazuar në dy burime themelore: burimi i parë është ai kristian, sipas të cilit njeriu lind me fajin fillestar, që do të thotë se lind me të keqen brenda vetes së tij dhe se gjatë jetës

ai duhet të bëjë përpjekje që të pastrohet nga mëkati me të cilin është i lindur. Është e mundur që kjo ide, se ai është i lindur me mëkatin fillestar, të bëhet një nga burimet e natyrës së tij të dhunshme në jetën sociale. Ideja se në veten e vet njeriu e ka të vulosur mëkatin e paraardhësve të vet, Adamit dhe Evës, ia krijon atij perceptimin se është larg nga mundësia që të jetë i përkryer, që të jetë ideal. E nëse nuk mund të jetë ideal, atëherë nuk ka fort rëndësi nëse edhe bën gabime e mëkate të tjera gjatë jetës, sepse mëkati rezulton i ligjësuar si natyrë e tij dhe është aktiv brenda tij. Nëse e shohim sjelljen dhe natyrën e fëmijës derisa ai është i vogël dhe jashtë ndikimit të ideve se është i lindur me mëkatin fillestar të paraardhësve, shohim se fëmija aspiron të jetë ideal, i dashur për të gjithë, i dëshiruar nga të gjithë dhe i dhënë pas të gjithë njerëzve të rrëthit të vet. Bile edhe fakti që ai e dëshiron dhe e kërkon më së shumti praninë e nënës së tij, është provë e aspiratës së të qenit ideal, sepse dihet që pikërisht nëna është krijesa më e përkushtuar për fëmijën e saj të vogël. Përderisa nëna e di se dashuria e saj ndaj fëmijës së saj është e motivuar nga lidhja me burim fiziologjik dhe shpirtëror, fëmija këtë nuk e di në fazat e hershme të jetës së vet. Ai nuk e di as që ka lindur nga mitra e nënës së vet dhe se, sipas udhëzimeve hyjnore që vlejnë jo vetëm për të, por për të gjithë njerëzit, ndaj nënës ka përgjegjësi të shumta kur të rritet. Dashuria e diferençuar qartë e fëmijës për nënën e vet e ka burimin te pastërtia me të cilën lind krijesa njerëzore, e cila edhe në atë fazë të jetës, e ka të programuar në shpirtin e vet, që ta njohë atë që e ka më të afërt, atë që është më e përkushtuar ndaj tij. Po të lindte me mëkatin fillestar të paraardhësve, fëmija do të duhej ta kishte të programuar në veten e tij që ta urrente më së shumti atë që e ka lindur nga mitra e vet, nënën e tij, sepse do t'i rezultonte që

ajo është shkaktare e ardhjes së tij në këtë botë me barrën e mëkatit dhe me rrezikun që të ngarkohet gjatë jetës edhe më shumë mëkate dhe të përfundojë në humbje të plotë në të dy botët. Pra, në fazën e hershme të jetës nuk do të kishte prirjen e theksuar ndaj nënës, ndërsa në fazat e mëvonshme të jetës do të kishte prirjen që ta urrente më shumë atë që e ka sjellë në jetë. Por, nuk ndodh kështu. Fëmija mbetet i lidhur me nënën e vet edhe gjatë jetës së mëvonshme, me një dashuri më të theksuar se me këdo tjetër. Qoftë dhe vetëm ky fakt, e rrëzon tezën sipas së cilës e keqja është brenda njeriut, natyrë e tij ose pjesë thelbësore e natyrës së tij.

Në të vërtetë, mësimi që propagandon lindjen e njeriut me mëkatin fillestar dhe shoqëria që bazohet në programe të përfshirët vetëm nga interesat dhe nga idetë tokësore, shkakton edhe ftohjen dhe largimin e njerëzve nga njëri-tjetri, duke përfshirë këtu edhe ftohjen dhe largimin e fëmijëve nga prindërit e tyre. Por, kjo vjen më vonë, kur fëmija (fëmijët) i konsumon idetë sipas të cilave paraardhësit e kanë bërë mëkatin fillestar dhe ne jemi bartës të virusit të atij mëkati. Prej këtu, mund të aktivizohet ftohja edhe ndaj prindërve, pra edhe ndaj nënës. Por, kjo nuk është si rezultat i natyrës së dhunshme të fëmijës/fëmijëve, mirëpo është pasojë e mësimeve që u jepen atyre dhe e organizimit joadekuat të jetës sociale, ku vlerat e familjes janë të kërcënuara seriozisht. “Si shpjegohet që fëmijët janë aq të zgjuar e të rriturit aq budallenj? Me siguri që faji është i edukimit”, ka thënë me të drejtë Aleksandër Dyma.

Burimi i dytë për natyrën e dhunshme të njeriut, kësaj here është doktrinar. Ai është i lidhur me rezultatet e psikanalizës, të antropologjisë raciste, të sociologjisë pozitiviste dhe të një varg disiplinash të tjera humane dhe sociale, të cilat e hulumtojnë individin dhe shoqërinë,

duke u nisur nga gjendja e sotme e krizës së ideve dhe e krizës së organizimit të botës moderne, ose nga pasojat që shihen në njeriun dhe në njerëzimin si pasojë e deformimeve morale, kulturore e sociale që vijnë nga e kaluar. Megjithatë, në këto raste nuk arrihet të njihen shkaqet e vërteta të krizës dhe të deformimeve, ashtu që shkaqet sajohen në bazë të tezave të gatshme. Në këtë aspekt burimi më agresiv mbetet psikanaliza. Duke e sajuar idenë se e keqja është brenda njeriut dhe se njeriu udhëhiqet nga pjesa e pavetëdijshme e qenies së vet, psikanaliza e ka legalizuar konceptin që njeriu në esencë është i keq, keqbërës dhe keqdashës, si ndaj kolektivit ashtu edhe ndaj vetes së vet. Me këtë ide udhëheqëse, psikanaliza e ka “studiuar” njeriun nga ana e errët e tij, duke e paraqitur si krijesë të rrezikshme dhe të dhunshme, madje të pavlerë.

Nëse na lejohet këtu të bëjmë një digresion, atëherë do të konstatonim se psikanaliza në një aspekt në fakt ka të drejtë: nëse do të theksonte qartë se kjo qasje i dedikohet njeriut që është i shkëputur tërësisht nga programi hyjnor, njeriut që është zhveshur nga vlerat hyjnore me të cilat është i krijuar dhe i nxjerrë në këtë botë, njeriut që për ekzistencën e vet ka sajuar një program tërësisht materialist dhe ateist. Është shumë e vërtetë se ky tip njeriu dhe organizimi social, kultura dhe qytetërimi që përftohet prej tyre, janë të ulët dhe të rrezikshëm. Pra, në këtë aspekt, psikanaliza vetëm sa ka bërë analizën e mendjes dhe shpirtit të çrregulluar njerëzor dhe rezultatet e saj në këtë plan edhe mund të jenë evidente. Por, mësimi i psikanalizës nuk vlen për njeriun, për bashkësitetë dhe për njerëzimin, nëse njeriu është i lidhur me programin hyjnor, nësejeta e tij organizohet brenda standardeve të udhëzimeve hyjnore. Thënë krejt shkoqur, nëse njeriu ose bashkësia është në Islam, asnje rezultat i psi-

kanalizës nuk vlen. Në një rast të tillë, do të ishte krejt e qartë se e keqja nuk është brenda njeriut, por është jashtë njeriut. E keqja e provokon njeriun nga jashtë. E keqja është në formën e djallit të mallkuar, i cili është armiku i hapur i njeriut, me mandat të lejuar nga vetë Zoti, i cili ia la këtë mundësi, kur Iblisi tregoi mendjemadhësi dhe nuk pranoi të përkulej para njeriut. Atëherë Allahu shpalli se njeriu dhe djalli janë armiq të njëri-tjetrit deri në fund të ekzistencës në tokë. Por, njeriun e forcoi me udhëzimet e veta hyjnore, që të jetë i aftë ta përballojë me sukses të plotë provokimin e armikut të tij të hapur. Prandaj, lufta e njeriut me të keqen që e kërcënnon nga jashtë, nga armiku i tij i përhershëm, është edhe sprovë e cila i dallon të mirët nga të këqijtë, të udhëzuarit nga të paudhëzuarit, të dorëzuarit te Allahu nga mohuesit. Rrje-dhimisht, e keqja mund të futet brenda njeriut vetëm në rast se njeriu largohet nga udhëzimet e Krijuesit dhe e humb mbrojtjen e tij, në rast se e dëgjon djallin e mallkuar, në rast se i ndjek mësimet e tij të mbrapshta. Megjithatë, psikanaliza nuk ka pasur sukses të bëjë diferençimet e duhura në këtë aspekt. Ajo ka bërë përgjithësime, duke e paraqitur njeriun si qenie të dhunshme dhe me të keqen brenda vetes së tij. Ky interpretim do të ketë stimuluar pastaj edhe dhunën faktike të individëve e të strukturave sociale e shtetërore (a është rastësi që psikanaliza është bashkëmoshatare e kasaphanës botërore në Europë?!), ngase ka bërë relativizimin e aspektit moral të së keqes, duke i injoruar obligimet që i ka njeriu ndaj Hyjnise. Për mendimin tonë, nuk është e rastësishme që krahas lulëzimit të psikanalizës si shkencë që lansoi idenë se e keqja është brenda njeriut dhe se njeriu praktikisht nuk është përgjegjës për të keqen e vet, kanë lulëzuar edhe ideologjitetë më monstruoze që i ka njobur njerëzimi, sikundër janë racizmi, marksizmi, fashizmi

dhe nacional-socializmi. Sikundër përmendëm më lart, shoqëruese agresive të psikanalizës në prodhimin e perceptimit për njeriun si krijesë e keqe, e dhunshme dhe e pavlerë, kanë qenë edhe antropologja me ngjyrime raciste, e konstituuar në bazë të studimeve mbi disa fise e popuj primitivë në vendet e kolonizuara, sociologja pozitiviste, biologja darviniste dhe disa disiplina të tjera humane e sociale që studimet i kanë bazuara në teoritë aggressive materialiste. Duke nxjerrë përfundime se fiset dhe popujt primitivë të pushtuar janë në shkallë të ulët të zhvillimit dhe se do t'u duhen shekuj që ta arrijnë stadin e zhvillimit normal, këto teori kanë krijuar terren për legjitimimin e shfarosjes së fiseve dhe popujve, veçmas në Amerikën Veriore, në Amerikën Latine dhe në Australi. Kështu shkenca është vënë në shërbim të kolonializmit dhe të forcimit të një qytetërimi të dhunshëm.

Është e qartë se mësimet hyjnore dhe shkenca e vërtetë, e cila i ruan lidhjet me programin hyjnor, nuk mund të jenë prodhuese të ideve sipas të cilave njeriu rezulton të jetë krijesë e keqe, e dhunshme e lindur me faj filletar. Por, kur të ndodhë kjo, atëherë fjala është për devijimin e shpalljes dhe për instrumentalizimin e shkencës në shërbim të ideologjive, të shteteve dhe të qytetërimeve të dhunshme. Shpjegimet e bëra deri tash besojmë se e kanë hapur mundësinë që të diskutohet edhe teza tjetër e Alf Gerlahut, sipas së cilës dhuna “duket është pjesë e brendshme dhe ndoshta me një rëndësi të madhe në qytetërimin tonë të orientuar drejt progresit”. Fillimisht, duhet diskutuar se çka nënkuptohet në këtë kontekst me nocionin “progres”. Një qytetërim i orientuar drejt progresit, me dhunën si “pjesë të brendshme dhe ndoshta me rëndësi të madhe në qytetërimin tonë”, rezulton të mos jetë i bazuar në mësimet hyjnore, që e ndalojnë dhunën dhe e favorizojnë paqen, e ndalojnë ndarjen dhe e afir-

mojnë vëllazërinë ndërmjet njerëzve. Shpallja biblike dhe kur'anore thonë qartë se njerëzimi lindi nga Adami dhe Eva (Ademi dhe Hava), pra nga prindër të njëjtë. Njof-tojnë po ashtu se ndërmjet dy vellezërve, Kainit dhe Abelit (Kabilit dhe Habilit) lindi një zënkë që përfundoi me vëllavrasjen e parë. Por, ajo vrasje nuk u lejua nga Zoti, për çka Kibili do të jetë nga të ndëshkuarit, edhe pse ai u pendua. Pra, është e qartë se as në kuadër të bashkësisë njerëzore dhuna nuk u ligjësua dhe as nuk u sugjerua si bartëse e qytetërimit drejt progresit. Dhuna ndodhi kur Kibili provoi të shmanget nga obligimet që ishin caktim i Krijuesit (për martesën) dhe kur adhurimin ndaj Zotit e përjetoi si rivalitet me të vëllain, duke e shndërruar atë rivalitet në dhunë dhe në krim. Nga akti i dhunshëm që e bëri, Kibili nuk njoihu progres as në lumturinë e as në pasurinë e tij. Përkundrazi, ai e kuptoi gabimin që bëri, por me vonesë fatale. Prandaj, shembulli i njeriut të dhunshëm, vrasës, as në këtë rast nuk sugjerohet si pjesë e brendshme e organizimit social dhe e qytetërimit. Aq më pak e kërkimit dhe e gjetjes së mirëkuptimit nga Krijuesi.

Një ekspert tjetër, i quajtur Gerhard Armanski, është cituar të këtë thënë në atë konferencë se “asnjëherë njerëzimi nuk ka prodhuar një potencial të tillë shkatërrues, por në të njëjtën kohë, pikërisht për shkak të kësaj, edhe një qytetërim shumë të suksesshëm”. Më tutje ky ekspert e thotë edhe këtë: “Dhuna nuk qëndron në periferi të historisë europiane, por është një përbërës i rëndësishëm i kulturës perëndimore”.⁸

Edhe në konkluzionin kaq eksplicit të këtij eksperti, hetohen dy çështje esenciale: e para, potenciali shkatërrues si garant i suksesit të qytetërimit dhe, e dyta, dhuna

⁸ *Epoka e re*, Prishtinë, 2001.

është përbërës i rëndësishëm i kulturës perëndimore. Analiza ia vlen të niset nga konstatimi i fundit.

Kultura perëndimore (Hantingtoni do ta quante qytetërimi perëndimor), pra, e ka dhunën si një përbërës të vetin të rëndësishëm, sikundër thotë Gerhard Armanski. Nëse e ndjekim këtë pohim të Armanskut dhe bëjmë një shfletim të shpejtë të disa kapitujve të historisë dhe të kulturës perëndimore, mund të shohim se si është përfuar ajo ngjizje e kulturës dhe e historisë me dhunën dhe çfarë pasojash ka prodhuar ajo në një fazë kur dhuna është bërë shtresa më arrogante e sundimit dhe e tërë qytetërimit. Këtu po bëjmë vetëm një skicim krejt të vogël nga historia romake në shekullin I pas Isait a.s., sa për ta konkretizuar konstatimin, sepse po të ndaleshim në ngjarje dhe periudha historike që karakterizohen nga shtresa e dhunës, do të na duhej të shkruanim një libër më vete për këtë temë. Por, qëllimi ynë nuk është përshkrimi i historisë së dhunshme, që është ngjizur me kulturën dhe me qytetërimin perëndimor. Qëllimi ynë është të kuptojmë diçka më shumë për pasojat e këtij devijimi, për gjasat që mund të ketë korrigjim i këtij raporti dhe për pasojat që mund të rezultojnë nëse kjo nuk ndodh në të ardhmen.

Në Romën e lashtë, dhuna ka qenë njëra nga shtresat më të dukshme, jo vetëm të pushtetit ekspansionist, por edhe të vetë kulturës. Lufta në arenat e gladiatoriëve përcillej nga një numër i madh i shikuesve dhe përjetuhej si art. Brohoritjet e publikut, kur njëri nga gladiatorët ia priste gabzherrin tjetrit ose ia ngulte shpatën në zemër, ishin të fuqishme, pikërisht si brohoritjet e kohës sonë kur ndonjë këngëtar e finalizon performansën e tij me një përfitim bravuroz, ose kur shënohet ndonjë gol në një ndeshje të rëndësishme të futbollit. Dhuna e egër e arenave ishte prodhuese e kë-

naqësisë së publikut dhe madje njëri nga institucionet që e përcaktonte një sistem të vlerave pushtetore, kulturore të qytetërimit romak. Kjo dhunë e arenave do të ketë shërbyer për motivimin e ushtarëve në ekspeditat e shumta pushtuese, duke ua krijuar bindjen se vdekja e të tjerëve, atyre që ishin në shënjestër të pushtimeve romake, atyre që konsideroheshin popuj barbarë, ishte një art. Dhuna e ambalazhuar me këtë mbështjellës kulturor e qytetëruar, pati përfshirë hapësira të mëdha nën sundimin e Perandorisë Romake, e cila me anë të plaçkitjeve, të eksploatimit dhe të abuzimit me pushtetin, ishte bërë një perandori e fuqishme dhe shumë e begatshme. Dhuna si mjet pushtimi, e kombinuar me dhunën si art dhe si kulturë masive, u bë joselektive, deri në atë masë sa provoi të viktimizonte edhe të dërguarin e Zotit, Jezusin (Isain, a.s.). Por, nga teprimi i përdorimit të dhunës, e cila për një kohë u kishte dhënë suksese dhe rezultate të mëdha, filloi katandisja e asaj perandorie. Katandisja filloi nga brenda, që nga disfatat e rënda ushtarake në fushat e betejës, krizat e rënda morale, e deri te çrrëgullimi i mendjeve të sundimtarëve. Madje kjo e fundit, pra, çrrëgullimi mendor i disa perandorëve romakë në shekullin I pas Isait a.s., u paraqit si katandisje fatale e Perandorisë Romake. Ata që e konsiderojnë këtë teori si aksident, si rastësi e fatit historik, ose janë krejt naivë ose luajnë lojëra me teori materialiste, pa e loddhur mendjen që ta hulumtojnë të vërtetën. Dhuna e ushtruar ndaj popujve të shumtë që ishin pushtuar nga romakët, dhuna e shndërruar në art e në vlerë kulturore e qytetërimi romak, dhuna që ishte bërë aq gjithëpërfshirëse sa ishte drejtuar edhe ndaj të dërguarit të Zotit, Isait a.s., filloi ta merrte haraçin e saj kundër Perandorisë Romake e kundër qytetërimit romak, edhe si vetëndëshkim, por edhe si vetëshkatërrim. Fillimisht duhet përkujtuar se në vitin 9

pas Isait a.s. ushtria romake përjetoi njérën nga katastrofat më të mëdha ushtarake, nga e cila nuk u shërua kurrë plotësisht. Ushtria romake ishte nisur në ekspeditë pushtimi drejt tokave gjermane me synim që ta zgjeronte pushtimin edhe në pjesën kontinentale të kontinentit. Ishte ajo një ushtri e madhe, e armatosur mirë dhe e komanduar nga Variusi, një ushtarak që e kishte besimin e plotë të Augustit. Shtegtimi i kësaj ushtrie drejt tokave gjermane ishte i gjatë dhe i vështirë, por ajo ia arriti të hynte në brendësi të saj duke synuar pushtimin e plotë. Legionet romake u ndeshën me forcat gjermane që komandoreshin nga Arminiusi në një vend që quhet *Pylli i Tutebergut*. Aty legionet romake pësuan një katastrofë që nuk u kishte ndodhur deri atëherë në atë përmasë. Legionet 17, 18 e 19 u shkatërruan tërësisht. Në atë betejë u vranë më shumë se tridhjetë mijë ushtarë romakë. Historianët kanë numëruar një varg shkaqesh për disfatën e rëndë që përjetoi ushtria romake e komanduar nga Variusi. Ata kanë pohuar se në këtë epilog ka ndikuar fakti që gjermanët i donin pyjet, ndërsa romakët nuk gjenden shin mirë nëpër pyje, se shiu që kishte rënë i kishte rënduar armët romake, ndërsa armët e ushtarëve gjermanë nuk ishin rënduar, sepse ata kishin vetëm heshta prej druri, se gjermanët e njihnin mirë terrenin në tokat e veta, ndërsa ushtarët romakë nuk e njihnin terrenin, madje se komandanti Varius kishte përvoja në tokat palestinezë, por nuk kishte përvoja në pjesët kontinentale. Kjo e fundit, që ka të bëjë me Variusin, mund ta ketë një pjesë të së vërtetës. Kjo ka të bëjë me faktin që Variusi kishte ardhur nga Palestina, ku ushtria romake ishte identifikuar si ndëshkuese e Isait a.s. Tani po atij po i ngarkohej fatura e disfatës së ushtrisë romake, shumë larg nga toka e Palestinës, edhe pse ndëshkimi e kishte ndjekur dhe i kishte marrë shpagimin edhe atje. Ironia e

kësaj disfate është se vetë komandanti i ushtrive gjermane, Arminiusi, ishte ushtarë që ishte përgatitur në ushtrinë romake dhe e kishte edhe nënshtetësinë e Romës. Por, ai ishte rebeluar dhe i kishte shkaktuar Perandorisë një disfatë të jashtëzakonshme, e cila në histori quhet “Makthi i Cezarit”. Ç'është e vërteta, makthi i Cezarit dhe i tërë Perandorisë Romake, shkakun e kanë pasur më të thellë, por Arminiusi dhe ushtritë e tij gjermane, ishin shfaqur si shkaktar fizik i tij. Aq më tepër, disfata e Tutebergut, që u erdhi ushtrive romake në vitin 9 pas Isait a.s., shënoi fundin e ambicies romake për t'i pushtuar territoret veriore gjermane dhe europiane. Ironia finale është se pikërisht ushtritë që erdhën nga ato territore, ia dhanë goditjen vdekjeprurëse vetë Perandorisë Romake, por kjo ndodhi pesë shekuj më vonë. Sidoqoftë, mbetet fakt që tatëpjeta e Perandorisë Romake filloi menjëherë në epokën e re, e kjo nuk ka si të mos jetë e lidhur me veprimet e saj në Palestinë, përkatësisht me veprimet kundër Isait a.s., të dërguarit të Zotit.

Katastrofa ushtarake e legioneve romake në Pyllin e Tutebergut ishte vetëm fillimi i katastrofave që do të pasonin. Katastrofat më të mëdha, më shkatërrimtare, do të shfaqeshin në formën e çrregullimeve mendore të vetë perandorëve romakë. Në mendjet e tyre u kurdis çrregullimi, dhuna e krimi i llahtarshëm, i cili nuk mund të shpjegohet me nocionet e logjikës historike. Si mund ta shpjegojë një historian materialist sëmundjen e perandorit romak kur as gjendja ekonomike, as pozita e fuqisë së shtetit, as qëndrimi i të sunduarve, nuk jepin indikacione se kanë ndikuar në çrregullimin mendor të perandorit. Madje, këto dukuri sociale dhe politike mund të kenë qenë edhe më të konsoliduara në kohën kur perandorëve u shfaqet sëmundja sesa në kohën pararendëse, kur perandorët nuk kanë vuajtur nga sëmundje aq asgjësuese

edhe pse kanë pasur më shumë vështirësi në sundim. Fshehtësia e këtyre çrregullimeve mund të kuptohet me aplikimin e metodologjisë islame në studimin e historisë.

Disa nga këta perandorë romakë të shekullit I pas Isait a.s. ushtruan një dhunë të llahtarshme edhe ndaj vetë Romës e romakëve, sa ajo mbeti në histori si shembull barbarie e parrëfyeshme. Sundimi i ashpër i Tiberit (në vitet 14-37) u shqua me reprezalje në Afrikë, në Gali, në Traki, po edhe kundër robërve në vetë Italinë. Në fund Tiberi u vra vetë nga të vetët. Sundimi i dhunshëm në këtë shekull kulmoi me Kaligulën (që sundoi në vitet 41-54) i cili krahas mizorive që bëri kundër ilirëve, kundër britanikëve e kundër thrakasve, instaloi edhe një arrogancë të skajshme të sundimit në vetë selinë e Perandorisë së Romës. Kaligula shkoi aq larg në abuzimin me sundimin, saqë kalin e tij e shpalli senator të Romës. Por, edhe Kaligula ra viktimë e dhunës, e grushtshtetit. Ai u vra nga Pizoni, një i besuar i Tiberit.

Megjithatë kulminacioni i dhunës ndodhi nën sundimin e mëvonshëm të Neronit (Lucius Domitius Nero) i cili jetoi në vitet 37-68, ndërsa sundoi në vitet 54-68. Dhuna që e ushtronte Neroni ishte punë e çmendur. Ai i hipte të krishterët e hershëm nëpër shtylla të larta dhe i digje duke u krekosur se ashtu e ndriçonte qytetin nga flaka e përfuar nga djegia e trupave të besimtarëve të krishterë. Kjo egërsi kishte në themel përpjekjet për ta mbrojtur qytetërimin e përfuar nga dhuna, në të cilin politeizmi përbënte bazën ideologjike, ndërsa dhuna moralin politik dhe publik. Pra, edhe me këta pak shembuj të shekullit të parë te erës së re shihet se perandoria dhe qytetërimi i përfuar nga dhuna sado që arrijnë një zhvillim të jashtëzakonshëm, në një shkallë të arrogancës dhuna shndërrohet në kundërgoditje e brendshme dhe e

fillon shkatërrimin e pashmangshëm të Perandorisë dhe të qytetërimit të saj.

Historianët dhe studiuesit e tjerë të kohërave antike rrapaten të tregojnë shkëlqimin e Perandorisë së Romës, përhapjen e qytetërimit prej saj në mesin e popujve barbarë, por shumica prej tyre e injorojnë faktin se sa shkatërrime kanë bërë romakët në atë “mision qytetëruesh”, duke shkatërruar gjuhë, tradita e potenciale demografike të fiseve e popujve të shumtë në Europë e në Azi. Këta dijetarë e injorojnë faktin se paganizmi/politeizmi që e përhapi qytetërimi romak, bashkë me atë grek, kanë qenë shkaktarë të çrregullimit të raportit të njeriut me programin hyjnor, të besimit në një Zot të vetëm e të përhapjes së mesazhit se të gjithë njerëzit janë vëllezër. Prej këndej, ata kanë qenë shkaktarë të motivimit të dhunës, të krimtit e të shkatërrimeve të mëdha në tokë. Ata nuk duan të përpiken të gjejnë një përgjigje në pyetjen: si do të ishte fati i njerëzimit, edhe në planin e zhvillimit shpirtëror e edhe në atë material, po të mos ndodhnin ato pushtime shkatërrimtare dhe po të mos imponohej në ato përmasa politeizmi romak si armik i monoteizmit? Po të mbetej njerëzimi në binarët e zhvillimit sipas udhëzimeve që e kanë kumtuar ndër njerëz profetët e mëdhenj: Nuhu, Ibrahimi e Musai, fatet e tij do të ishin më fatlume në të gjitha planet dhe nuk do të ishte aspak e nevojshme “madhështia e qytetërimt romak” për zhvillimin dhe përparimin paqësor të popujve.

Dhuna e perandorëve romakë të shekullit të parë pas Isait, a.s., Tiberit, Severit, Kaligulës e Neronit, e kthyer kundër vetë shtetasve romakë dhe kundër institucioneve të vetë Perandorisë Romake, për atë që di të mendojë, është një argument i qartë se ajo ishte fatura e ndëshkimit për dhunën dhe krimet e bëra, duke përfshirë këtu me

theks tē posaçëm dhunën e rekomanduar prej administratës romake ndaj tē dërguarit tē Zotit, Isait a.s.

Ajeti 251 i kaptinës kur'anore el-Bekare mund tē jetë çelës pér ta kuptuar edhe çrregullimin mendor tē perandorëve romakë, madje jo vetëm tē tyre, por edhe tē disa sundimtarëve tē mëvonshëm:

“Dhe sikur Allahu tē mos i mbronte njerëzit me disa prej disa tē tjerëve, do tē shkatërrohej toka, po Allahu është bamirës i madh ndaj njerëzimit”.

Përvoja e hidhur e tragjedive tē Perandorisë së Romës në shekullin e parë, pas Isait a.s., tregon se dhuna e ushtruar, u kthye si bumerang ndaj Perandorisë dhe ndaj shtetasve tē saj, duke ia dhënë tatëpjetën fatale pikërisht asaj. Shembuj tē përafërt ka edhe në kohë tē tjera e në shtete dhe popuj tē tjerë, në rastet kur ata e kanë përdorë dhunën dhe kanë devijuar nga programi hyjnor. Prandaj dhuna nuk ka prodhuar dhe nuk prodhon progres afatgjatë e tē qëndrueshëm. Rrjedhimisht, mendimi i Gerghard Armanskit se “dhuna nuk qëndron në periferi tē historisë europiane, por është një përbërëse e rëndësishme e kulturës perëndimore”, mund tē pranohet, nëse interpretohet edhe si shkaktare e çrregullimeve, e deformimeve dhe e degradimeve serioze edhe tē vetë këtij qytetërimi. Ndërkaq dëmet që ua ka shkaktuar dhuna e tij kulturave dhe qytetërimeve tē tjera, që nga asimilimi i dhunshëm e deri te shfarosjet masive, janë tē pallogaritshme.

Arti antik greko-romak si prodhues i ideve të dhunës

Nëse e shohim këtë kulturë të dhunës, të transponuar në artet antike, veçmas në atë antik grek, që paraqet edhe tharmin e *renesancës europiane* e prej andej edhe të një pjesë vitale të identitetit perëndimor, po ashtu mbetemi të shokuar nga përjetësimi i dhunës dhe i makabritetit në to. Arti antik grek, që nga poemat homerike e deri te tragjeditë antike greke, është dëshmi artistike e një qytetërimi që është i mpleksur me dhunën dhe me politeizmin vulgar. Poemat homerike “Iliada” dhe “Odisea”⁹ janë poema të luftës së gjatë dhe shkatërrimtare që bënë akej-të kundër Trojës dhe të pasojave që e ndoqën pastaj Odiseun si ideator i shkatërrimit të Trojës. Përshkrimet e skenave të luftës, të përjetimeve të luftëtarëve, të viktimave që japid shpirt të mbytur në gjak, të shkatërrimeve që i shkakton lufta, janë tablotë më mbresëlënëse të artit homerik. Lufta për shkatërrimin e plotë të Trojës motivohet nga rrëmbimi i Helenës, gruas së Menelaut, nga Paridi, i biri i Priamit, mbretit të Trojës. Kjo tradhi bashkëshortore e Helenës dhe kjo pabesi e Paridit ndaj miqve, nxiti aleancën e madhe të shteteve greke, e cila përcillet me krimet të reja (flijimin e të bijës së Agamemnonit, Ifigjenisë, për t'i zbutur erërat e për ta

⁹ Homeri, *Iliada*, *Odisea*, Rilindja, Prishtinë.

lehtesar udhëtimin drejt Trojës). Iliada nuk e përshkruan tërë luftën e gjatë, por i fikson vetëm ngjarjet e pesëdhjetë ditëve fatale të saj, duke e fokusuar zemërimin e Akilit për poshtërimin që i bëhet nga Agamemnoni (atij ai ia merr robinjën Briseidë, që po ashtu e zbulon karakterin e shthurur të komandantëve akej.) Vrasja e Patroklit në dyluftim me Hektorin e rikthen në luftë Akilin dhe pastaj ndodh dyluftimi ndërmjet tij e Hektorit, që rezulton me vrasjen e këtij të fundit dhe tërheqjen e kufomës së tij zvarrë rrëth mureve të Trojës (sërisht kemi të bëjmë me praktikimin e gjymtimit të trupave të vdekur).

Sipas arkeologëve dhe historianëve që e kanë trajtuar luftën greko-trojane, ajo duket se ka ndodhur në shekullin XII para epokës sonë, ndërsa poemat homerike, *Iliada* dhe *Odisea* janë krijuar në shekujt VIII-VII, pra së paku katër shekuj pas asaj lufte. Në kontekstin e trajtimit tonë, kjo distancë e madhe kohore ndërmjet ngjarjeve dhe krijimit të veprave poetike, si dhe gjithë ajo mjegullnajë që rri pezull mbi “çështjen homerike”, mund të përdoret vetëm si argumentim për prirjen e pakuptueshme të pranimit jokritik të gjërave nga antika greko-romake, vetëm e vetëm për ta përligjur këtë kulturë si shtyllë të qytetërimit perëndimor. Në këtë mes lihen mënjanë faktet se këngët homerike u krijuan në ambientin e Azisë së Vogël, pra në Lindje, dhe se edhe Troja e zbuluar nuk është në truallin e Europës. Por, trajtimi i këtyre aspekteve të artit greko-romak, me gjithë ato shartime dhe falsifikime që janë bërë, do të na largonte nga tema që po shqyrtojmë, e cila ka të bëjë me dhunën dhe qytetërimin perëndimor. Sidoqoftë, mbetet fakt që *Iliada* dhe *Odisea* janë pranuar si tharmi i një letërsie të tërë europiane e cila me shekuj mëkohet nga temat e luftërave dhe të dhunës.

Kur dihet se cila është shkalla e politeizmit në poemat homerike *Iliada* dhe *Odisea*, bëhet edhe më e qartë se

ato kanë ndikuar në deformimin e botëkuptimit të shumë gjeneratave të njerëzve europianë lidhur me Zotin dhe me botën tjetër, jo vetëm në kohën antike po edhe në atë të *renesancës* dhe më vonë. Trillimi i emrave të zotave, ndarja e funksioneve për zotat sipas kërkeshave të njerëzve, ndarja e tyre në “zota të mirë” dhe në “zota të këqij”, pa dyshim se ka prodhuar herezi dhe deformim në botëkuptimin e njerëzve. Mjafton të sillet në kujtesë me këtë rast vetëm prejardhja dhe natyra e Zeusit, si “perëndia kryesore”, për të kuptuar rolin destruktiv të asaj mitologje antike. Sipas mitologjisë, Zeusi ishte perëndia i qiellit, i shiut, i vetëtimës e bubullimës dhe ishte kryesori në fronin e Olimpit. Babai i tij, Kroni, i kishte ngrënë fëmijët e tij (!!) nga frika se do ta vrisnin, por Zeusin e kishte shpëtuar e ëma, Rea, ndërsa kur u fuqizua, ky e dënoi babain e tij, Kronin, duke e hedhur në Tartar (pra kemi të bëjmë me atëvrasje!!!). Edhe nga ana morale, Zeusi përshkruhet si merakli femrash, sepse përveç gruas së tij, Herës, kishte marrëdhënie edhe me gra të tjera dhe kishte shumë fëmijë jashtë kurorës (!!) Konceptimi nga ana e grekëve antikë, politeistë të përhumbur, të zotit të tyre kryesor me gjithë ato kontradikta dhe të meta, mund të kuptohet më lehtë sesa pranimi i konceptimit të tillë nga europianët pas njëmijë e pesë-qind vjetëve të shpalljes hyjnore për një Zot të vetëm, që erdhi me anën e Jezu Krishtit (Isait a.s., të birit të Merjimes.) Ikja e europianëve nga konceptimi monoteist, qoftë dhe vetëm në aventurën artistike, që e mundëson letërsia antike, nuk është lehtë të kuptohet. E vërteta është se letërsia mesjetare e manastireve, ishte e pa fantazi, dogmatike dhe aspak inspiruese. Por, Europa e shekujve XII-XV, kishte kontakte të drejtpërdrejta me poezinë andaluziane dhe siciliane të muslimanëve dhe prej saj e thithë mushtin e një arti kulminat, si rezultat i së cilës

lindi poezia provansale dhe poezia e stilit të ri të ëmbël në Itali, e cila kulmoi me poezinë e Dante Aligierit dhe të Françesko Petrarkës. Atëherë, pse ajo prirje drejt poeziës antike greke-romake, me tematika të dhunës e të shkatërrimeve, në vend që të ndiqej poezia fine, me ide të forta metafizike e të afirmimit të ndjenjës së dashurisë njerëzore? Por, ka një përgjigje. Europa e periudhës së *humanizmit* dhe *renesancës*, po formësohej si Europë e jehonës që e kishin lënë pas vetes kryqëzatat (1095-1270) e luftërave të shenjta për çrrënjosjen e Islamit dhe për përhapjen e krishterimit në dhunë në të katër anët e botës. Kësaj Europe i duheshin më shumë fanfarat luftarake të letërsisë antike greke-romake (ku përligjej vrasja e fëmijëve, atëvrasja, mbretvrasja, masakrimi i kufomave, rrëmbimi i femrave, marrja e femrave si pre e luftës, dje-gia deri në themel e qyteteve të pushtuara, etj.) sesa stili fin e meditativ dhe ku madhërohej një Zot i vetëm, i poezisë së muslimanëve të Andaluzisë e të Sicilisë. Prandaj, afiniteti i *renesancës* europiane ndaj artit dhe kulturës antike greko-romake, përveç si ikje nga dogmat kishtare të rrënguara të letërsisë së manastireve, duhet të shihet edhe si një përligje e ekspansionit, e pushtimeve dhe e relativizimit moral për veprimet e njeriut europian. Pa e pasur në themel këtë kulturë me burim politeist, domethënë antihyjnor dhe këtë moral të lëkundur, domethënë të përshtatur ndaj devizës makiaveliste “Qëllimi arsyeton mjetin”, është e pakonceptueshme dhuna që e bënë spanjollët e krishterë kundër hebrenjve dhe muslimanëve, si edhe kolonizatorët e tjerë europianë në kontinentet e reja të pushtuara (dy Amerikat dhe Australia). Nëse titani Kron, babai i Zeusit i hante fëmijët e vet për të shpëtuar vetë dhe nëse kjo pranohet si vlerë kulturore, nuk ka barrierë morale për ta ndalur vrasjen e indianëve indigenë në kontinentet e pushtuara. Me anën e artit antik

grek-romak, ku dhuna ishte plotësisht e ligjshme dhe ku politeizmi ishte vlerë, ishte zbutur frika e njeriut europian jo vetëm nga Kisha, por edhe nga vetë Zoti. Ky trend i filluar në *renesancë* do të intensifikohet edhe në shekujt e mëvonshëm, duke prodhuar fashizmin, nazizmin, antisemitizmin dhe komunizmin, për çka do të flitet më vonë.

Mosnjohja e njëshmërisë së Zotit nga njerëzit e antikës greke, kjo e dokumentuar nga poemat homerike, na ndihmon të kuptojmë edhe shkakun themeltar të gjithë atyre fatkeqësive e tragjedive me të cilat ata njerëz janë ballafaquar, si rezultat i shkëputjes fatale nga lidhja me Krijuesin e Botëve dhe programin hyjnor që Ai e ka dërguar për njerëzit në të gjitha kohët. Historianët kanë dokumentuar se pas luftës kundër Trojës, shtetet greke u pllakosën nga shumë fatkeqësi dhe shumë banorë u detyruan të shpërndaleshin drejt Lindjes. Fatet e familjes së Artidëve, si simbol i fitores kundër Trojës, janë bërë më të njohura me tragjeditë e Eskilit. Edhe pse ata e fituan luftën e madhe, tragjeditë mbi fiset dhe popujt grekë qenë të mëdha dhe gati shfarosëse. A ishte ky ndëshkim për arrogancën dhe politeizmin ekstrem? Është e sigurt se edhe njerëzit e antikës do të kenë pasur mesazhe hyjnore, sepse Zoti i Botëve e thotë qartë:

Secili popull kishte të dërguarin e vet. (Kur'ani, Junus: 47)

Nga mitologja e tyre rezulton se ata kanë qenë robër të politeizmit dhe tërë jetën e tyre personale, sociale dhe shtetërore e kanë organizuar duke u përpjekur që t'i pajtojnë zotat e ndryshëm që i kanë imagjinuar dhe emërtuar vetë. Prandaj, duket se në favor të politeizmit vulgar i kanë injoruar mesazhet hyjnore, për çka edhe u kanë ardhur fatkeqësitë dhe padrejtësitë, gjithë kjo si posojë e punëve të tyre të mbrapshta, e jo nga Zoti:

Allahu nuk u bën asnjë të padrejtë njerëzve, por ata bëjnë të padrejtë vetes së tyre (Kur'ani, Junus: 44)

Edhe shumica e tragjedive antike greke të Eskilit, të Euripidit e të Sofoklit, janë tematizime të krimeve monstruese që i bëjnë anëtarët e familjes ndërmjet tyre. Në këtë aspekt nuk duhet ta shbangim nga vëmendja faktin se krimi në familjen e parë njerëzore ndodhi në familjen e babait të njerëzimit, Ademit, a.s., me ç'rast i biri i tij, Kibili, e vrau të vëllain e vet, Habilin. Kjo pra është një temë për të cilën na janë dhënë njoftime të qarta në Shpalljet Hyjnore. Por, ajo lloj epidemie e autorëve antikë për ta tematizuar këtë lloj krimi në familje, i zbulon rrugën e gabueshme, që i ka ndjekur kjo pjesë e njerëzimit, e legjitimuar si shoqëri antike greke. Lufta e egër për pushtet, hakmarrja joproportionale, xhelozia irracionale, sundimi i zhveshur nga drejtësia dhe nga mëshira, janë shenja të një shoqërie që është shkëputur nga programi hyjnor dhe që ka sajuar për veten e saj një mënyrë jetese plot vështirësi e plot tragjedi. Edhe ajo shumësi e simboleve poiteiste, e miteve, ajo përzierje e figurave tokësore me ato gjoja hyjnore, e tregojnë një kujtesë të çrregulluar, një ndërgjegje të çoroditur. Ankthi i njeriut për ta qetësuar ndërgjegjen e vet mbetet konstant, sepse ajo është natyra e tij e dhënë, ndërsa largimi nga programi hyjnor, e bën egon të dominojë, të bëhet e dhunshme e të mos ngopet me asgjë. Hakmarrja dhe krimi, në këtë kontekst, shfaqen si mjete për ta kënaqur egon e çrregulluar dhe për ta “qetësuar ndërgjegjen”, por me mjete që vetëm sa e shqetësojnë edhe më shumë. Po sjellim këtu si shembull tragjeditë e Eskilit. Në tragjedinë “Agamemnoni”, tematizohet kthimi i fitimtarit të luftës së Trojës në shtëpinë e vet, i cilit kthehet me një grua të marrë peng, Kasandrën, të palegalizuar me kurorë, që është treguese e çoroditjes morale, tradhtisë dhe e xhelozisë.

Në anën tjeter, e shoqja e Agamemnonit, Klitemnestra, në bashkëpunim me Egjistin, të birin e Atreut, e

ka përgatitur vrasjen e të shoqit. (Sa për plotësim të kuadrit tematik të kësaj tragjedie të Eskilit, të përkujtojmë këtu se Egjisti ishte i biri i Atreut, i cili të vëllait, Tiestit, babait të Agamemnonit, ia kishte vrarë fëmijët dhe ia kishte servuar si ushqim në një gosti, ndërsa Atreun e kishin vrarë për shkak të atij krimi të tmerrshëm që e kishte bërë ndaj fëmijëve të të vëllait, Tiestit.) Klitemnestra e vret Agamemnonin në banjë dhe pastaj bashkë me të dashurin e saj, Atreun, e shpallin vrasjen dhe e marrin sundimin në vend. (Sundimtarët e paligjshëm dhe të padrejtë, po ashtu janë në grupin e mëkatarëve.) Por, motivi kryesor i hakmarrjes së Klitemnestrës ndaj të shoqit, buron nga fakti se Agamemnoni e kishte fliuar të bijën e tyre, Ifigjeninë, për t'i qetësuar erërat e për t'i hapur rrugë udhëtimit pushtues drejt Trojës (Zoti e ka ndaluar vrasjen e fëmijëve nga prindërit e tyre, në të gjitha rrethanat, madje edhe në ato të varfërisë ekstreme, e lëre më të ambicieve pushtuese). Klitemnestra urdhëron që trupi i vrarë i Agamemnonit të copëtohet dhe të varroset pa asnjë nderim, duke ndaluar pjesëmarrjen në varrim edhe të bijës së vet, Elektrës (masakrimi i kufomave është po ashtu i ndaluar). Nga ky përshkrim i shkurtër i fabulës, shihet se tragjedia *Agamemnoni* e Eskilit vlon nga krimet që ndodhin brenda familjes, ku fillimi isht xhaxhai vret fëmijët e të vëllait dhe ia servon atij si ushqim (!!), pastaj i vëllai vret të vëllain, babai vret të bijën (Agamemnoni Ifigjeninë), gruaja me dashnorin e saj e vret dhe e masakron burrin (Klitemnestra Agamemnonin). Megjithatë, përveç krimit ordiner, këtu kemi të bëjmë edhe me mungesë të çdo lloj mëshire dhe etike (servimi i mishit të fëmijëve si ushqim, masakrimi i kufomës, varrimi pa ceremoni i mbretit, ndalimi i fëmijës që të marrë pjesë në varrimin e të atit, usurpimi i sundimit nga Klitemnestra dhe dashnori i saj). Nëse arti antik, duke përfshirë

edhe këtë tragjedi të Eskilit, mund të na shërbejë sado pak që të bëjmë një skanim të moralit dhe të idealeve të shoqërisë greke të kohës që tematizohet në këtë vepër, atëherë mund të kuptojmë se ajo shoqëri, sado e shpalur si demokraci, ka vuajtur nga çrregullimi i rëndë moral dhe nga vrasja e ndërgjegjes në vorbullat e krimeve e të hakmarrjeve serike. Në tragjedinë “Koeforët”, që është pjesa e dytë e trilogjisë, Eskili e vendos në skenë një ngjarje po ashtu tragjike, duke e sjellë te varri i Agamemonit të birin e arratisur, Orestin. Ai takohet aty me të motrën, Elektrën, dhe e bëjnë planin për vrasjen e nënës së tyre dhe të dashnorit të saj, që pastaj edhe e realizojnë. Por, pas krimit, Oresti e humb vetëdijen, nga se e ndjekin eriniet. Ndërkaq, në tragjedinë “Eumenidët” vihet në skenë ikja e Orestit nga eriniet, fshehja në tempullin e Apollonit, pastaj gjyqi që bëhet me pjesëmarrjen e “zotave”, njerëzve dhe erinieve dhe, në fund, është gjetja e një zgjidhjeje sipas të cilës eriniet pranojnë të banojnë në Atenë, ndërsa Oresti lirohet nga ndjekja e tyre.

Këtu mund të sillen edhe shembuj të tjerë, të tragjedive të Eskilit, të Sofokliut e të Euripidit, por të gjitha ato pak a shumë e kanë të njëjtin tematizim të dhunës, të krimeve, të padrejtësive të njerëzve e të “zotave” që në fakt ata i kanë trilluar në imaginatën e tyre.

Funksioni estetik i këtyre veprave antike greke, që e tematizojnë dhunën dhe krimin e llahtarshëm, është kërkuar dhe kërkohet edhe sot në të ashqutuajturin katarsis, pra në spastrimin e njeriut nga e keqja. Aristoteli në traktatin Poetika, i cili konsiderohet si gurthemel i mendimit teorik dhe estetik për dramaturgjinë, thotë se tragjedia “kryen pastrimin e pasioneve me anë të mëshirës e të frikës”. (Poetika, 62). Pra, tronditja emocionale dhe morale që e pëson shikuesi nga shfaqja, fjala vjen

nga tragjedia “Agamemnoni”, atë e frikëson dhe e bën të jetë më i mëshirshëm ndaj njerëzve.

Po të kishte efekte të këtilla tragjedia, ajo nëpër shekuj do të kishte njëfarë suksesi në rritjen e mëshirës ndërmjet njerëzve dhe në rritjen e frikës së tyre nga dhuna e nga krimi. Rrjedhimisht, me kalimin e kohës, ndikimi i saj do të ishte ndjerë në përftimin e një shoqërie më të mirë dhe të një bote pa krimë. Por, kjo nuk ka ndodhur aspak. Pëkundrazi, krimi i përmasave familjare me kalimin e shekujve është zgjeruar në bashkësi më të mëdha njerëzore dhe ka arritur deri në përmasat e shfatosjes në masë të njerëzve. Nga ky zhvillim në shoqërinë njerëzore, veçmas në atë perëndimore, në kohën kur modeli i tragjedive antike greke u riafirmua në kulturën evropiane të *renesancës*, më afér mendsh duket teza se kjo dhunë e luajtur në skena, ka ndikuar në nxitjen e ideve se krimi në jetë është disi si lojë në teatër. Shfaqjet e tilla kanë e hequr frikën e njeriut nga ballafaqimi me dhunën dhe e kanë bërë më të ashpër ndaj kundërshtarëve. Për ta provuar këtë tezë, duhen shumë analiza, por ne këtu po mjaftohemi vetëm me kontestimin e katarsisit të tragjedisë si gjoja një mjet për largimin e njeriut nga krimi dhe për rritjen e mëshirës së tij ndaj njerëzve. Fakti që frenimi i dhunës në qytetërimin perëndimor nuk ka ndodhur, na jep të drejtë të mendojmë kështu. Ndoshta mund të mendohet se shfaqja e modelit të artit antik në shekujt e mesjetës evropiane pati shkaqe të kryqëzuara: artistët synonin të çlirohen nën nga prangat e letërsisë dogmatike të manastireve dhe e gjetën modelin te arti antik grek, i cili ishte i çliruar nga dimensioni moral dhe hyjnor. Katarsisi që buronte prej saj, dukej i mjaftueshëm për ta qetësuar ndërgjegjen nga mëkatet dhe rebelemi. Ndërkaq Kisha nga ana e saj e sforcoi ndjekjen dhe

persekutimin e heretikëve, në përpjekje për ta mbrojtur kështu epërsinë e saj dhe të modeleve artistike kishtare.

Është paradoksale prirja se mund të përftohet një lidhje ndërmjet katarsisit dhe zëvëndësimit që ai i bën të rrëfyerit të personit te prifti. Edhe të rrëfyerit te prifti ka funksionin e pastrimit nga mëkatet dhe nga e keqja që e ka bërë personi. Njeriu besimtar që ka bërë vepra të liga, i ka mjaftuar të shkojë te prifti dhe t'i shlyejë mëkatet, paçka se ka marrë ndonjë ndëshkim të rastit, sepse ai përsëri ka vazhduar me të vjetrën. Forma më drastike e relativizimit të përgjegjësisë së individit përfajet e bëra ka ndodhur me indulgjencat që Kisha u jepte njerëzve që paguanin para përfaljen e mëkateve. Me këtë formë të pastrimit nga mëkatet, personi mund të bënte batërdi dhe të dilte i larë, duke paguar vetëm një shumë që i caktohej nga kisha. Dihet se kjo ishte njëra nga shkaqet që e nxitën rebelimin e Martin Luterit, që rezultoi edhe me lëvizjen e madhe reformuese të *reformacionit*. Në fakt katarsisi shkonte edhe më larg nga indulgjencat: ai e shkëpuste njeriun nga nevoja e të rrëfyerit para priftit. Mjaftonte të shihte një shfaqje dhe të pastrohej. Kështu paganizmi antik e kishte sfiduar shumë seriozisht autoritetin e Kishës mesjetare në një sferë të ndjeshme sikundër ishte arti. Prandaj, edhe rezultoi që kjo shtresë e qytetërimit antik të bëhej njëra nga pjesët përbërëse të qytetërimit perëndimor, duke e sfiduar fort shtresën judeo-kristiane të tij.

Tematika e dhunës dhe e krimeve monstruoze të ndodhura në familje dhe në bashkësinë njerëzore, nuk mbeti vetëm rivalizuese e letërsisë dhe e kulturës mesjetare të manastireve. Ajo është shartuar në mënyrë të fuqishme edhe në letërsinë dhe kulturën e *rilindjes europiane* dhe të klasicizmit, duke u bërë model qendror kulturor edhe për Europën moderne. Skenat e teatrove europiane

në shekujt XV-XIX kanë prodhuar emocione të mëdha nga dramat me përbajtje dhe ide të kësaj natyre. Ato janë gërshetuar me kulturën antike greke duke rezultuar me një simbiozë të çuditshme të ideve dhe përbajtjeve të një arti dhe kulture politeiste me idetë dhe përbajtjet e një kulture kristiane ose judeo-kristiane, sikundër e emerton dijetari Egdar Moren. Ky ndërkomunikim i artit dhe kulturës antike greko-romake me ndjeshmëritë estetike të *rilindjes* dhe të *klasicizmit*, ka ndihmuar në formësimin e identiteteve nacionale dhe kulturore në truallin europian. Përderisa *renesanca* ishte me ndikime përcaktuese në Itali dhe në Angli, në rastin e Francës mund të thuhet se klasicizmi është njëra nga shenjat legjitimuese të identitetit nacional dhe kulturor francez. Nga aspekti i tematizimit të dhunës e të krimeve, dramaturgja e *rilindjes europeane*, po ta marrim atë që është më kulminantja, nga dramaturgja e Shekspirit, është vazhduese e përbajtjeve të dramaturjisë antike greke. Fjala vjen, kryevepra e tij, Hamleti, e cila përshkon edhe sot me intensitet të parë të gjitha skenat e teatrove europiane dhe botërore, ka në themel një fabulë lidhur me krimin dhe shpagimin e krimit brenda familjes përkatësisht brenda oborrit mbretëtor në Danimarkë. Dy muaj pas vdekjes së mbretit, fillon e shfaqet fantazma e mbretit të vdekur. Rojet e lajmërojnë Hamletin, të birin e mbretit, andaj ai shkon në roje me ta. Këtu shfaqet fantazma e të atit i cili i thotë se atë e ka vrarë i vëllai, Klaudije, me të cilin e ëma e Hamletit është martuar menjëherë pas vdekjes së mbretit (Ngjashmëritë ndërmjet Agamemnonit të Eskilit dhe Hamletit të Shekspirit në këtë pikë janë evidente). Mbreti i vrarë i thotë të birit se duhet të hakmerret. (Hakmarrja e Orestit si udhërrëfuyese e hakmarrjes së Hamletit). Pas shumë dilemash e peripecish, duke e vrarë pa qëllim Pollonin prapa perdeve dhe Laertin në

dyluftim, Hamleti e vret edhe uzurpatorin e kurorës, por vdes edhe vetë nga plaga e marrë në dyluftim me Laertin, të vëllain e Ofelisë fatkeqe. Ne vetëm mund të imajinojmë se sa emocione ka prodhuar kjo tragjedi e Shekspirit dhe sa vazhdon të prodhojë edhe sot, duke e tematizuar vëllavrasjen/mbretvrasjen, usurpimin e sundimit, tradhtinë bashkëshortore, hakmarrjen dhe dështimin e dashurisë. Se sa ndikojnë të gjitha këto ide dhe përbajtje në relativizimin moral të njerëzve e të shoqërive, nuk do të merret vesh kurrë nga njerëzit. Natyrisht, që Hamleti nuk është një vepër e vetmuar në këtë plan. Edhe dramat e tjera të Shekspirit, si *Rikardi III*, *Jul Cezari*, *Othello*, *Tregtari i Venedikut*, *Mbreti Lir*, *Makbethi*, etj., po ashtu e tematizojnë dhunën, luftën për pushtet, hakmarrjen, tradhtinë, usurpimin e pushtetit e forma të tjera të dhunshme të jetës së njeriut.

Po ashtu nuk mund të dihet saktësisht se sa i ka motivuar ky art i *renesancës* ekspeditat pushtuese angleze anekënd botës. Por, gjithë ajo dhunë që e ka prodhuar historia angleze e britanike, nuk mund të jetë tërësisht e shkëputur nga arti shekspirian, përkatësisht nga idetë dhe përbajtjet e tragjedive të tij. Së paku në planin moral, por pse jo edhe në atë politik. Edhe dramaturgja e klasicizmit francez, po t'i marrim autorët më kulminant, Rasinin dhe Kornejin, e ka po ashtu prirjen për tematizimin e krimit dhe të heroizmit që buron nga luftërat dhe nga dhuna. Bile, atdhedashurisë si një vetëdije supreme, ata ia nënshtrojnë edhe fatin personal dhe lumturinë personale, dashurinë dhe miqësinë. Kur është në pyetje kauza e atdheut, të gjithë duhet të përkulen, të bien në gjunjë, të dorëzohen. Po e kujtojmë këtu vetëm tragjedinë e Kornejit, *Horaci*, vetëm si një ilustrim të vogël të kësaj çështjeje. Në luftën ndërmjet Romës dhe Albës, shkatërrrohet martesa e Horacit me Sabinën, shkatërrro-

het dashuria e Kuriacit me Kamilën, në emër të luftës për atdheun shkatërrohen miqësitë dhe vlerat njerëzore. Arti klasicist, duke e glorifikuar heroizmin e individit dhe atdheun si zëvendësim të hyjnores ia ka hapur rrugën edhe laicizimit të botëkuptimit të njeriut francez e europian, me çka duket se ka marrë pjesë edhe në hapjen e shtegut të revolucionit të Komunës së Parisit. Vërtet, kur analizohet gjithë ajo batërdi e Komunës së Parisit, gjithë ajo gjakderdhje në emër të kauzës së atdheut, pastaj qërimi “heroik” i hesapeve ndërmjet vetë protagonistëve të *revolucionit* (Dantonit, Robespierit, Fushesë, etj), duket se në prapavijë të atyre tragjedive reale njerëzore, ndihet frymëzimi nga veprat e tragjikëve klasicistë francezë.

Megjithatë, edhe formacionet e mëvonshme stilistike (romantizmi europian në një pjesë të tij paraqet njëfarë përjashtimi, për shkak të stilit individual dhe tematikës zotëruese të ikjes nga realiteti aktual, politik, nacional e doktrinar), vazhdimisht e kanë ruajtur orientimin për tematizimin e dhunës për afirmimin e personazhit negativ ne letërsi, në teatër dhe në kinematografi. Veprat e Dostoevskit ndoshta paraqesin majat më të larta të tematizimit të krimit e të dhunës, të çrregullimeve psikologjike e mendore të njeriut dhe të raporteve të çrregulluara ndërmjet individit e bashkësisë. Kjo tematikë është përpunuar e detajizuar edhe nga shumë autorë të tjera të letërsive moderne kombëtare, duke e bërë nganjëherë letërsinë edhe objekt të psikanalizës. *Tregimet e Kolimës* të Shallamovit, bile shkojnë edhe më larg, e zbulojnë egërsinë e njeriut/të burgosurit në luftën e tij për të mbijetuar, që shkon përtej asaj që një mendje normale mund ta imagjinojë. Natyrisht, proza e Shallamovit, si edhe i tërë arti me parashenjë të tillë, e tematizon një realitet të dhunshëm e tragjik, ku dhuna e shtetit ndaj individit e ndaj bashkësisë arrin në përmasat e shfarosjes. Por, në fazën

tjetër, arti që e tematizon aq ashpërsisht dhunën, në gjenaratat e mëvonshme edhe vetë ndikon në relativizimin e normave morale dhe në legjitimimin e sjelljeve të dhunshme ose në shfaqjen e pasojave nga mesazhi i dhunës që e bart në vete.

Në këtë kontekst mjafton të përmendet kinemografia e sotme e Hollivudit, e cila prodhon numër jashtëzakonisht të madh të filmave që janë shumë të dhunshëm dhe nuk janë pa efekte mbi shikuesit e tyre. Për një numërim të filmave të dhunshëm që prodhohen sot, do të duhej një libër më vete, por nga të fundit që është dalluar për vizuelizimin e brutalitetit në përmasa të frikshme, ka qenë edhe filmi “Mundimet e Krishtit” i Mel Gibsonit, ndaj të cilit ka pasur reagime edhe nga kisha. Gjatë shfaqjes së këtij filmi janë raportuar edhe raste të vdekjes së disa shikuesve nga tronditja me çka është riaktualizuar edhe një herë ndikimi i dhunës që trajtohet në veprat artistike në fatin dhe shëndetin e njerëzve, pra jo si katarzë, por si mjet që e shkakton fatkeqësinë. Megjithatë ende nuk ka pasur asnjë diskutim serioz se ku është kufiri ku do të ndalohet prodhimi i dhunës në arte. Kjo nuk ndodh sepse ende nuk është lëkundur aspak teza sipas të cilës dhuna është shtysë e këtij qytetërimi drejt progresit.

Në të vërtetë, në artet dhe përgjithësisht në kulturën europiane, ekzistojnë koncepte dhe rrëryma artistike të shumta, që nuk e tematizojnë dhunën dhe nuk e motivojnë dhunën. Po të mbetemi në fushën e teatrit, këtë e shohim në të ashtuquajturën dramë antiaristoteliane, që më së miri vërehet në dramën dhe në teatrin e absurdit. Në këto vepra artistike nuk ka ngjarje të dhunshme dhe nuk ka mesazhe të dhunshme. Në to tematizohen ankthi i njeriut modern, tjetërsimi i tij, paaftësia për të konkurruar në jetën sociale dhe politike, dështimi në dashuri,

rrënimet e iluzioneve, pritja e kotë, (mjafton të përkujtojmë këtu dramën *Duke pritur Godonë* të Beketit si metaforë e këtij arti). Vërtet, këto rrryma artistike nuk kanë brenda vetes dhunë, por e keqja është se ato nuk kanë as përbajtje dhe as mesazhe etike e filozofike që do ta mobilizonin njeriun moralisht e do t'i ndihmonin që t'i përballonte më lehtë sfidat e jetës në botën e sotme. Ky art dallohet për shterpësi të ideve dhe mbahet në këmbë vetëm falë efekteve të vogla që harrohen në çast.¹⁰

Skenat e teatrove të sotme europiane janë përplot shfaqje të tilla, me nga dy aktorë, me më shumë pantomimë sesa tekst, me më shumë efekte akustike sesa konflikt dramatik, me më shumë prirje drejt zhveshjes lakurike në skenë sesa të dhëniaj së një mesazhi etik. Nga ky aspekt, ky lloj arti i absurdit, më shumë të zgjon neveri etike, sesa që të ofron kënaqësi estetike. Ky lloj arti flet në një aspekt për njeriun e sotëm të zënë në kurthin e vëtmisë, të perversitetit, të ankthit, të pamundësisë që të jetojë normalisht, në një botë të dhunshme e johumane. Megjithatë ky lloj arti nuk arrin ta nxjerrë kuptimin e vërtetë të shkaqeve të krizës së njeriut dhe të shoqërive perëndimore së botës së sotme. Ato vetëm e regjistrojnë ndonjë elemente të asaj krize, duke e shikuar të fragmentuar, të shkëputur dhe pa gjasa që të ndryshojë diçka në të ardhmen. Këtë art e përshkon fatalizmi, sepse edhe vetë burimin e ka tek agnosticizmi, te laicizmi dhe te perversiteti i jetuar me të vërtetë nga autori. Ja si e përshkruan shkrimtarja kanadeze, Mirna Kostash lidhjen e prozës së saj me përvojat jetësore: “Kam synuar t'i hu-

¹⁰ Shfaqja *Kleine prinz* e Theatre A.D. Ruhr, që u dha më 2 tetor 2005 në skenën e Teatrit Kombëtar të Prishtinës, si shfaqje pjesëmarrëse në Festivalin Ndërkombëtar të Teatrit “Kosova InFest 2005”, e cila ndonëse e motivuar nga një vepër interesante, është një shembull i artit pa përbajtje dhe pa mesazh.

lumtoj mundësitë e dëshirave heteroseksuale te gratë, pasi që u ftoh zjarri i revolucionit seksual - pasi që bashkëmendimtaret e mia u zhdukën në martesa, amësi, shkurorëzime, martesa pa kurorë, vdekje, pasi që u harxuan të gjitha mënyrat e paraqitjes së thyerjes së normave seksuale dhe fragmentimit, derisa bota pamëshirshëm dhe e ndërkryer nxiton drejt mjerimit të globalizuar postmarksist në formën e lakmisë dhe digjitalizimit.”¹¹

Edhe shkrimtari anglez Alen Halingharst është një shembull interesant i këtij fenomeni, ku përvoja e patologjisë seksuale të autorit, shitet si art. Alen Halingharst-i vetë është gej, ndërsa, në romanin *The Line of Beaty* (Vija e të bukurës), e përshkruan jetën e një geji hedonist, praduke i transmetuar përvojat personale të patologjisë seksuale në një roman për të cilin madje e ka fituar edhe çmimin prestigjioz *Buker*. Rrjedhimisht, ky lloj arti rilidhet me frymën perverse të artit antik grek, jo vetëm në tematizimin e defekteve të njeriut, por edhe në përligjen publike të ndyrësisë fizike dhe morale.

¹¹ Danas, 20 tetor 2004, www.danas.co.yu

“Bukuria amerikane” si tragjedi jetësore

Artin e tillë, me parashenjë të fuqishme të të qenit pjesë reprezentuese e qytetërimit perëndimor, e sajojnë artistët që janë pjesë e industrisë së artit dhe kulturës. Ata nuk janë personazhe si personazhet e tragjedive antike greke, të tragjedive të Shekspirit e të klasicistëve francezë. Ata janë njerëz dhe e jetojnë dramën e tyre jetësore si njerëz. Dramat e tyre jetësore e zbulojnë edhe një segment të pasojave që i prodhon dhuna e artit të tyre dhe dhuna e tërë qytetërimit me të cilin arti i tyre identifikohet si vlerë kulmore.

Hollivudi vërtet ndoshta mund të shërbejë si metafora më e fuqishme që e shënon këtë industri, nga më profitabilet dhe nga me ndikim më të fortë në botën e sotme, në të katër anët e globit. Prodhimi i filmave dhe i këngëve në studiot e Holliviudit është i madh dhe me shumë ndikim ndikim në treg. Filmat që prodhohen në studiot e tij realizojnë përfitime me qindra milionë dollarë, sikundër që hitet muzikore që lansohen nga këto studio, të cilat përfshijnë botën me një shpejtësi marramendëse. Ndërsa, artistët e Hollivudit, për shkak të përfitimeve enorme që i realizojnë producentët e tyre nga veprat artistike që i prodrojnë, janë njerëzit më të pasur të botës. Mediat raportojnë për miliona dollarë që i harxojnë disa prej tyre për ditëlindje, për dasma, për shpenzime gjyqi pas shkurorëzimeve, për aktivitete humanitare, etj. Këto raportime të mediave zbulojnë se ata

janë njerëz shumë të pasur, aq sa nuk e dinë as çka të bëjnë me të hollat që i fitojnë.

Por, a janë njerëz që rrezatojnë vlera morale dhe a janë njerëz të lumtur këta milionerë të Hollivudit dhe të estradës përgjithësisht? A janë të lumtur ata që i përfitojnë zemrat e miliona njerëzve anekënd botës?

Këtu po i sjellim vetëm disa shembuj të sjelljeve skajshmërisht të këqija dhe të skandaleve që e karakterizojnë botën e njerëzve të Hollivudit, i cili në instance të fundit është produkt i një shoqërie dhe i një qytetërimi të dhunshëm:

Angjelina Xholi, pas dy martesave të dështuara, deklaronte se në të ardhmen do të jetë “seksualisht aktive”, duke pasur nga disa partnerë në të njëjtën kohë. (Është e ditur se cili është emërtimi për femrën që është “seksualisht aktive” jashtë kurorës dhe më me shumë meshkuj në të njëjtën kohë).

Aferat e Majkell Xheksonit me fëmijë të vegjël kanë zgjatur me vite dhe janë zvarritur nëpër procese gjyqësore. Sado që është vendosur për mosndjekje penale ndaj tij, mbetet impresioni i implikimit të tij në këtë sferë patologjike, sepse ka pasur dëshmi se ai u ka paguar shuma marramendëse parash prindërve të fëmijëve që kishin qenë objekt i abuzimeve të tij.

Këngëtar i njohur, Elton Xhon, e ka shpallur haptazi martesën me një mashkull. (Dihet se homoseksualizmi është një nga veprat e shëmtuara, për çka Zoti në Kur'an na ka paraqitur prova të ndëshkimit të fortë të disa njerëzve e popujve.) Po ky Elton Xhon, , i entuziazmuar nga fakti që në Nepal homoseksualizmi është legal, ka dhënë donacion për homoseksualët e këtij vendi, paçka se paratë i ka dhënë për mjekimin e sidës, që është pasojë direkte e dukurisë së shëmtuar të homoseksualizmit dhe të formave të tjera jonormale të kontaktit seksual.

Këngëtarja e famshme, Maraja Keri, ka përjetuar disa kriza depresioni dhe pastaj është mjekuar nëpër spitale.

Heroi i filmit “Perl Harbur”, Ben Aflek, ka vuajtur nga alkoolizmi, për çka edhe i është nënshtruar mjekimit spitalor.

Kristina Agilera e pranon botërisht se e ka përdorur drogën, por fatmirësisht thotë se e ka kuptuar se ajo nuk ishte për të, andaj thotë se tash më shumë e preferon alkoolin (që po ashtu është i radhitur te gjërat e ndaluara.)

Aktorja e famshme, Xhulia Roberts, e cila ka pasur një varg martesash dhe skandalesh, në prag të martesës me Kifer Saterlandin, e kishte marrë valixhen dhe kishte ikur në Irlandë duke e lënë dasmën e shpallur.

Modelja Kejt Mos, në studion e të fejuarit të saj, këngëtarit Pit Dohert, është fotografuar duke marrë drogë. Fotografitë i ka bërë fshehurazi një mik i tyre i cili pastaj ia ka shitur gazetës “Daily Mirror” për 1.3 milionë dollarë. Kështu është zbuluar se Mos është e varur nga drogat e rënda.¹²

Tregime të këtilla rrëqethëse nga aspekti moral, prodhohen përditë nga Hollivudi dhe kudo që ndodhen këta artistë të famshëm, nga veprat e të cilëve tërë bota mbahet në një makth.

Prej nga burojnë këto sjellje jonormale të shumë artistëve të famshëm, për të cilët po të vlente fakti se pasuria do të bënte njeriun të lumtur, këta artistë do të mund të ishin nga më të lumturit e botës? Mirëpo, ata nuk janë të lumtur. Është e kundërta, sepse shumë prej tyre e thonë vetë se kanë kriza dhe ndihen fatkeq. Sjelljet e këtilla skandalozë në fakt e kanë burimin te pakënaqësia ekstreme shpirtërore

¹² Këto raste janë shkëputur nga gazetat, vetëm sa për ta ilustruar temën, sepse informacione të kësaj natyre ka përditë dhe me qindra. Lajmet për “të rejat” e artistëve të Hollivudit në fakt janë edhe shkatërrim i privatësisë së jetës së njeriut, sepse pothuajse asgjë nuk mbetet në sferën e jetës private të tyre. Nga ky aspekt, ato janë viktima të pangopësisë së publikut dhe të mediave për senzacionalizëm.

e këtyre njerëzve, të cilët e kanë realizuar veten në planin profesional dhe në planin material, por nuk e kanë gjetur paqen shpirtërore dhe pastërtinë morale. Femrat e famshme vërtiten nga një burrë te tjetri, nga një shtrat e tjetri, pa kurorëzim, pa legjitimim ligjor të lidhjeve. Edhe burrat po ashtu. Shpërthimi i sjelljeve lesbike dhe homoseksuale është tronditës në këto qarqe.

Ambienti kulturor dhe shoqëror në të cilin këta jetojnë është motivues për sjellje patologjike. Në disa shtete amerikane, por edhe në Holandë, në Spanjë e në Kanada, është e lejuar me ligj martesa e homoseksualëve. Mediat kanë paraqitur edhe në film ceremonitë e martsave të homoseksualëve. Madje, ka edhe raste të protestave të tyre në ato vende ku nuk janë lejuar martsat e tyre. Ka edhe raste, si ai në Zelandë të re, kur Gjykata e ligjëson birësimin e një fëmije nga dy lesbike dhe nga një homoseksual (i cili e ka huazuar spermën për lindjen e fëmijës). Ndërsa, agjencia Rojters ka transmetuar rezultatet e një ankete të bërë në Gjermani, sipas së cilës gjermanët i mashtrojnë partnerët e tyre në çdo sekondë. Anketa i përfshinte 1059 respondentë, të cilët kishin deklaruar pa përjashtim se së paku një herë e kishin tradhtuar partnerin e tyre. Nga arsyetimet që ka arritur t'i nxjerrë Instituti Gevis, i cili e ka realizuar këtë anketë, iluzioni për dashurinë e përsosur që transmetohet nga filmat, është njëri nga nxitësit kryesorë të tradhtisë bashkëshortore te këta të anketuar. Ne as që mund të imagjinojmë se çfarë dramash, konfliktesh, e çfarë dhune prodhohet në ato familje nga ato tradhti bashkëshortore, çfarë trumash përjetojnë fëmijët e çifteve të tilla dhe çfarë problemesh sociale e morale shkaktohen në shoqëri. Shumica e ekspertëve pajtohen në konstatimin se familja në shoqëritë perëndimore është në krizë. Sipas një burimi, në qytetin gjerman të Hamburgut, së paku 100 000 ekono-

mi familjare përbëhen vetëm nga një person. Trendi i shkurorëzimeve, i martesave të homoseksualëve dhe lesbikeve, i jetesës në vetmi, i hapjes së shtëpive publike, i pedofilisë dhe i narkomanisë, është në rritje në tërë Perëndimin. Të gjitha këto dukuri sociopatologjike janë pasojë e zhvillimeve joharmonike të shoqërive dhe të vetë qytetërimit perëndimor, i cili është koncentruar në progresin material, duke e injoruar tërësisht dimensionin moral dhe shpirtëror të njerëzve. Nga ky aspekt mund të thuhet madje se në praktikat e sotme, qytetërimi perëndimor më pak është kristian e shumë më tepër një qytetërim postpagan ose politeist.

Filmi “Bukuria amerikane” mund të jetë sublimim i tërë kësaj krize që e prodhon ky qytetërim në stadin e tashëm të zhvillimit enorm material dhe të kriçës enorme morale dhe shpirtërore. Në filmin “Bukuria amerikane” konfliktet dramatike zhvillohen në këto drejtime: gruaja e tradhton burrin, burri e tradhton gruan (por edhe burri që ia kapë gruan Lesterit, është i shkurorëzuar nga e shoqja), një burrë tjetër (ish-ushtarak) është homoseksual, ndërsa i biri i tij është narkoman. Një personazh tjetër është një vajzë adoleshente që shtiret si prostitutë me nam, ndërsa kur i vjen puna të shtrihet në shtrat (me babain e shoqes së vet), është e lemerisur nga frika. Me një fjalë, të gjithë individët, e gjithë familja, po edhe bashkësia, që tematizohen në këtë film, kanë defekte psikologjike, seksuale, sociale dhe morale. Si për ironi, regjisori këtij filmi ia ka vënë titullin “Bukuria amerikane”, edhe pse këtu është fjala për shëmti, që në një mënyrë lidhet me tërë atë ngarkesë vuajtjesh e çrrregullimesh që i tematizon arti antik greko-romak, për të cilin disa dijetarë thonë se paraqet njérën nga shtyllat e qytetërimit perëndimor.

Shqetësimi nga imoraliteti në rritje në elitat e artisteve është i madh, sepse veprimet e tyre kanë ndikim të

ndjeshëm në tifozërinë e tyre në tërë botën. Krahas mesazheve të dhunës që i jep një pjesë e artit, që nga arti antik greko-romak, e deri te kinematografia e Hollivudit, e të cilat mund të ndikojnë në shpërthimin e sjelljeve të dhunshme te njerëzit e paudhëuar, sjelljet publike imorale të artistëve, që nga prostitucioni e deri te format e tjera patologjike të homoseksualizmit, të biseksualizmit e të heteroseksualizmit, kanë ndikim të rëndë te gjeneratat e reja, që ëndërrojnë t'i pasojnë artistët e famshëm. Vërtet, mesazhet që i jep qytetërimi perëndimor përmes artistëve të këtij formati, vetëm e fsheh përkohësisht një krizë të thellë morale. Ata reklamojnë një shkëlqim të jashtëm, me pasuri marramendëse e me veshje ekstravagante, por në të njëjtën kohë ekspozjonë një çrregullim të rëndë moral e shpirtëror, një ankth që nuk gjen ngushëllim as te mirëqenia, as te popullariteti përrallor.

Është e qartë se këta artistë janë shembull i njerëzve që kanë mungesë të ushqimit shpirtëror, i cili merret vetëm me besimin në Zot, me praktikimin e fesë dhe të jetës në pajtim me ligjet fiziologjike, emocionale, morale e shpirtërore, që Krijuesi i ka caktuar për krijesat njerëzore.

Toleranca e rreme ndaj të mundurve

Eskperti gjerman, Reimer Ditrih, ka ardhur në një përfundim të çuditshëm lidhur me transformimin e dhunës në sport. Ai pikërisht në konferencën me temë “Dhuna dhe qytetërimi”, të organizuar nga Shoqata Gjermane e Psikanalizës, Psikosomatikës dhe Psikologjisë (GDPT) ka thënë se “Do të ishte jorealistë të shpresojmë për eliminimin e plotë të dhunës. Nuk mund të ketë shoqëri njerëzore pa dhunë, por ajo që mund të bëhet është ndryshimi i drejimit të formave shkatërruese të dhunës për ta kthyer prirjen drejt saj të favor të formave kolektive, siç janë sportet”.¹³

A mund ta neutralizojnë dhunën sportet, ashtu sikundër propozon eksperti gjerman? Dhuna e zbuluar nga arti antik greko-romak, që konsiderohet si njëra nga shtyllat e qytetërimit perëndimor (krahas shtyllës tjetër judeo-kristiane) e bartur nëpër të gjitha formacionet artistike dhe e ardhur në ditët tona si art i dhunës në formën e kinematografisë dhe i rënies morale te bartësit e vetë mesazht artistik, ka shtrirje edhe në fushat e tjera të jetës, duke përfshirë manifestimin e saj edhe në sporte, madje edhe në tribunat e stadiumeve të futbollit. Nga ky aspekt dhuna e manifestuar në stadiumet e futbollit, më shumë është e lidhur me kulturën e arenave, por edhe të amfiteatrove. Shembujt që po i sjellim këtu janë fare të

¹³ Epoka e re, 7 dhjetor 2001.

freskët: në ndeshjen e futbollit ndërmjet Realit të Madridit dhe ekipit gjerman Leverkuzen, e cila u zhvillua më 23 nëntor 2004 në stadiumin Santiago Bernabeu ndodhi një shpërthim i emocioneve raciste me përmasa shqetësuese. Me mijëra shikues, tifozë të ekipit madrilen ulërinin gjithë tërbim, duke krijuar onomatopenë e klithjeve të majmunëve dhe duke e adresuar atë tërbim kundër futbollistëve zezakë të ekipit gjerman. Po atë shpërthim racist e manifestoi publiku spanjoll edhe në ndeshjen e futbollit që u luajt ndërmjet Spanjës e Anglisë, e cila ka një numër të madh të futbollistëve zezakë në ekipin e vet. Fatkeqësisht, ky shpërthim i emocioneve raciste nuk mbeti vetëm në mesin e tifozëve spanjollë të futbollit.

Shpërthimi i kësaj urrejtjeje raciste u përhap gjithandej nëpër stadiumet europiane të futbollit dhe tashmë është bërë një problem serioz për federatat e futbollit, për ekipe, për opinionin publik e mbase edhe për politikat europiane. Gjithë kjo ndodhë për arsyen se nëse kjo dukuri e shëmtuar nuk shuhet, ajo mund të prodhojë pasojë negative për futbollin në Europë. Po qe se një lëvizje raciste do t'i detyronte ekipe europiane të futbollit t'i largojnë nga radhët e veta futbollistët me ngjyrë të zezë të lëkurës, atëherë do të ndodhë një degradim i futbollit në Europë. Tash për tash shumica e ekipeve të mëdha të futbollit kanë lojtarë nga Amerika Latine, nga Afrika, nga Azia e madhe edhe nga Lindja e Largët. Këta lojtarë, që sigurisht janë më të talentuarit, mundësojnë në ekipe e mëdha të futbollit europian kualitet dhe sharm që e josh publikun dhe prej andej edhe sigurojnë të ardhura marramendëse për klubet e tyre. Sot është e vështirë të gjendet një ekip serioz i futbollit në truallin europian i cili nuk ka në radhët e tij lojtarë nga kontinentet e tjera. Pikërisht në futbollin europian mund të shihet trendi dhe ndoshta shkalla më e lartë e globalizmit. Vetëm

mund tē merret me mend se nē çfarë nivelesh mē tē ulëta do tē ishe cilësia e ekipit tē famshëm londinez, Arsenal, pa Tieri Anrinë.

Një lëvizje e tillë me ngjyrime raciste do tē kishte pasoja tē rënda edhe pér imazhin e kontinentit europian, ku toleranca konsiderohet se ka arritur standarde tē larta (por ky standard rezulton nga krahasimi me vendet e tjera, latino-amerikane, afrikane, aziatike, duke përfshirë edhe shtetet me shumicë muslimane tē popullsisë, por me regjime diktoriale). E drejta, toleranca dhe liritë e njeriut, mbrohen me një sërë konventash e ligjesh tē miratuara me konsensus nē institucionet nationale dhe paneuropiane. Nëse do tē prishej ky imazh dhe nëse do tē rrezikohej kjo infrastrukturë ligjore që e mbron tolerancën ndëretnike, atëherë e ardhmja e Europës do tē ishte problematike, ngase ajo tashmë ka një popullsi shumë tē përzier dhe më nuk mund tē aspirojë kthimin nē skemat e vjetra tē pastërtisë së racës. Gjithsesi duhet diçka më shumë se propozimi pér kthyerjen e “drejtimit tē formave shkatërruese tē dhunës, pér ta kthyer prirjen e saj nē favor tē formave kolektive, siç janë sportet”. Nëse ambienti social, politik dhe kulturor mbeten tē dhunshëm, sportet vetëm e stimulojnë dhunën, me atë që Vilhelm Rajh, duke e analizuar ndikimin e histerisë së masave pér agresivitetin dhe dhunën e prodhuar nga fashizmi, e ka quajtur “psikologjia masive”.

Shkrimtari i njohur Xhorxh Orvell e ka analizuar me shumë sens mesazhin e dhunës që prodhohet nē stadiu-met e futbollit, nē rrëthanat e konflikteve ideologjike. Në takimin ndërmjet një ekipi anglez dhe në ekipi sovjetik, nē periudhën e Luftës së Ftohtë, Orvellli ka zbuluar se sharjet dhe ulërimat e publikut nga tribunat e stadiu-mit, bartnin një potencial tē jashtëzakonshëm pér dhunë. Prandaj, sportet vërtet nuk mund ta zbusin dhunën dhe

as ta orientojnë atë në një drejtim më të butë. Këto ide janë sipërfaqësore dhe pa gjasa që të ndihmojnë në eliminimin e dhunës nga jeta njerëzore.

Ulërimat e tifozëve të egërsuar nëpër stadiume kundër futbollistëve të huaj, me ngjyrë të zezë, nuk janë një produkt i vetë stadiumeve. Është një opinion i përpunuar në media, në televizione dhe në parti politike të së djathës ekstreme, e cila urrejtjen ndaj të huajve e ka shndërruar në obsesion. Ata qytetarë që ulërijnë në stadiume janë pjesëtarë të kësaj mendësie. Me këtë rast mund të përkujtohet se shenjat e para të urrejtjes shpërthyese ndëretnike në ish-Jugosllavi janë shfaqur pikërisht në stadiumet e futbollit. Në stadiumin “Marakana” të Beogradit, u burgosën tifozët e ekipit të futbollit Prishtina, për shkak se serbët nuk mund të pajtoheshin që ekipi i Cërvena Zvezdës të humbte ndeshjen nga shqiptarët! Në fundin e viteve të tetëdhjetë, ulërimat “cigani” (magjupë), “ustashe” (fashistë kroatë të LDB-së), “çetnici” (fashistë serbë të LDB-së) u shndërruan në një lëvizje masive të fuqishme, e cila doli edhe nga stadiumet dhe vërshoi rrugëve të qyteteve, në media dhe në foltoret e institucioneve politike.

Për luftërat e përgjakshme që e shkatërruan ish-Jugosllavinë në vitet 1991-1999 një pjesë të kontributit e ka edhe tifozeria e manipuluar në stadiumet e futbollit. Opinion publik dhe politikanët europianë, që nganjëherë shtiren si të topitur e nuk reagojnë ndaj dukurive të shpërthimeve raciste nëpër stadiumet e futbollit dhe nëpër qytetet ku digjen objektet fetare të muslimanëve, do të duhej ta mbajnë mend shembullin tragik të mbjelljes së urrejtjes nga stadiumet e futbollit e të përhapur pastaj edhe me tytat e armëve, deri në spastrimin etnik dhe gjenocidin në emër të urrejtjes etnike dhe fetare në ish-Ju-

gosllavi. Srebrenica është metafora më tragjike e kësaj urrejtjeje, edhe pse ajo nuk është e vëtmja.

Me gjithë ekzistimin e një sërë faktorëve që nxisin urrejtjen racore dhe fetare në shtetet e sotme europianoperëndimore, mbetet e paqartë se si është e mundur që ajo të arrijë të mobilizojë aq shumë njerëz në stadiume dhe të shndërrrohet edhe në dhunë, siç ishte djegia e xhamive në Holandë. Por, edhe kjo e ka një shpjegim logjik. Pasardhësit e kolonizatorëve europianë, të cilët i kanë pushtuar kontinentet dhe e kanë përhapur krishterimin me forcën e armëve dhe kanë zhdukur popuj të tërë, në mendësinë e tyre e kanë të injektuar ndjenjën e epërsisë racore. Kjo mendësi është veçmas aktive në raport me zezakët dhe me muslimanët. Ndaj këtyre të fundit ka mbetur e pafashitur urrejtja e hershme e kryqtarëve dhe e kolonizatorëve dhe ajo sapo e gjen një pretekst, manifestohet me ashpërsi.

Toleranca është dukur se po triumfonte atëherë kur europianët kanë qenë të bindur se i kanë mposhtur plotësisht të tjerët. Në rolin e triumfuesve dhe të imponuese të vlerave të qytetërimit të vet, europianoperëndimorët janë treguar më zemërgjerë, por vetëm me kusht që të mundurit të sillen sipas rregullave të caktuara të sjelljes. Pra, toleranca racore, etnike dhe fetare ndaj të mundurve, ka të bëjë me mbajtjen prej tyre të rregullave që u janë imponuar. Dhe në rast se ndodh përpjekja për të dalë nga ajo kornizë e për të krijuar identitetin e tyre, veçmas atë fetar, atëherë toleranca shkrihet si sapuni në ujë: shfaqet ulërima raciste, shfaqen filmat që mbjellin urrejtje dhe pason djegia e xhamive. Me një fjalë, me të fuqinë e saj rikthehet urrejtja e vjetër e kryqtarëve dhe urrejtja e re e kolonizatorëve. Ky është virus që fle në trupin e Europës konservative (jo edhe të pjesës liberale të saj) dhe që ngjallet kur trupi e ndjen rrezikun se po e

humb imunitetin e fitimtarit. Në një gjendje të tillë as që mund të bëhet fjalë për arritjen e statit ku njerëzimi mund të jetojë pa dhunën si pjesë përbërëse të jetës së tij.

Por, jeta e njerëzimit pa dhunë, absolutisht është e mundshme dhe e garantuar nga Krijuesi i Botëve. Për ta arritur atë shkallë të ekzistencës, njerëzimit i duhet ta organizojë jetën e vet në pajtim me shpalljet hyjnore. Në një rast të tillë fatlumë, dhuna do të shmangej, ndërsa njerëzimi do të jetonte në mirëkuptim dhe paqe. Dallimet ndërmjet popujve, fiseve dhe racave do të jepnin rastin për t'u njobur më mirë, për ta plotësuar njëri-tjetrin e për t'u zhvilluar në mënyrë më harmonike. Në atë rast, gara kryesore ndërmjet njerëzve do të ishte se kush do të jetë më i ruajtur nga të këqijat, ashtu siç thuhet në ajetin 13 të sures së Kur'anit el-Huxhurat: “*O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se tek Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (nga të këqijat) e Allahu është shumë i dijshëm dhe hollësishët i njobur me çdo gjë.*

Është po ashtu me interes ajeti paraprak i kësaj sureje, ajeti 12, në të cilin Zoti u kërkon njerëzve që të heqin dorë nga dyshimet, nga zbulimi i të metave të njëri-tjetrit (vetëm perceptimi i çoroditur i tjetrit mund të sajojë dyshim në bazë të ngjyrës ose të përkatësisë etnike, si edhe vlerësimi se të qenit me ngjyrë të zezë e njeriut/futbollistikët është një e metë). Zoti e ka koncentruar ndershmërinë e njeriut te ruajtja nga punët e liga, e jo nga pamja e jashtme. Edhe përgjimi i njëri-tjetrit, si veprim që e ka motivin te mosbesimi dhe te synimi për t'ia gjetur tjetrit pikat e dobëta e përmes tyre për ta luftuar, bie në kategorinë e gjérave të ndaluara, sepse ato fusin mosbesim dhe çrregullim në raportet ndërmjet njerëzve. Këtë veprim të çoroditur Zoti e ka krahasuar me një ngrënien e mishit të vëllait të vdekur, pra me një gjë të

tmerrshme, qoftë dhe vetëm për ta paramenduar: “*O ju që keni besuar, largohuni prej dyshimve të shumta, meqë disa dyshime janë mëkat dhe mos hulumtoni për zbulimin e të metave të njëri-tjetrit, dhe mos përgjoni njëri-tjetrin, a mos ndonjëri prej jush dëshiron të bajë mishin e vëllait të vdekur? Atë pra e urreni! Kini frikë nga ndëshkimi i Allahut, e Allahu është mëshirues, Ai pranon shumë pendimin*”.

Heqja dorë nga dyshimet në qëllimet e njëri-tjetrit, duke përfshirë këtu edhe heqjen e dyshimeve ndërmjet popujve dhe moshulumtimin e të metave të njëri-tjetrit, janë obligime për njerëzit që kuptojnë. Teoria raciste bazohet pikërisht në theksimin e dallimeve dhe vlerësimin e dallimeve (Franc Nojman) duke i vlerësuar dallimet e tjetrit si të rrezikshme, me vlera më të ulëta, etj., gjë që paraqet arsyetimin e akteve të dhunshme kundër njerëzve të racave të tjera, të etnive të tjera, të territoreve të tjera e të feve të tjera. Prandaj, po të hiqeshin dyshimet, ama po t'i hiqnin dyshimet të gjithë njerëzit e të gjithë popujt, ashtu siç po kërkon Zoti (ndërsa është e qartë se kur Zoti e kërkon një gjë nga njerëzit, ajo është e mundur, sepse mundësohet prej Tij), atëherë do të shterej burimi ideologjik i nacionalizmit dhe i racizmit. Edhe ndalimin e mospërgjimit të njerëzve, Zoti e ka kategorizuar si një gjë të madhe, sepse përgjimi prodhon çregullime të rënda në raportet ndërmjet njerëzve e ndërmjet qeverive e popujve. Sot vetëm mund të imagjinohet se sa miliardë dollarë harxhohen në botë për instalimin e përgjimeve, që nga bisedat telefonike, te mesazhet e koduara e deri te zbulimi i të fshehtave teknologjike. Bota e sotme vërtet jeton në ankthin e përgjimeve, të sajimit të dosjeve në bazë të përgjimeve e madje edhe të aplikimit të dhunës, (shantazhimeve, burgosjeve, atentateve, madje edhe spastrimeve etnike.)

Me shterjen e këtyre burimeve (dyshimet në njëri-tjetrin, zbulimi i të metave të njëri-tjetrit dhe përgjimi) që së bashku i motivojnë dhe i arsyetojnë dyshimet dhe dhunën, fitorja e mirëkuptimit dhe e paqes ndërmjet një-rëzve dhe ndërmjet popujve të ndryshëm do të ishte plotësisht e mundur, sepse ajo në fakt është kërkesë e vetë Krijuesit të Botëve. Pra, toleranca ndaj atyre që konsiderohen të mundur ose më pak të rrezikshëm nuk bën aspak pjesë në përbushjen e obligimeve që Zoti ia ka ngarkuar njeriut, në mënyrë që ai të jetojë në paqe dhe duke e pasur kënaqësinë e Zotit të tij.

Toleranca ndaj të mundurve është hipokrizi, është dhunë e maskuar, është krim potencial, si thika e fshehur nën mëngë e cila në çdo çast mund të nxirret e të ngulet në trupin e tjetrit. Rrjedhimisht sporti nuk mund ta transformojë dhunën në diçka më humane, në rast se vetë qytetërimi nuk transformohet në drejtimin e duhur, nëse nuk hiqet dorë nga dhuna si pjesë organike dhe e shpallur si mjet legjitim për arritjen e qëllimeve. Rreziku që ulërimat nga stadiumet të marrin udhën e përndjekjeve dhe spastrimit etnik, vërtet është potencial. Askush dhe asnjëherë nuk duhet ta harrojë mesazhin hitlerian në lojërat olimpike të vitit 1936.

E keqja e problemit në fjalë është se shpërthimi racist nuk po ndodh vetëm nëpër stadiume. Ka raste kur shpërthimi racist mbi baza të urejtjes fetare shndërrohet edhe në dhunë ndaj njerëzve dhe ndaj objekteve fetare. Rasti më drastik ndodhi në fundvitin 2004 në Holandë, e prej andej u përhap edhe në Gjermani, Francë, Angli e në disa vende të tjera europiane. Vetëm në Holandë brenda pak ditësh u dogjën së paku njëzet xhami në shenjë hakmarrjeje për producentin Teo Van Gog i cili u vra nga një maroken. Producenti Teo Van Gog kishte prodhuar një film skajshmërisht antimusliman, në të ci-

lin përcmonte edhe ajete kur'anore, përcmonte figurën e muslimanes, madje edhe Islamin në tërësi. Për të qenë e keqja edhe më e madhe, televizioni publik holandez e transmetoi atë film duke e justifikuar këtë gjë me lirinë e të shprehurit. Manipulimi me lirinë e të shprehurit në këtë rast është evident, sepse liria e të shprehurit dhe liria në përgjithësi e ka kufirin aty ku e cenon lirinë e tjetrit. Por, ky liberalizëm ka arritur në përmasa të tilla sa është shndërruar në anarki. Dhe, pikërisht në këtë pikë, ai liberalizëm kthehet kundër dinjitetit dhe kundër identitetit të të tjerëve, duke i fyer e duke i provokuar rëndë. Duket sheshit se i riu maroken që e vau producentin Teo van Gog nuk ka arritur ta kuptojë "lirinë e shprehjes" e cila guxon të tallet edhe me fjalët e Zotit dhe me shpalljet e Tij. Sigurisht që marrja e drejtësisë në duar prej tij është një vepër e dënueshme, por mbetet fakti se provokimi në baza racore dhe fetare, në emër të lirisë së shprehjes, e cila rezervohet vetëm për vete, i ka kaluar kufijtë dhe ashtu e ka ndjellë krimin. Megjithatë përgjigja ndaj një krimi të një individi, i cili ka mundësi të ketë pasur edhe probleme mentale, ishte edhe më shokuese. Djegia sistematike e njëzet xhamive anekënd Holandës, ngacmimi dhe kërcënimi i muslimanëve, arriti në pikë kritike. Aq më tepër, ai u përhap edhe në disa shtete të tjera europiane, duke zgjeruar kështu disponimin antiislam në truallin europian.

Edhe nëse pranohet se ky ishte një reaksion emocional për shkak të vrasjes së producentit Teo van Gog, çka mund të thuhet për programin politik antimusliman të ish-politikanit holandez, Fortuini. Ai angazhohej për dëbimin e muslimanëve dhe të huajve nga toka holandeze. Angazhime programore të kësaj natyre kanë edhe të djathjtët e tjerë në vende të tjera europiane, që nga Le Peni në Francë e deri te Hajderi në Austri. Me këto

programe politike janë të orkestruara edhe shumë media që vjellin helm e vrer kundër muslimanëve dhe kundër të huajve që “e kanë vërvshuar” truallin europian.

Megjithatë në këtë botë të përkohshme, edhe fitoret më spektakulare janë të përkohshme. Europa duhet të vetëdijësohet për këtë fakt she të përgatitet për bashkëjetesë të mirëfilltë, aktive dhe në baza të partneritetit e të respektit të ndërsjellë edhe me popujt që dikur i ka mundur, por të cilët tashmë janë pjesë përbërëse e saj dhe me gjasa që në një të ardhme, të shndërrrohen në shumicë madje edhe brenda saj. Për Krijuesin e botëve kjo është krejt e lehtë. Allahu ka paralajmëruar qartë:

Zoti yt nuk ka nevojë për asgjë, Ai është mëshirues. Nëse do Ai, juve ju zhduk dbe sjellë kë të dojë pas jush, ashtu sikurse ju solli juve nga pasardhësit e atyre që ishin para jush. (Kur'ani, el-En'am: 133)

Dhe pastaj:

A nuk e ke kuptuar ti se Allahu krijoj qiejt e tokën me urtesi, e nëse Ai do, juve ju zhduk e sjellë krijesë (popull) të re. (Kur'ani, Ibrahim: 19)

Këto janë njoftime dhe ligje të Krijuesit të botëve, andaj atyre nuk mund t'u rezistojë askush, aq më pak ulëritësit e egërsuar të urejties racore, e cila zbrzet nëpër tribunat e stadiumeve dhe zjarrvënësit e shtëpive të Zotit të cilët maskohen pas një qytetërimi gjoja më superior ndaj të tjerëve.

Shtylla judeo-kristiane: “vëllezër sipas Krishtit”

Tash ia vlen të rikthehem i shtylla tjetër e qytetërimit perëndimor, ajo që nga Edgar Moreni¹⁴ emërtohet si shtylla judeo-kristiane, për të hetuar kështu potencialin e dhunës që e ka prodhuar ajo nëpër shekuj, qoftë në relacionin kundër hebreve ose në rastin tjetër edhe ndërmjet vetë të krishterëve. Dhuna në emër të fesë, të dogmave fetare kristiane, filloj të shfaqej ndërmjet judejve dhe kristianëve europianë, kur filluan të rriten dallimet në interpretimin e misionit dhe të mesazhit të Krishtit (Isait a.s.) Fitorja e konceptit të Palit shënoi edhe humbjen e trashëgimisë së judejve ndaj misionit dhe mesazhit që e kishte sjellë pjesëtari i popullit të tyre, Isai a.s, i biri i Merjimes. Dallimet shkuan aq larg, saqë në një fazë të mëvonshme, u instalua akuza përfajësi kolektive të të gjithë hebreve përmundimet dhe përpësimin e Krishtit. Mbi këtë akuzë edhe u ndërtua ideologjia antihebreje, e cila në historinë e Europës është e ndërlidhur me projekte shfarosëse që nga *Rekonkuista* e deri te kampet e përqendrimit të Hitlerit e gulagët e Stalinit. Papa Gjon Pali e pat lëshuar një deklaratë në të cilën në emër të Kishës Katolike kërkonte falje përdhunën e ushtruar kundër hebreve.

¹⁴ Edgar Moren, *Europa në mendje*, Ora, Tiranë, 2001.

Lufta e ashpër ndërmjet vetë të krishterëve në formën më gjithëpërfshirëse dhe tragjike u shfaq në Perandorinë Romake të Lindjes, Perandorinë e Bizantit. Prandaj, dhuna fetare dhe trashëgimia e qytetërimit, kanë qenë të pandashme në Perandorinë e Bizantit. Përveç rivaliteteve dhe luftërave të dhunshme për pushtet, atje edhe luftërat e egra ndërmjet ithtarëve të dogmave të ndryshme fetare kanë qenë shkak i vrasjeve dhe masakrave të egra për qindra vjet. Që nga Koncili i Nikesë i vitit 325, kur u promovua dogma ortodokse për natyrën hyjnore dhe njerëzore të Krishtit (Isait a.s.) lufta ndërmjet monofizistëve dhe arianistëve ka regjistruar rënje e ngritje, fitore të njërsës palë e humbje të tjetrës, por ajo nuk u fashit kurrë, gjithnjë deri në kalimin e shumicës së ariantistëve në Islam dhe në shkatërrimin përfundimtar të Bizantit më 1453. Në ato luftëra të egra ndërfetare, me implikime edhe kulturore (për shembull, ikonoklastët), ka pasur edhe raste kur brenda një dite në një hipodrom në Kostandinopojë, janë masakruar deri në 40.000 njerëz. Ka pasur raste kur trupi i një perandori (për shembull, Fokasit), pasi është copëtuar, gjymtyrët e tij janë ngulur nëpër hunj dhe pastaj janë shëtitur nëpër rrugët e qytetit dhe në hipodrom para masës së entuziazmuar nga pamja që u është shpalosur para syve. Po ashtu, ka pasur periudha kur egërsia e dhunës është kthyer brenda vetë Perandorisë (duke përfshirë edhe atëvrasjen, fëmijëvrasjen e vëllavrasjen), e cila e ka përgatitur edhe rënien e saj. Edhe kësaj here, për mendimin tonë, shku ku suprem gjendet në arrogancën e perandorëve dhe të Perandorisë ndaj thirrjes së të dërguarit të Zotit, kësaj here të të dërguarit të fundit, Muhamedit a.s., për t'i braktisur devijimet doktrinare dhe për ta përqafuar thirr-

jen e plotë dhe përfundimtare në fenë e vetme të pranuar nga Allahu i Gjithfuqishëm.¹⁵

Dhuna e egër e ka shoqëruar edhe kulturën dhe historinë mesjetare krishtere e cila është e mbarsur me luttëra të brendshme fetare, me kryqëzata, me djegie të njerëzve në turra drush, pasi që nga inkviziconi janë shpalitur shtriga dhe heretikë. Shembuj nga më tragjikët gjenden në truallin e Spanjës, ku është ushtruar një gjenocid i tmerrshëm kundër muslimanëve dhe kundër hebrenjve. Inkvizitorëve nuk u ka mjaftuar as konvertimi fetar, andaj kanë dashur më shumë, kanë dashur çrrënjosjen e plotë të muslimanëve dhe të hebrenjve nga trualli spanjoll. Simon Vizentali në librin e tij *Veli i shpresës* ka sjellë shumë shembuj të dhunës më barbare, të djegies në turra të druve të mijëra hebrenjve, nën akuzat se edhe pas konvertimit në katolikë, kanë vazhduar fshehtas ta mbajnë fenë e tyre të vjetër: “Vëllezër sipas Krishtit” u thoshin torturuesit viktimate të tyre, gjysmë të vdekurve, të poshtëruarve, të munduarve. Pas shqiptimit të gjykit, ua vendosnin në kokë nga një kapelë të bardhë të ngjyrosur me gjuhëza të verdha e të kuqe të flakës. Edhe rrobat e tjera u bëheshin me flakëza të këtilla. Në duar mbanin flakadanë të mëdhenj e të ndezur, ndërsa deri te turra e druve i shpinin në kortezh. Dhe, meqë kisha nuk guxon të derdhë gjak, të dënuarit duhej të digjeshin.¹⁶

Kjo histori shumëshekullore me dhunën edhe ndërmjet vetë të krishterëve, si tipar kryesor të historisë dhe kulturës europiano-perëndimore, ka kulmuar në kohët e reja me shfaqjen e kolonializmit, të nazizmit, të fashizmit dhe të komunizmit. Këto ideologji agresive kanë shkaktuar miliona viktima në rrugët tokësor, por

¹⁵ Shih: “Logjika historike dhe figura tejhistorike e Muhamedit a.s. dhe e Islamit”, *Meditime Islame*, Furkan-ISM, Shkup, 2005).

¹⁶ Simon Vizental, *Jedro nade*, Beograd, 2003, fq. 47.

gjithnjë duke e përligjur dhunën si mjet kulture dhe qytetërimi. Kolonizatorët europian operëndimorë kanë masakruar dhe madje kanë zhdukur edhe popuj të tërë në dy kontinentet amerikane dhe në Australi, duke e justifikuar kështu gjenocidin e tyre me argumente kulturore. Ata që nuk e pranonin pushtimin dhe krishterimin si ideologji të pushtuesit, i ekspozoheshin zhdukjes fizike. Edhe nazizmi i cili ndër të tjera u motivua si ideologji për shkak të frustrimit gjerman nga ngulfatja e aspiratës gjermane për koloni jashtë Europës, e adoptoi teorinë kulturore të epërsisë së racës ariane, dhe nën ketë pretekst filloi shfarosjen sistematike të disa popujve që konsideroheshin raca të më ulëta. Nazizmi gjerman nuk arriti të dilte jash-të kufijve të Europës, sikundër kolonizatorët anglezë, spanjollë, portugezë, francezë e holandezë dhe prandaj egërsinë e vet e shfryu në truallin europian dhe kundër popujve europianë. Por, kjo ideologji e përfshiu edhe zhdukjen e handikapatëve dhe të të gjithë atyre që nuk i plotësonin kriteret e ideologjisë naciste edhe brenda racës ariane, me synim që ashtu ta shtrijë dhunën në të gjitha nivelet e shoqërisë dhe të njerëzimit.

Edhe komunizmi si ideologji e cila proklamoi barazinë e njerëzve dhe zhdukjen e dallimeve klasore, racore e kombëtare dhe madje edhe zhdukjen e shtetit, ishte produkt i dhunës së egër dhe i projektit shfarosës ndaj kundërshtarëve ideologjikë. Me miliona njerëz ranë viktima të kësaj ideologjie terroriste dhe gjenocidale. “Në këtë mënyrë gjatë shekullit XX në kasaphanat politikisht të motivuara janë zhdukur në mënyrë të qëllimshme jo më pak se 167 000 000 – madje ka shumë të ngjarë ky numër të jetë mbi 175 000 000. Ky është barasvlerësi i përafërt i numrit të përgjithshëm të popullsive të Fran-

cës, Italisë dhe Britanisë së Madhe, ose dy të tretat e popullsisë aktuale të Shteteve të Bashkuara".¹⁷

Sipas specifikimeve që i ka prezantuar ky autor në librin e lartcituar, vetëm Hitleri ka shkaktuar vdekjen e 17 000 000 njerëzve, ndërsa Stalini ia kaluar, duke shkaktuar vdekjen e 20 000 000 ose 25 000 000 njerëzve. Ndërkaq, në anën tjeter, *Revolucioni Komunist Kinez*, i huazuar nga europianët, po sipas burimit të njëjtë, ka shkaktuar vdekjen e rreth 29 000 000 njerëzve në Kinë.

Zbingiev Brzhezhinski konkludon se “shifrat e mësippërme të vdekjeve totale nuk mund ta përbajnë dhe, duke pasur parasysh përmasën e tyre, mendja njerëzore as nuk mund ta marrë me mend, dëmin e shkaktuar dhe çoroditjen morale që u përfuan në kataklizmat binjake të shekullit XX: në luftërat e tij masive dhe në revolucionet totalitare. Gjatë dy luftërave botërore, Evropa, djepi i qytetërimit perëndimor, ka qenë subjekt i më shumë se dhjetë vjet shkatërrimesh të vazhduara dhe vrasjesh masive”.¹⁸

Kështu shtylla judeo-kristiane e qytetërimit perëndimor është përgjakur që nga gjeneza e saj dhe ka prodhuar tragjedi të panumërtë në vetë botën kristiane. Ky ka qenë rezultati logjik i devijimeve drastike që janë bërë ndaj figurës dhe misionit të Isait a.s., birit të Merjemes, me çka hebrenjtë dhe të krishterët kanë ardhur në konflikt, e pastaj edhe vetë të krishterët ndërmjet vete. Mburrja me një trashëgimi të tillë të përgjakshme flet në të mirë të faktit se akoma nuk është kuptuar gabimi fatal që është bërë ndaj të dërguarit të Zotit, Isait a.s., të birit të Merjemes, dhe misionit të tij në mesin e njerëzve. Mungesa e vullnetit për të bërë korrigimin e gabimit, e mbuluar nga mburrija arrogante për gjoja epërsinë e qytetërimit perëndimor dhe nga përpjekjet që të imponohet

¹⁷ Zbigniew Brzhezhinski, *Jashtë kontrollit*, Elena Gjika, Tiranë, 1995, fq. 26.

¹⁸ Po aty.

me dhunë një sistem vlerash i ndërtuar mbi themelet e devijimit të rëndë, është tipari kryesor i frysë së ashtu-quajturit *Rend i Ri Botëror* me globalizmin si ideologji të re neoimperiale.

Dhuna e inicuar nga idetë e rebeluara ndaj programit hyjnor

Dhuna e shekujve të fundit, veçmas dhuna e tmerrshme e shekullit XX, më shumë ka qenë e motivuar nga idetë dhe ideologjitet që nuk kanë pasur baza fetare, por që kanë qenë shpikje e vetë mendjeve të njerëzve. Megjithatë, autorët perëndimorë nuk arrijnë ta zbërthejnë shkakun themelor të këtij çrregullimi global që i ka ndodhur qytetërimi të tyre dhe që ka marrë me miliona jetë njerëzore duke lënë prapa vetes edhe shkatërrime materiale të llahtarshme. Ata nuk arrijnë të shpjegojnë se kjo është pasojë e shmangies nga feja, nga programi hyjnor. Shmangia e perëndimorëve nga feja monoteiste dhe ndërlidhja më e fortë me anën e konceptimeve humaniste me botën e mitologjive politeiste antike greko-romake, shkaktoi eksplodimin e ideve të llojillojshme të njerëzve, të ngjizura me ambicie për pasuri materiale, për pushtime territoresh, për zhdukje të popujve “me shkallë më të ulët të qytetërimit”, gjithë kjo në bazë të kualifikimeve raciste, nacionaliste dhe komuniste. Këto projekte dominimesh, pushtimesh dhe zhdukjesh të popujve, mundësuan një zhvillim enorm në planin ekonomik, ushtarak dhe teknologjik të popujve fitimtarë, të cilët i shfrytyrojnë dhe i shfrytëzojnë resurset e pasurive të botës sipas interesave të tyre. Por, kjo përparësi e tyre në planin material, nuk solli edhe një shkallë më të lartë

të iluminimit kulturor, moral dhe shpirtëror. Përkundrazi, pikërisht në këto shoqëri u shfaqën probleme të mëdha kulturore, morale dhe shpirtërore që mezi përballohen. Në këto plane, eksplodimi i ideve të shkëputura nga programi hyjnor solli degjenerime marramendëse, siç është revolucioni seksual, dobësimi i institucionit të familjes, persversiteti ekstrem në formën e homoseksualizmit e të lejzbekërisë, depresioni masiv dhe preokupimi vetëm me anën hedoniste të jetës së kësaj bote.

Që këtu, edhe dëmet e prodhua në planin kulturor dhe artistik, janë po aq të pallogaritshme. Në njëren anë komunizmi, i bazuar në idetë materialiste-ateiste, e prodhoi doktrinën e realizmit socialist, e cila ia zuri frymën lirisë së shprehjes dhe kreativitetit artistik, kurse po ky komunizëm në shkencë e promovoi marksizmin si teori e cila ishte ideologjikisht përjashtuese ndaj të gjitha teorive të tjera dhe ishte tërësisht dogmatike në interpretim. Në Perëndim, pluralizmi ekstrem stilistik, i ndërtuar mbi eksplodimin e ideve të shkëputura nga programi hyjnor me të cilin është i ngarkuar njerëzimi, solli perversitetin dhe dhunën ngulfatëse në arte, veçmas në kinematografi, si një ushqim të përditshëm helmues për shpirtin e njerëzve.

Nga kjo pamje e përfthuar shumë shpejt dhe shumë shkurt rezulton se historia dhe kultura europiane vërtet kanë qenë të ngjizura për shekuj të tërë me dhunën, si një përbërës i rëndësishëm i tyre. Përderisa në shekujt e hershëm, në Perandorinë Romake, dhuna si përbërës i qytetërimit motivohej nga politikat pushtuese dhe nga ideja që të ruhej paganizmi, në Bizant dhe në një pjesë të Europës mesjetare dhuna u përdor për të imponuar doktrina fetare që po ashtu ishin deformuar nga mendja dhe nga interesat tokësore të njerëzve. Më vonë, pas fitores së humanizmit mbi dogmat kishtare të mesjetës, filloj periudha e ideve dhe e projekteve të dhunshme që u in-

tegruan në konceptet politike, kulturore dhe qytetëruese perëndimore, duke qenë kështu tërësisht të shkëputura nga programi hyjnor. Si të tilla, ato sollën relativizimin moral dhe varfërimin shpirtëror, si një tagër të rëndë për përparimin enorm material, i cili u realizua me anë të pushtimeve, kolonizimeve, plaçkitjeve, shfarosjeve të popujve dhe dominimit ushtarak në botën e sotme.

Nëse rikthehem te teza e Armanskit sipas të cilës “njerëzimi asnjëherë nuk ka prodhuar një potencial të tillë shkatërrues, por në të njëjtën kohë, pikërisht për shkak të këtij potenciali, edhe një qytetërim shumë të suksesshëm”, sërisht do të gjëjmë hapësirë për diskutimin e kësaj çështjeje në një dritë tjeter. Pra, është evidente se qytetërimi perëndimor, i bashkëdyzuar me dhunën si instrument të vetin, ka njojur një zhvillim material të jashtëzakonshëm. Neve na duket se suksesi i këtij qytetërimi ka ndodhur për arsyet se idetë mbi të cilat është ngritur ky qytetërim i mundësojnë atij përparim në të gjitha fushat materiale, ngase veprimet janë të liruara nga respektimi i programit hyjnor me të cilin Zoti e ka obliguar njeriun të jetojë e të veprojë derisa të gjendet në tokë si mëkëmbës i Tij. Abuzimi i njeriut me këtë dhundi të dhënë nga Krijuesi i Botëve është evident. Ai i ka shfrytëzuar aftësitë që ia ka dhënë Krijuesi, por ka hequr dorë nga falënderimi ndaj Tij dhe nga respektimi i rregullave me të cilat Zoti e ka ngarkuar me shpalljet hyjnore. Njeriu që e ka farkuar këtë qytetërim, ia ka mbushur mendjen vetes se ai është qëllim në vetvete, qëllimi final i ekzistencës dhe se kjo botë është e vetmja në të cilën njeriu ekziston si qenie. Perandorët romakë e bizantinë e mendonin veten si zota në tokë dhe bënin çfarë t'u shkrepte në mendje. Këtu diku arritën edhe ideologët e humanizmit që sajuan ide të shumta, sipas të cilave njeriu në procesin e evolucionit ka mbërritur në formën

e tashme dhe veprimet e tij në procesin e mbijetesës, duke përfshirë edhe mposhtjen e natyrës dhe dominimin, janë moralisht të lejueshme. Idetë e shkëputura nga shpalljet hyjnore, madje të kundërvëna ashpër ndaj tyre, sikundër janë idetë komuniste, fashiste dhe antisemitiste, kanë motivuar një seri veprimesh që janë bërë të dhunshme, agresive dhe skajshmërisht barbare. “Darvini te *Prejardhja e njeriut* pohon se qytetërimi e prish popullsinë, sepse ai e kufizon përgjedhjen natyrore. Popujt e egër i lënë më të pazotët të vetasgjësohen, ndërsa popujt e qytetëruar nuk i favorizojnë më të fortët: këtu lufta është në favor të të dobëtëve, feja i sterilizon mendjet më të mira, ndërsa mjekësia i shpëton tuhafët. Darvini pranon gjithsesi se njëfarë përgjedhjeje ushtrohet ende, por ajo është e pamjaftueshme. Zgjidhja e arsyeshme do të ishte sigurisht nëse rivendosej një lloj përgjedhjeje”.¹⁹

Është e qartë se darvinizmi edhe në këtë rast paragjet bazë të tmerrshme ideologjike për shfarosjen e njerëzve dhe të popujve. Ndërlidhja e ideve të *Mein Kampf* dhe e praktikave shfarosëve të nazistëve të Hitlerit me këto ide të Darvinit, duket evidente.

Shikuar nga aspekti i natyrës në të cilën është formësuar qëndrimi arrogant i shteteve përfaqësuese të qytetërimit perëndimor ndaj qytetërimeve të tjera, kjo është krejt e kuptueshme, sepse një dhunë që ushtrohet me mijëra vjet dhe që ka përpunuar ide për dominim, seleksionim e shfarosje të popujve e të qytetërimeve të tjera, është shndërruar në vlerë morale dhe kulturore. Një qytetërim që bazohet në idetë e dhunshme që burojnë nga e drejta romake, nga traditat kulturore antike greke, që bazohet në glorifikimin e dhunës dhe të krimit (këngët homerike, tragjeditë antike greke) nga ekskluziviteti i

¹⁹ Shantal Milon Delsol, *Idetë politike në shekullin XX*, Onufri, Shtëpia e Librit, Tiranë, 2000, fq. 109.

Kishës dhe nga favoret që i ka krijuar pozita e kolonizatorit, nuk mund të heqë dorë vetveti nga ushtrimi i dhunës dhe nga vlerësimi i saj si pjesë përbërëse e kulturës së vet në raport me të tjerët. Dhe, meqë ky model është rrënjosur më shumë se dy mijë vjet dhe u ka sjellë atyre të mira të dukshme materiale, është afër mendsh se ata do të vazhdojnë ta mbajnë simbiozën e dhunës dhe të kulturës e të progresit, derisa të jetë kjo e mundur. Pra, nga aspekti moral nuk mund të pritet ndonjë reflektim nëse nuk ndodh një ndryshim themelor në tërë konstruksionin ideologjik dhe filozofik mbi të cilin është ngritur fuqia materiale e këtij qytetërimi. Përkundrazi, fuqia e koncentruar i ka bërë që dhunën ta legjitimojnë edhe me akte të së ashtuquajturës të drejtë ndërkombëtare duke e përdorë si instrument legjitim politik, gjeopolitik, ekonomik, kulturor dhe madje edhe fetar.

Po të varej kjo punë ekskluzivisht vetëm prej aktorëve që e legjitimojnë dhunën si pjesë të rëndësishme të kulturës dhe të historisë se tyre, as që do të mund të shpresonim se ndonjëherë do të hiqnin dorë prej saj pënderisa ajo jep rezultate. Por, mrekullia e Krijuesit të botëve edhe në këtë rast shpaloset në mënyrë të shkëlqyer. Aty ku arroganca njerëzore synon t'i sfidojë ligjet e Krijuesit, fillon edhe akti i disfatës së saj. Prandaj, edhe janë shkatërruar Roma antike, Kartagjena, Greqia antike, Bizanti, Gjermania naziste dhe Bashkimi Sovjetik. Në shkatërrimin e tyre ka një vulë të qartë të Fuqisë Hyjnore. Po të varej jetëgjatësia dhe fuqia e tyre vetëm prej kalkulimeve njerëzore, ato perandori e shtete do të vazhdonin të lëshonin hije mbi dhë e të ushtronin dhunë mbi njerëz edhe shumë kohë. Por, krimet e shtresuara nga përdorimi i dhunës dhe nga vlerësimi i dhunës si mjet legjitim politik dhe si model kulturor e moral, shkaktojnë “gabime strategjike” nga të cilat fillon edhe shpërbërja

dhe shkatërrimi i tyre i pandalshëm. Po të rikthehem i edhe njëherë te Roma, Greqia antike, Bizanti, Gjermania naziste dhe Bashkimi Sovjetik, do të shohim qartë se aty ka një përsëritshmëri perfekte të zvetënimit, rënies e shpërbërjes së perandorive e shteteve në periudhat kur ato e taprojnë me arrogancë dhe me krimë ndaj njerëzimit. Fjala vjen, Romën antike filluan ta shkatërrojnë vetë perandorët e degjeneruar e të çmendur romakë, të cilët vetëm e pasonin njëri-tjetrin. Mjafton vetëm ta shikojmë këtë rend të tyre: Kaligula (12-41 pas Isait a.s.) ishte po-thuajse i çmendur. Ai shkoi aq larg me marrëzirat e tij, sa e shpalli senator edhe kalin e vet. Përfundoi tragjikisht, ngase kundërshtarët e vranë. Neroni (37-68 pas Isait a.s.) sundoi në vitet 54-68. Edhe pse e pati si këshilltar një dijetar si Seneka, Neroni qe i pandalshëm në marrëzitë dhe në krimet e tij: ai e vrau edhe nënën e vet, Agripinën dhe gruan e tij, Oktavinë. Ambicia e tij ishte që ta imitonte Aleksandrin e Madh dhe kjo i kushtoi Romës me shumë luftëra në Armeni e në Etiopi, por pa rezultate. Neroni shkoi aq larg, sa e dogji edhe vetë Romën për të krijuar pretekst për ndjekjen e të krishterëve. Në fund Neroni e vrau edhe veten, duke lënë një testament po ashtu makabër “Ç'artist po humb bota!”. Kur jemi këtu, na parashtrohet pyetje: “A mund të jetë rastësi kjo tatëpjetë dhe ky degjenerim i Perandorisë Romake, apo ishte një ndëshkim hyjnor për atë që deshi ta bëjë pushteti romak ndaj Isait a.s. dhe për ndjekjet e egra që ua bënte Roma besimtarëve të krishterë, pasuesve të Isait, a.s.?”. Të krishterët e asaj kohe ishin të varfër dhe të pafuqishëm, ashtu që ata me fuqinë e tyre nuk do të mund ta ndryshonin qëndrimin e perandorëve romakë, por edhe në këtë rast veproi Vullneti Hyjnor, i cili bëri që pushteti i perandorëve të degjenerohej, të dobësohej e të shkonte drejt fundit. Transferimi i selisë së Perandorisë Romake

nga Roma në Kostandinopojë, nga perandori Konstantin, i cili edhe e legalizoi krishterimin si fe monoteiste, është epilogu i ngjarjeve të zhvilluara sipas Vullnetit Hyjnor i cili dhunën e ka ndaluar rreptësisht:

Allahu urdhëron drejtësi, bamirësi, ndihmë të afërmve, e ndalon nga imoraliteti, nga e neveritura dhe dhuna. Ju këshillon ashtu që të merrni mësim. (Kur'ani, en-Nahl: 90)

Edhe pse Konstandini e arsyetoi transferimin e selisë së Perandorisë sipas një ëndrrë të cilën e komentuan si mesazh hyjnor, ai nuk arriti ta kuptonte të vërtetën e plotë të Vullnetit Hyjnor. Konstandini ishte përkrahës edhe i doktrinës fitimtare të Koncilit të Nikesë, ku u bë devijimi drastik lidhur me natyrën e Krishtit (Iait a.s.). Megjithatë Perandoria Romake e Lindjes (Bizanti) do të mbahej në këmbë e do të zhvillohej në një Perandori të jash-tëzakonshme për shekuj të tërë, derisa nuk u ballafaqua edhe ajo me testin e Vullnetit Hyjnor, ashtu si perandorët romakë shtatë shekuj para Herakleut. Ky i fundit e refuzoi thirrjen e të dërguarit të fundit, Muhamedit a.s., për t'i braktisur shtrembërimet drastike doktrinare e për të pranuar shpalljen e fundit, përkatësisht Islamin si fenë e vërtetë. Njëherit refuzimi i tij rezultoi me fillimin e një periudhe të errët të perandorëve bizantinë, të cilët i kapi çmenduria e pushtetit, e egërsisë dhe e kimeve monstruoze, të papara deri atëherë në histori. Edhe në këtë rast është i qartë ndëshkimi i Vullnetit Hyjnor. Bile, edhe fitorja e muslimanëve ndaj ushtrisë bizantine, e cila ishte shumëfish më e madhe në numër dhe shumë më e armatosur, e ka shpjegimin te Vullneti Hyjnor i cili i ndëshkon dhunesit dhe arrogantët dhe i shpërbulen punëmirët.

Përputhja e fillimit të rënies së Perandorisë Romake dhe të asaj të Bizantit me arrogancën dhe dhunën e treguar ndaj Isait a.s. dhe ndaj besimtarëve të krishterë, siç është refuzimi i pranimit të Islamit, është një argument i

qartë i ndikimit vendimtar të Vullnetit Hyjnor në punët e kësaj bote, përkatësisht në ndëshkimin e atyre që bëjnë dhunë dhe që i mohojnë ligjet e Allahut.

Po e njëjta gjë mund të argumentohet edhe në rastin e disfatës së Gjermanisë naziste dhe të shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik. Hitleri e vau veten po si Neroni dhe e la pas vetes një shtet e një komb të shkatërruar, të poshtëruar e të pushtuar. Edhe Lenini dhe pasuesi i tij, Stalini, krijuan një shtet kolosal të dhunës, i cili e tmerroi botën për më shumë se gjysmë shekulli, por edhe ai u shpërbë dhe u poshtërua në sytë e botës.

Vetëm kolonizatorëve nuk u ka arritur fatura për dhunën që e kanë ushtruar ndaj popujve të kolonizuar, ndaj të cilëve kanë kryer krimet e shumta deri edhe në çrrënjosje fizike të disave prej tyre. Mjafton të kujtohen këtu popujt që jetonin në Amerikën e sotme Jugore, të cilët iu nënshtruan shfarosjes nga kolonizatorët spanjollë dhe portugezë. Po ashtu nuk mund të shmanget nga kujtesa edhe dhuna që e kanë ushtruar kolonizatorët në Amerikën Veriore, ku praktikisht e zhdukën popullsitet autoktone. E njëjta gjë ka ndodhur edhe në Australi dhe në Zelandën e Re. Dhuna e kolonizatorëve ka qenë e madhe edhe në Afrikë, në Azi e kudo tjeter, ku ka shkelur këmba e tyre. Krimet monstruoze të kolonizatorëve në sheku i XVI-XX në të shumtën e rasteve janë bërë në emër të Kishës, në emër të krishterimit, pra të thirrjes për konvertim fetar. Edhe pse në prapavijë gjithmonë ka qenë e pranishme ideja e dominimit dhe e shfrytëzimit të pasurive të vendeve të pushtuara, ideologjia fetare është përdorur si arsyetim për dhunën dhe krimet e kryera në emër të qytetërimit perëndimor. Fiset dhe popujt që iu nënshtruan kësaj dhune dhe kësaj shfarosjeje, e kishin humbur lidhjen me programin hyjnor që është obligim i të gjithë njerëzve. Ata kishin përqafuar lloj-lloj ritualesh

pagane, politeiste e sataniste, me çka devijimin e kishin bërë fatal për veten e tyre. Ata me shekuj kishin jetuar brenda disa ritualeve të çmendura, pa e ndjerë nevojën e zhvillimit kulturor e ekonomik, pa e kuptuar se njeriu, përveç ushqimit material, ka nevojë edhe për ushqim shpirtëror, për ngritje morale dhe për lidhje të përhershme me Krijuesin e tij, Zotin e botëve. Këto fise dhe këta popuj primitivë ishin shndërruar në komunitete pa vlera njerëzore të mirëfillta që burojnë nga lidhja e njeriut me programin hyjnor. (Gabimi i antropologëve perëndimore, të cilët për ta shpjeguar evolucionin e njerëzimit nga një gjendje e ulët primitive drejt progresit, u bazuan në gjendjen e këtyre fiseve dhe popujve primitivë, është jashtëzakonisht i rëndë. Ata e morën gjendjen e atyre fiseve dhe popujve si të ishte ligjësi e zhvillimit të tërë njerëzimit, duke e injoruar faktin se njerëzimi ka ndjekur rrugë tjetër të zhvillimit - duke u bazuar në lidhjen me Zotin me anë të shpalljeve dhe të të dërguarve, si dhe duke e zbatuar programin hyjnor që ishte rezervuar për ta. Por, kjo mund të jetë një temë më vete). Megjithëse shkatërrimi dhe zhdukja e këtyre fiseve dhe popujve primitivë është evidente, ajo nuk mund të kuptohet vetëm me interpretimin materialist të fakteve që thonë se ata ishin më të dobët ushtarakisht, ekonomikisht dhe kulturalisht dhe prandaj nuk arritën t'u bënin ballë sulmeve të kolonizatorëve. Ka shembuj jo të paktë në histori, kur fise dhe popuj më të dobët ushtarakisht, ekonomikisht dhe kulturalisht, i kanë zmbrapsur mësymjet e pushtuese. Bile ka raste kur edhe kanë fituar luftëra kundër armiqve që në dukje kanë qenë shumë më të fuqishëm. Fitoret e muslimanëve kundër mushrikëve (idhujtarëve) në Bedër, kundër Persisë dhe kundër Bizantit, në shekullin e parë të Islamit, janë argument i pakundërshtueshëm në këtë aspekt.

Besoj se ajo paaftësi e fiseve dhe e popujve primitivë kundër kolonizatorëve europianë, ka ndodhur për arsyen se ata kanë qenë paganë, politeistë, e rrjedhimisht mëkatarë të pafalshëm për faktin se nuk e kanë njohur mbi vete autoritetin e Krijuesit. Allahu ka shpallur qartë:

“Po ashtu (sikur u dbamë xhinve dbe njerëzre përjetim), Ne i bëjmë sundues disa mizorë mbi mizorët e tjerë për shkak të asaj që fituan (repruan)”. (Kur’ani, el-En’am: 129)

Besoj se atyre u ka ardhur ndëshkimi nga Zoti i botëve pikërisht për shkak se kanë shkuar larg në degjenerim dhe në humbje të natyrës njerëzore, të cilën Krijuesi e ka bërë të jetë e lartë, ashtu si i takon atij që Zoti e ka caktuar si zëvendës të vetin në tokë. Rënia dhe degjenerimi i disave prej këtyre popujve kishte shkuar aq larg, sa ata në ritualet e tyre i flijonin njerëzit e gjallë, sikundër kanë bërë inkët dhe actekët. Ata kanë ngritur dorë ndaj krijesës së Allahut, duke e dhunuar jetën e saj dhe duke e bërë krimin në emër të disa ritualeve magjike, idhujtare, që në fakt kanë qenë aktivitete djallëzore. Teprimi që e kanë bërë ata me injorimin e plotë të programit hyjnor dhe teprimi në krimet e bëra ndaj krijesave të Zotit, u është kthyer atyre si ndëshkim nga Krijuesi i botëve. Përndryshe, kjo nuk e arsyeton krimin e kolonizatorëve dhe asnjë krim tjetër, sepse Zoti ka shpallur qartë në ajetin 205 të sures el-Bekare, në fjalinë e fundit të të cilit thuhet:

E Allahu nuk e do çrrregullimin

Duke i shikuar përvojat e ushtrimit të dhunës nëpër histori dhe duke e parë se dhuna është vlerësuar dhe po vlerësohet si mjet legjitim politik, madje edhe si vlerë, pavarësisht shembujve të qartë dhe përvojave të hidhura që kanë dalë nga kultura dhe nga politika e ngjizur me dhunë, shtrohet pyetja elementare: “Si ka qenë dhe si është e mundur të gjenden arsyetime për dhunën dhe dhuna të vlerësohet si pjesë e rëndësishme e progresit të

qytetërimit konkret?”. Përgjigja është po ashtu elementare: “Kjo ka qenë dhe është e mundur për arsyen se ka një çrrëgullim drastik të historisë së njeriut dhe të njerëzimit”. Duke u larguar nga mësimet e vërteta hyjnore, duke i devijuar ato sipas interesave koniunkturale dhe duke mos i pasuar mësimet dhe shembujt e të dërguarve të Zotit, njerëzimi ka ecur një rrugë të cilën e ka sajuar vetë sipas interesave dhe ambicieve në tij për vetërealizim maksimal në këtë botë. Ky devijim drastik ka arritur deri aty sa edhe udhëzimet hyjnore dhe shembujt e të dërguarve të zëvendësohen nga ideologjitetë agresive dhe nga bëmat e “figurave të mëdha historike”, të cilët kanë qenë simbole të ekspansioneve, të agresioneve, të push-timeve, të kolonizimeve dhe të shfarosjeve të popujve të tjera ose të kundërshtarëve ideologjikë. Një histori e bazuar në këto modele, të ambicieve për vetërealizim vetëm në këtë botë, si finalizim i ekzistencës dhe mbështetjes në modelet e personave që janë treguar më arrogante në realizimin e projekteve fitimprurëse, është një histori e devijuar dhe prej andej ajo prodhon edhe moral, kulturë dhe ideale të deformuara. Një qytetërim i tillë e arsyeton dhunën si instrument për arritjen e qëllimeve. Nuk është e rastësishme që Makiaveli ka gjetur një formulim të saktë për këtë kulturë dhe këtë qytetërim kur është shprehur se “Qëllimi e arsyeton mjetin”. Pra, sipas kësaj formule që është vënë në themel të politikës, të diplomacisë dhe të kulturës perëndimore, nëse ke për qëllim ta shfrytëzosh naftën në Arabi, është e arsyeshme ta përdorësh dhunën për pushtimin e atyre territoreve, kolonizimin e atyre popujve dhe shfrytëzimin e pafund të atyre resurseve.

Megjithëkëtë, edhe arroganca e bazuar në formulën sipas së cilës qëllimi e arsyeton mjetin, i ka kufijtë e saj përtej të cilëve nuk depërtton. Allahu na ka paralajmëruar qartë

lidhur me demagogjinë e dhunuesve të paqes në tokë, sepse kur atyre u tërhiqet vërejtja, ata thonë se po angazhohen për përmirësimin e gjendjes, e jo për shkatërrim:

Kur atyre u thuhet: Mos prishni rendin në tokë! Ata thonë: Ne jemi vetëm përmirësues (paqtues)! Veni re, ata në të vërtetë janë shkatërruesit, por nuk e kuptojnë. (Kur'ani, el-Bekare: 11,12)

Edhe ky moskuptim i tyre e ka shkakun te shkëputja e tyre prej udhëzimeve hyjnore dhe prej mësimeve të të dërguarve të cilët e kanë sjellë ndër njerëz mesazhin e paqes e të devotshmërisë.

Zoti na ka njoftuar me saktësi edhe për mirëqenien dhe fuqinë e përkohshme të dhunuesve e të çrregullueseve. Atyre u janë hapur dyert e begative dhe ata mashtrohen pas tyre, derisa të humben krejtësisht në atë ambicie të shfrenuar, derisa t'u arrijë ndëshkimi.

Meqë lanë pas dore atë me çka u këshilluan, (t'i drejtoben Zotit), Ne ua hapëm dyert e çdo gjëje (begatie) deri sa kur u gëzuan për atë që ju kishte dhënë, i kapëm befas e ata mbeten të zhgënjer. (Kur'ani, el-En'am: 44)

Pra, fuqia e bazuar në dhunë e në çrregullim, vetëm i thellon zbatuesit e saj në mëkate dhe në krime të rënda para se t'u arrijë ndëshkimi. Shembujt që i kemi sjellë nga Roma antike, nga Bizanti, nga Kartagjena, e madje edhe shembujt e kohës së re nga Gjermania naziste dhe Bashkimi Sovjetik, janë mjaft ilustrativë, andaj rrjedhimisht edhe dhunuesit e kohës sonë janë të përkohshëm në këtë botë, sepse i pret fundi dhe ndëshkimi:

“Ata që i përgjenjeshtruan faktet Tona, ata i kap dënimini ngase nuk respektuan normat”. (Kur'ani, el-En'am: 49)

Këto norma dhe ligje të Krijuesit, ku dhuna dhe çrregullimi në tokë ndalohen, janë të përhershme, pra derisa të ekzistojë jeta në tokë. Prandaj qytetërimi që është i bazuar në dhunë ose që dhunën e ka si pjesë të veten të rëndësishme, nëse nuk korrigojhet, nëse nuk

rikthehet në binarët e duhur, trezikohet nga rënia dhe zhbërja. Ata që krekozen se ky qytetërim ka zgjatur shumë, më shumë se dy mijë vjet, shfaqin po atë shenjë të moskomunikimit me logjikën e shpalljeve hyjnore, me të cilat Zoti u ka dhënë mundësi njerëzve që ta vlerësojnë edhe historinë e njerëzimit në këtë botë. Krijuesi i botëve na ka njoftuar se matja e kohës te Sovrani i gjithësisë bëhet ndryshe nga matja që e bëjnë njerëzit. Dy mijë vjet të matjes së kohës nga njerëzit janë të barabarta me dy ditë te Krijuesi i botëve:

Ai është që udhëheq çështjen (e të gjitha krijesave) prej qiellit në tokë, pastaj ajo (çështja) ngihet tek Ai në një ditë që sipas llogarisë suaj është sa njëmijë vjet. (Kur'ani, es-Sexhde: 5)

Pra, fatet e rezervuara për popujt dhe qytetërimet e ardhshme janë fshehtësi, andaj nga gjendja e tashme e raportit të fuqisë materiale nuk mund të kalkulohen. Dhe, mbi të gjitha, është vërtetuar se shtetet dhe qytetërimet që bazohen në dhunë, vijnë në një shkallë kur dhuna u drejtohet vetë atyre me fuqi fatale të cilës nuk mund t'i rezistojnë. Akumulimi i të keqes, që shkaktohet nga dhuna e ushtruar dhe e legalizuar si normë e sjelljes dhe e qytetërimit, e cila zanafillën e ka te përçarja për shkak të qëndrimit ndaj shpalljes së Zotit të gjithësisë, mund t'i përfshijë edhe qytetërimet e tashme, sikundër u ka ndodhur edhe qytetërimet e mëhershme, të cilat kanë qenë të themeluara me dhunë dhe të bazuara në dhunë, për shkak të mohimit ndaj Shpalljes Hyjnore, e cila e dënon dhunën dhe e afirmon paqen. Zgjidhja e vërtetë, atë që Krijuesi i botëve e ka pëlqyer për njerëzimin, është bashkëjetesa e popujve dhe e kulturave të tyre, paqja globale e bazuar në programin hyjnor. Pra, zgjidhja nuk është te globalizimi i dhunës, sikundër pretendojnë të argumentojnë ideologët e *Rendi të Ri Botëror*. Zgjidhja tjetër, e vëtmja e drejtë, është universalizimi

mi i paqes, kjo e bazuar në programin hyjnor me të cilin njerëzimi është i obliguar të jetojë në këtë botë. Pra, zgjidhja fatlume për njerëzimin është paqja globale e bazuar në programin hyjnor të finalizuar në shpalljen e fundit për njerëzimin, në Shpalljen Islame, e jo në idetë e sajvara nga imaginata dhe interesat e njerëzve dhe të grupeve të ndryshme sociale ose kombëtare, që dominimin politik e kulturor, si dhe eksploatimin ekonomik, e kanë qëllim të jetës së tyre.

A po mbetet i pakuptuar mesazhi i Alsajmerit nga ata tē cilëve u drejtohet?

Në vazhdim do tē sjellim një shembull që mund tē shërbejë pér ta kuptuar largimin drastik tē njeriut tē sotëm perëndimor nga tē kuptuarit e pozitës së tij në këtë botë dhe argumentimin e fuqisë hyjnore e cila rregullon gjithçka në këtë botë dhe në gjithësi, përfshirë edhe vdekjen, si një caktim nga Krijuesi i botëve, e cila nuk mund as tē shtyhet as tē negociohet. Në rast se do tē kuptohej drejt mesazhi që e bart vdekja e njeriut, atëherë njerëzimi do tē mund tē reflektonte dhe tē korrigjonte esencialisht botëkuptimin dhe sjelljen e vet, duke e vënë në plan tē parë programin hyjnor e duke e harmonizuar tërë jetën në bazë tē tij.

Më 11 qershor 2004 në Los-Anxhelos u varros ish-presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Ronald Regan, i cili që nga viti 1994 vuante nga sëmundja e Alsajmerit. Sëmundja e rëndë, e cila ia merr njeriut kujtesën dhe gradualisht e shndërron në krijesë tërësisht tē çorientuar në kohë dhe në hapësirë, edhe në këtë rast ishte provë e pafuqisë së njeriut, sado i fuqishëm tē jetë ai, pér tē depërtuar përtej caqeve në tē cilat është kufizuar fuqia e tij. Prandaj, edhe njëri nga presidentët më të fuqishëm dhe më të famshëm të Amerikës, i cili e shpalli luftën e yjeve dhe praktikisht e fitoi Luftën e Ftohtë kundër komunizmit agresiv sovjetik, në dhjetë vitet e

fundit të jetës së tij, e provoi pafuqinë e vet të plotë në raport me sëmundjen dhe me vdekjen që i afrohej krejt e papenguar. Jo vetëm ai vetë, por e tërë mjekësia dhe teknologja e sofistikuar e superfuqisë së vetme të mbetur të fundit të shekullit XX nuk ishte në gjendje ta pengonte përparimin fatal të sëmundjes së ish-presidentit.

Që nga fjala e tij në vitin 1994, kur vetë e informoi popullin amerikan për sëmundjen e vet, Regani jetonte i shmangur ngajeta publike të cilën e kishte pasur në gjak tërë jetën, dikur si aktor e mandej edhe si president. Njeriu që kishte treguar guxim të pashembullt në konfrontimin me “Perandorinë e së keqes”, me militarizmin komunist të Bashkimit Sovjetik, me emrin e të cilit qysh në gjallje të tij ishte emërtuar aeroporti i kryeqytetit të Amerikës, ishte detyruar që ngadalë ta pranonte humbjen e vet nga një sëmundje që po e shtronte dhe po e shpinte drejt vdekjes.

Kjo pafuqi njerëzore që shfaqet edhe te njerëz të fuqishëm, siç ishte ish-presidenti Ronald Regan, dhe siç është shfaqur dhe i ka gjunjëzuar edhe me mijëra mbretër, perandorë, gjeneralë e presidentë të fuqishëm para tij, e cila finalizohet me vdekjen, nuk ka të bëjë me të ashtuquajturin “proces biologjik” si një dukuri më vete. Po të ishte fjala për ndonjë proces të tillë, të rrumbullakësuar në vullnetin e tij vetëm si “proces biologjik”, njerëzimi do të mund të gjente mënyra që në ndonjë fazë të korrigjohej. Por, në rastin e kësaj pafuqie të njeriut, fjala është për një ligj i cili aktivizohet dhe ia rikujton njeriut se është nisur drejt një fundi, drejt vdekjes, e cila është e pashmangshme, pavarësisht se çfarë prestigji ka njeriu dhe çfarë fuqie ka shteti që identifikohet me të. Vetëdija se njeriu është i vdekshëm dhe shkon drejt fundit të jetës në këtë botë, me ndonjë sëmundje që shfaqet vetëm në rolin e “ofruesit të

shërbimit”, e fashitë reagimin që do të mund ta bënte iracional dhe ndoshta të egër fundin e jetës së njeriut.

Pothuajse në të gjitha besimet dhe qytetërimet ekzistojnë shpjegime për vdekjen e cila mundëson kalimin e njeriut nga kjo botë në botën tjetër, në botën e amshueshme. Madje, përshkrimi i zotit të vdekjes dhe i jetës në botën e amshueshme është bërë duke sugjeruar kontinuitetin e jetës së njeriut me detaje të shumta. Në mitologjinë antike greke, e cila është produkt i shkëputjes fatale të njeriut nga mesazhet hyjnore, ka ekzistuar “zoti” i vdekjes, i cili quhej Tanat (në një interpretim Tanati ishte vetë vdekja), detyra e të cilit ishte t'i merrte shpirtrat e njerëzve dhe t'i dërgonte në Had. Edhe sipas kësaj mitologjie, momenti i vdekjes është caktuar nga fati dhe nuk ka mundur të shtyhet.²⁰

Më tutje, vdekja është përshkuar si kalim nga kjo botë në mbretërinë e nëndheshme të Hadit. Kalimi bëhej nëpër lumin Akron, nga varkëtari Haron. Para frontit të Hadit ata i priste gjykimi, në prani të gjykatësve, Minosit, Radamantit dhe Eakut, bijve të Zeusit. Kishte të shpëtuar, të cilët liheshin të kënaqeshin në fushat e Elizësë, kishte të tillë që nuk ishin të shpëtuar e as të dënuar, që bridhnin në fushat e Alfodelit, ndërsa shumica ishin që dënoheshin për veprimet që i kishin bërë gjatë jetës së tyre në botën e sipërme. Edhe pse ky perceptim mitologjik i vdekjes dhe i botës së amshueshme është tmerrësisht i deformuar, ai ka shërbyer për ta amortizuar reagimin e njeriut ndaj vdekjes dhe botës së përjetshme e cila e pret pas saj.

Nga një përshkrim për vdekjen dhe rolin e saj në jetën e kinezëve, që e ka shkruar shkrimitari Niko Kazanzaqi, bëhet i qartë një mister i atij qytetërimi. Ki-

²⁰ Vojçeh Zamarovski, *Heronjtë e miteve antike*, Rilindja, Prishtinë, 1985, fq. 480.

nezët kanë frikë nga i vdekuri dhe bëjnë shumë veprime që ta marrin me të mirë, në mënyrë që ashtu ta qetësojnë shpirtin e tij:

“Nuk i tremben aspak vdekjes, por të vdekurit. Kinezi vetëm pas vdekjes merr forcë të madhe dhe të gjithë të afërmit i tremben si djallit ose si Zotit. Pak para se të përshpirtet, atë e shtrijnë në një copë dërrase dhe e nxjerrin jashtë dhomës, sepse besojnë se shpirti i atij që vdes mbi shtratin e tij, nuk e ndjek trupin, por kapet pas shtratit, orendive, pas mureve, pra e pushton dhomën dhe kështu asnjëri nuk guxon të banojë më tej në atë dhomë. Dhoma duhet të shkatërrohet nga themeli dhe të shkatërrohen orenditë, që ashtu shpirti të shqitet e të largohet”.²¹

Roli që e luajnë të vdekurit në jetën sociale dhe morale të të gjallëve, mbetet aktiv, sepse duhet të ndiqet shëmbëlltyra e paraardhësve për të mos e zgjuar mërinë e shpirtrave të vdekur.

“Zoti i vërtetë i Kinës është vetëm një: paraardhësi. Adhurimi i të parëve – kjo është feja e vetme e vjetër e kinezit. Njeriu që zurret në tokë, përfton forca të rrezikshme, andaj duhet ta marrim me të mirë që mos të na mposhtë. Vetëm një është ai që mund të ndërmjetësojë: biri. Biri duhet çdo ditë t'i bëjë flijime lule, ushqime, lutje dhe ta ndjekë me besnikëri shembullin e tij në jetë.” Pra, sipas këtij interpretimi, vdekja më shumë ka të bëjë me këtë botë, me të gjallët, e jo me botën tjeter dhe përgjegjësinë e njeriut para Krijuesit.²²

Më duket e pabesueshme, por nga një rilexim i disa kapitujve më kryesorë të Biblës, që i kam bërë enkas për këtë rast, nuk kam gjetur ndonjë paragraf që bën fjalë për vdekjen e njeriut si vullnet dhe caktim i Zotit, për kalimin e njeriut të vdekur në botën tjeter dhe për për-

²¹ Niko Kazanzaqi, *Letërsia e udhëtimeve, Shekulli*, 2004.

²² Po aty.

gjegjësinë që e pret krijesën njerëzore para Krijuesit të vet. Në *Librin e Zanafillës* përmendet vdekja e Jakobit dhe e Jozefit, por vetëm në kontekstin e porosive për punët e kësaj bote:

“Atëherë ua dha këtë urdhër: ‘Së shpejti do të bashkohem me popullin tim. Më varrosni me etërit e mi në shpellën Makpelë, që gjendet në anën e Efron Heteut, kundruall Mambresë, në dheun e Kananit, të cilën e bleu Abrahami, me gjithë arë prej Efron Heteut, si pronë për varreza’”.²³

Edhe në *Librin e numrave* përmendet vdekja e Aronit (Harunit), por as kësaj radhe nuk sugjerohet kalimi në botën e amshueshme, por figurativisht thuhet se po bashkohet me popullin e tij.

Vetëm në *Librin e psallmave*, që është poezi lirike dhe sigurisht vepër e ndonjë poeti, gjenden disa vargje që e tematizojnë daljen në gjyq të të paudhëzuarve:

*Jo kështu jo, s'do t'u ndodh të paudhëve,
por ata janë porsi byku që e shpérndan era.
Prandaj të paudhët s'do t'i bëjnë ballë gjyqit
As mëkatarët bashkimit të të drejtëve!
Sepse Zoti e di udhën e të drejtëve,
kurse udha e bakëqijve do të mbarojë.*²⁴

As në të katër ungjiftë (të Mateut, të Markut, të Llukës e të Gjonit) nuk ka tematizim teologjik për vdekjen e njerëzve dhe për botën e amshueshme ku i pret gjyqi i Zotit të tyre.

Vërtet, pa këtë njoftim për jetën dhe vdekjen si vullnet të Zotit dhe pa njoftimin inicial për jetën në botën e amshueshme, për parajsën dhe për ferrin që i presin njerëzit, sipas punëve që i kanë kryer vetë, një shpallje kurresi nuk mund të quhet e kompletuar. Mbetet të studiohet se sa ndikon në stimulimin e dhunës së njerëzve pi-

²³ *Bibla*, Drita, Ferizaj, 1994, fq. 78,79.

²⁴ *Bibla*, fq. 660.

kërisht kjo mungesë në Bibël e shpalljeve për vdekjen dhe përgjegjësitë që e presin njeriun në botën tjetër. Besojmë se mungesa e urdhraleve, e porosive dhe e ndriçimit të fakteve për atë që e pret njeriun pas vdekjes ka një rol stimulues në papërgjegjësinë e njerëzve që formohen pa i marrë këto urdhëresa e porosi hyjnore. Po të mos jetë i mishëruar në njeriun frikërespekti ndaj Zotit, ai mund të jetë arrogant, agresiv dhe i dhunshëm ndaj atyre që janë më të dobët se ai. Në ato rrëthana ai nuk ngurron që t'ua uzurpojë edhe të drejtat e t'ua eksploratojë pasuritë njerëzve të tjerë dhe popujve të tjerë.

E vërteta për këtë shprehet në shpalljen përfundimtare që Allahu, sunduesi i vetëm i botëve, ia shpalli njerëzimit. Aty vdekja shpallet qartë si moment që është caktuar paraprakisht dhe që ndodhë vetëm e vullnetin dhe me lejen e Krijuesit dhe Sunduesit të botëve.

“Askush nuk vdes pa vullnetin dhe lejen e Allahut. Ai është shënim i afatit të caktuar. E kush e dëshiron shpërbimin e kësaj bote, Ne Atij ia jafim, e kush e dëshiron shpërbimin e botës tjetër, edhe atij do t'iia jafim atë, kurse mirënjobësit do t'i shpërblojmë.” (Kur’ani, Ali Imran: 145)

Ndërkaq, lidhur me botën tjetër, përshkrimi është në relacion me këtë botë dhe duke e sugjeruar epërsinë e ahiretit ndaj kësaj bote, me çka pa dyshim edhe ndodh ndikimi në reagimin pozitiv të besimtarit ndaj vdekjes:

“Kjo jetë e kësaj bote nuk është tjetër vetëm se dëfrim e lojë, e jetë e vërtetë, pa dyshim është ajo e botës së ardhme (ahiretit), sikur ta dini”. (Kur’ani, el-Ankebut: 64)

Të kuptuarit e vdekjes si caktim të fundit të njeriut në këtë botë dhe si kalim në botën tjetër, mund të jetë në proporcion edhe me shterjen e energjive fizike dhe intelektuale, të cilat e jepin sinjalin e qartë të përparimit të vdekjes mbi jetën. Një trup i dërrmuar me një kujtesë që turbullohet gjithnjë e më shumë, e jep mesazhin se

më nuk është i aftë ta përballojë ritmin e punëve e të ambicieve që shpalosen nga individi. Ky vetëdijësim ose ky rikujtim e krijon kornizën e re në të cilën individi i caktuar do të gjallojë me realitetin e ri i cili e shpie drejt fundit në këtë botë. Një fjalim lamtumirës si ai i Ronald Reganit në vitin 1994 është vetëm paraqitje autentike e këtij ndryshimi dhe e pajtimit të njeriut me rrugën e re drejt fundit jetësor në këtë botë. Por, vdekja i gjen njësoj edhe njerëzit e rinj që nuk vuajnë nga sëmundje që ua shterin energjitet. Të gjallët habiten nga vdekje të tilla të papritura dhe, nëse nuk besojnë se ai është caktim i Zotit, përpiken kot t'i hamendësojnë shkaqet e vdekjes.

Pse pajtohet njeriu kaq lehtë, ashtu që edhe më i fuqishmi me këtë zhvillim e ngre lart flamurin e bardhë me dorën e vet? Përgjigjja është krejt e thjeshtë dhe e kuptueshme nga të gjithë: njeriu nuk është i vetëkrijuar dhe nuk posedon fuqi të tjera, përveç atyre që i jepen në dispozicion dhe për një afat të caktuar. Meqë nuk është i vetëkrijuar (dhe as produkt i një procesi biologjik si qëllim final në vetvete), ai nuk e ka në dorë as korrigimin e defektit që shfaqet në formë të sëmundjes e as nuk mund ta shmang rrugën që e shpie drejt vdekjes. Pra, njeriu është i krijuar, e jo i vetëkrijuar. Është i krijuar në bazë të një Vullneti jashtë tij:

E kur ta përsosë atë (në formën e njeriut) dbe do t'i japë atij shpirtin që është kriesë Imja, atëherë ju bini atij në sexhde. (Kur'ani, el-Hixhr: 29)

Pra, ky Vullnet krijues jashtë njeriut, e ka krijuar dhe përsosur krijesën njerëzore dhe i ka krijuar ligjet brenda të cilave ky krijim do të përsëritet. Rrjedhimisht, as prindërit nuk janë në rolin e krijuesit të krijesës njerëzore, sepse ata edhe kur e kanë për qëllim që me kontaktin e tyre seksual të shkaktojnë lindjen e një pasardhësi, nuk e dinë momentin e ngjizjes, nuk e dinë me cilën pjesë të

farës pason ajo ngjizje, nuk e dinë gjininë e frytit të kontaktit të tyre, nuk e dinë fizionominë që do ta ketë krije-sa e re njerëzore, nuk e dinë as çfarë fati jetësor dhe çfarë jetëgjatësie do të ketë dhe, aq më tepër, ata nuk mund t'ia japid shpirtin asaj krijese. Prindërit i marrin të gjitha këto informacione në mënyrë retroaktive, pasi të kenë ndodhur ose pasi të jenë shpërblyer me lindjen e fëmijës. Nëna e bartë frytin në barkun e vet, por as ajo nuk e ka idenë për të gjitha proceset që kanë të bëjnë me fëmijën e saj të ardhshëm.

Secila kriesë njerëzore, në fakt, është e lindur sipas një sistemi të shpallur jashtë saj:

Allahu ju nxori nga barjet e nënave tuaja (si foshnje) që nuk dinit asgjë. Ju pajisi me (shqisat për) të dëgjuar, me të parë dhe me zemër, ashtu që të jeni falënderues. (Kur'ani, en-Nahl: 78)

Ky Vullnet jashtë njeriut mundëson lindjen, daljen nga barku i nënës dhe pajisjen me aftësitë për të jetuar, pa qenë njeriu i vetëdijshëm për të gjitha këto. Ky Vullnet jashtë njeriut siguron edhe transformimin e materialit në organizmin e prindërve (sperma dhe vezorja kriohen në organizmin e mashkullit dhe të femrës nga materie ushqimore që hyjnë në organizëm si ushqim dhe aty u nënshtrohen proceseve metabolike për të cilat njeriu nuk është plotësisht i vetëdijshëm, por është tërësisht jo-kompetent për orientimin e tyre), e bashkë me këtë edhe kohën e ngjizjes, gjininë, kohën e lindjes, fizionominë, fatin jetësor dhe kohën e vdekjes:

A nuk mendon njeriu se Ne e krijuam atë prej një pikë uji (fare), kur që ai, kundershtari i mëptë. (Kur'ani, Jasin: 77)

Kjo vërejtje që i bëhet njeriut për harresën e tij ndaj prejardhjes së parë, materialit nga i cili është krijuar, e rikonfirmon Vullnetin Krijues, i cili është Sovran i kriimit. Rregulluesi i të gjitha proceseve që ndodhin në organizëm (temperaturës, pulsit, tensionit, përqindjeve të

albuminave, të vitaminave, të yndyrës, etj. etj.,) dhe në synimet e krijesave njerëzore (talenti, fati jetësor, jetëgjatësia, etj. etj.,) është jashtë njeriut. Njeriu nuk i ka caktuar *a priori* shifrat normale të atyre niveleve dhe të atyre përqindjeve, të cilat janë unike për të gjithë njerëzit. Njeriu ka arritur që me studim t'i zbulojë këto shifra dhe përqindje, ka arritur të bëjë korrigjime mjekësore në to, por ligjet nuk i ka krijuar vetë dhe nuk arrin t'i ndryshojë. Njeriu nuk arrin që organizmin e tij ta bëjë të jetë në gjendje normale me tension 200-100 ose me temperaturë 45°C. Përpjekja e tij konsumohet në suksesin që arrin nëse i ruan vlerat normale që janë të programuara në organizmin e njeriut. Merre si ta marrësh, njeriu është i krijuar nga një Vullnet jashtë tij dhejeta e tij në të gjitha nivelet e saj është e rregulluar nga ai Vullnet.

Njeriu edhe kur nuk e di dhe kur nuk e beson plotësisht këtë të vërtetë të varshmërisë së tij nga Vullneti jashtë tij, duket se e ndjen. Ai e ndjen tëhuajësimin dhe pafuqinë, sepse ato imponohen nga Krijuesi, i cili ia ka caktuar prerasi rrugën dhe cakun ku do të përfundojë.

Në rastin e të moshuarve si ishte edhe ish-presidenti Regan, ky rregull është shpallur në këtë aksiomë kur'anore:

E atij që i japim të jetojë gjatë, e kthejmë prapa në krijimin e tij. A nuk janë duke menduar. (Kur'ani, Jasin: 68)

Pra, jetëgjatësia nënkupton edhe shterjen e pashmangshme të fuqive, kthimin në gjendjen e hershme të pafuqisë dhe të infantilitetit. Këtë proces nuk mund ta pengojnë kurrfarë barnash e intervenimesh medicinale. Pra, jo vetëm këto që janë rezultat i të arriturave të kohës së sotme, por as ato të kohërave që do të vijnë. Sepse, për ta korrigjuar këtë ligj, duhet pasur qasje dhe kompetencë në vetë ligjin e krijimit i cili është kompetencë ekskluzive e Allahut. Në atë nivel nuk arrin kurrë mjekë-

sia dhe dija njerëzore, sepse ajo arrin vetëm aq sa ia lejon vetë Allahu.

Me ketë rast duhet përkujtuar se yshtja për të pasur qasje në nivelin e pavdekshmërisë ka ekzistuar qysh nga njeriu i parë. Ademi a.s. dhe e shoqja e tij, Hava, u mashtruan nga yshtja e djallit, i cili u premtoi se mund ta fitonin përjetësinë dhe pushtetin e pazhdukshëm:

Por, atë e ngacmoi djalli duke i thënë: O Adem, a do të të tregoj për pemën e pardekshmërisë dbe të sundimit të pazhdukshëm! (Kur'ani, Ta-Ha: 120)

Përpjekja për të pasur qasje në këto fusha, rezultoi me mashtrimin e tyre nga djalli, me turpërimin e tyre para Krijuesit të tyre dhe me largimin e tyre nga xheneti. Prandaj, secila përpjekje e njeriut që synon përzierjen në fshehtësinë e krijimit, në mënyrë të pashmangshme do të rezultojë me mashtrim dhe me turpërim të njeriut.

Edhe në veprën më të vjetër poetike të gjetur deri sot, Gilgameshin, raporti i njeriut me vdekjen përkatësisht dëshira për ta gjetur barin shërues ndaj saj, përbën idenë themelore të saj, duke prekur ashtu në sferën e gabimit të hershëm të njeriut. Gilgameshi e vajton mikun e tij të vdekur, Enkidunë, për të cilin thotë se “atë e gjeti fati i njeriut”, duke nënkuptuar me këtë se njeriu, me gjithë dëshirën për të jetuar, është i vdekshëm. Megjithatë Gilgameshi nuk pajtohet me vdekjen e mikut të tij, Enkidusë, prandaj niset që ta takojë edhe në botën tjeter, duke u përpjekur që t'i thyejë ligjet e vdekjes. Ai kalon nëpër shumë vështirësi deri sa Nergali pranon ta hapë një zgavër në tokë që Gilgameshi ta shohë hijen e mikut të vet. Gilgameshi i rebeluar kërkon të dijë cilat janë ligjet e botës tjeter:

Hap Gilgameshi gojën dhe i thotë:

“Më thuaj, mik, të lutem, pa më thuaj!

Kumtoma ligjin n'tokë që mbret'ron!”

Por, ndarja e botëve është aq e fortë, saqë Enkiduja detyrohet ta zhgënjejë mikun e tij:

“Ta them këtë kurraqsh nuk mundem mik.

Në qoftë se ta kumtoj ligjin e tokës,

Të cilin e kam parë un’ këtu,

Ti do t’plandolesh edhe do t’vajtosh.”

Pas kësaj Gilgameshi ia kthen me fjalët: “T’plandosem dua, t’vajtoj pérjetë”, ndërsa Enkiduja e bën pérshkrimin më tronditës:

“Vështroje mikun, që ti e pranove

Për të cilin zemra jote u gëzua,

E han’ krimbat si t’ish teshë e vjetër!

Mik, Enkiduj, që dora jote e preku,

Sikurse baltë toke është bërë,

Në pluhur është mbytur krejtësisht,

Prandaj dhe pluhur tash ai është bërë”.²⁵

Me gjithë vendosmërinë e pasembullt, Gilgameshi pérjeton disfatë në kërkimin e tij të mikut të vdekur dhe kthehet në qytetin e vet, në Uruk, i cili ishte i rrethuar me mure të larta mbrojtëse dhe me tempullin e shenjtë që ngrihej lart, në të cilin ai është mbret. Por, pikërisht aty, “vdekja e rrëmbeu n’pallat, n’sallën e ndritshme”.

Edhe pse një rrëfim poetik që është shumë i deformuar në raport me Shpalljen Hyjnore për vdekjen, Gilgameshi bëhet provë e të kuptuarit të njeriut për pafuqinë e tij, për ta gjetur ilaçin e vdekjes, për ta fituar pavdekësinë dhe sundimin e pazhdukshëm. Në rastin e Ademit e të Havës, ambicia për të fituar pavdekësinë dhe sundimin e pazhdukshëm përfundoi me turpërimin e tyre para Krijuesit, ndërsa në rastin e Gilgameshit shohim se ambicia për ta gjetur ilaçin e pavdekësisë për mikun dhe për të sunduar vetë, shndërrohet në disfatë të plotë.

²⁵ *Gilgameshi*, Rilindja, Prishtinë, 1984.

Krahas përvojave të Ademit a.s., babait të njerëzimit, dhe të veprës së parë artistike, që janë dështime të plota, jam i bindur se sot qëndron ambicia shkencore për të ndërhyrë në ligjin e krijimit të njeriut. Kjo ndodhë pikërisht me klonimin e qenieve njerëzore që duket po ashtu si një përpjekje për të fituar njëfarë jetëgjatësie ose pavdekësie në formën e krijimit të përsëritur! Eksperimentimet mund të shpijnë në çfarëdo rezultati që është pasojë e shpërdorimit të dhuntisë dhe të dijes së dhënë të njeriut. Por, kurrfarë eksperimentimesh nuk mund ta krijojnë kurrë shpirtin e njeriut, sepse krijesa e përsosur në formën e njeriut dhe e pajisur me shpirt, është vepër ekskluzive vetëm e Zotit, siç edhe është shpallur në ajetin 29 të sures el-Hixhr, i cili u citua më herët.

Është e qartë se shkenca, si edhe imagjinata poetike, i ka kufizimet e saj, jashtë të cilave ajo kurrë nuk mund të dalë. Kjo do të thotë se as shkencat mjekësore (dhe as historia njerëzore) nuk zhvillohen sipas parimit të zhvillimit linear, të zhvillimit të pandalshëm poshtë lart deri në pakufi. Kur mjekësia arrin të shërojë një sasi sëmundjesh infektive, si lia, murtaja, kolera, fruthi, etj., shfaqen sëmundje të tjera, të panjohura më parë dhe sërisht të pashërueshme. Kur koncentrimi në gjetjen e mjekimit për to arrin të shënojë rezultate të caktuara, shfaqen sëmundje të tjera, të reja dhe të panjohura, por sërisht vdekje-prurëse. Prandaj, edhe në rastin e zhvillimit të mjekësisë dhe të shkencës, sërisht provohet pafuqia e njeriut për t'u ballafaquar me ligjet e Krijuesit, ndër to edhe me sëmundjet e pashërueshme si paralajmëruese dhe me vdekjen e cila e finalizon ekzistimin e njeriut në këtë botë.

Gabimi fatal i njeriut ka ndodhur dhe ndodhë sa herë që ai fillon të rivalizojë me Krijuesin e vet, duke e harruar krijimin e vet (prej një pikë uji) dhe ligjet brenda të cilave është krijuar dhe brenda të cilave duhet të funksionojë e të

përmbyllt historia e tij në këtë botë. Njeriu që i harron kufijtë e tij, duke synuar të ketë qasje në fushat në të cilat ajo nuk i është lejuar, shndërrohet në monstrum.

Edhe pafuqia e fiksuar në raport me sëmundjen dhe me vdekjen e njërit nga njerëzit më të fuqishëm të shekullit XX, Ronald Reganit, është një shembull konkret i pafuqisë së njeriut në përgjithësi, përballe ligjeve me të cilat Allahu e ka formësuar dhe e ka rregulluar jetën tonë në këtë botë. Kurrfarë zhvillimi mjekësor dhe teknologjik nuk mund t'i ndryshojë ligjet e Krijuesit lidhur me vdekjen e njeriut, me ç'rast sëmundjet e pashërueshme, si sëmundja Alsajmer, shfaqen vetëm si një eufemizëm për shkakun themelor të vdekjes, ashtu siç është shpallur qartë:

Askush nuk vdes pa vullnetin dbe lejen e Allahut. Ai është shënim i afatit të caktuar. (Kur'ani, Ali Imran: 145)

Ky njoftim i Allahut për vdekjen në një afat të caktuar dhe si rezultat i vullnetit dhe lejes së dhënë prej tij, e rrumbullakëson tërë kuptimin që ka jeta e njeriut, që nga ngjizja e deri te ndarja e tij nga kjo botë. Kjo e bën të qartë pse dikush jeton më gjatë, edhe kur jeton në kushte të vështira, ndërsa dikush jeton më shkurt, edhe pse mund t'i ketë të gjitha të mirat materiale dhe gjithë kujdesin shëndetësor të kësaj bote. Shpesh për krahasim më shfaqet në mendje jeta e ish-sekretarit të NATO-s, Manfred Verner, i cili vdiq pa i mbushur gjashtëdhjetë vjet dhe një burri tashmë të moshuar, i cili jeton në Prishtinë dhe tash tridhjetë vjet fle nëpër hyrje të banesave, dimër e verë! Këtë burrin e Prishtinës e kam njojur në fillim të viteve shtatëdhjeta, kur pati marrë vesh se ai nuk kishte ku të flinte dhe jetën e çonte duke fjetur ku mundej, kryesisht nëpër hyrje të banesave kolektive. Manfred Vernerin e kam parë një herë në vitin 1995, më duket, në një konferencë shtypi në Tiranë. Vneri ka vdekur moti, ndërsa ky burri i Prishtinës ende jeton dhe ende fle

nëpër hyrje të banesave dhe ushqehet me çka që t'i jepin njerëzit. Po të ishte jetëgjatësia sipas kushteve materiale, Verner do të mund të jetonte, ndërsa ky burri endacak do të ishte harruar moti. Por, ligjet e jetëgjatësisë nuk janë në dorë të njeriut dhe nuk varen vetëm nga kushtet ekonomike. Ata që i kuptojnë këto ligje dhe jetojnë në pajtim me udhëzimet e përgjithshme me të cilat Zoti e ka mëshiruar njeriun, e kanë më të lehtë edhe sëmundjen, edhe vdekjen. Ata e kuptojnë se sikundër që lindja nuk ka qenë rezultat i vullnetit të tyre, as vdekja (pra as shmangja e saj), nuk është në duart e tyre. Me një fjalë, e gjithëjeta e njeriut, fillim e mbarim, është argument se ekziston një Vullnet jashtë saj, i cili e formëson, e zhvillon dhe e shuan atë jetë në një afat të caktuar, e të cilit askush nuk mund t'i shmanget, pavarësisht fuqisë ose moshës.

Rrjedhimisht, ai Vullnet Sovran që e përcakton jetën dhe vdekjen e secilit njeri në këtë botë, sipas ligjeve që janë të pandryshueshme që nga vendosja e parë e njeriut në Tokë e deri në ditët tona, dhe që si ligje janë plotësisht jashtë kompetencave të fuqisë dhe të dijes së njeriut, është edhe Gjykatësi i veprës së secilit njeri në botën tjeter, për ekzistimin e së cilës, qoftë dhe vetëm përvojat e njoitura të njerëzve dhe argumentet që i shohim me sytë tanë gjithandej, nuk lënë asnjë dyshim.

Nëse kjo qasje, si e vëtmja e drejtë, do të pranohej dhe do të futej në veprim në jetën e njerëzve, pra edhe të qytetërimit perëndimor, ajo do të ndihmonte në korrigimin e mekanizmit që e ka larguar këtë qytetërim nga programi hyjnor dhe e ka bërë të dhunshëm deri në eks-tremin ku mund të rrezikohet edhe e ardhmja e tij.

Mesazhi i qytetërimeve të vdekura

Përveç vdekjes si një argument i pakundërshtueshëm për ligjet e Allahut, me të cilat Ai e ka rregulluar jetën në këtë botë dhe në gjithësi, besojmë se edhe studimi i qytetërimeve të vdekura është një argument që ndihmon të kuptohen ato ligje, të bëhen korrigimet e veprimeve dhe të shpëtohet qytetërimi nga rrreziku i ndëshkimit hyjnor. Kësaj here do të nisem edhe nga përvaja personale, artistike dhe studimore, e cila mund të inkadrohet në argumentimin e kësaj tematike.

Në verën e vitit 2004 shkova për pushime në Tunizi. Preokupimi im me Kartagjenën e lashtë, rrënojat e së cilës gjenden në Tunizinë e sotme, ka qenë mjaft i hershëm. Në vëllimin poetik *Pirg vegimi* të botuar në vitin 1985, pata botuar edhe një poezi të shkurtër me titull “Rënia e Kartagjenës”. Pata bërë përpjekje t'i zbulloja fshehtësinë se përse ra ai shtet i fuqishëm, i cili kishte qene në gjendje të matej me Romën dhe madje ta tmerronë kryeqytetin e njërsë nga perandoritë më të mëdha të të gjitha kohëve. Fjalia e tmerrit “Hanibal ante portas” (Hanibali para portës), e cila u kishte shërbyer grave romake që t'i frikësonin fëmijët e lazduar, kishte ardhur deri në ditët tona me një kumbin të çuditshëm.

Përpjekja ime që ta zbulloja shkakun e rënies së Kartagjenës ishte orientuar në shkaqet historike, konkretisht në konfliktet e brendshme në vetë shtetin kartagjenas. Frika nga rritja e autoritetit dhe e fuqisë së Hanibalit i

kishte shtyrë shtetasit kartagjenas që ta linin pa furnizime atë dhe ashtu Hanibali tē pësonte disfatë e tē detyrohej tē ulte kokën para oligarkëve tē pushtetit kartagjenas. Shkurtpamësia e tyre kishte bërë që ata tē mos e llogaritnin mundësinë e kundërgoditjes romake, e cila do tē vinte jo vetëm para portave tē Kartagjenës, por do tē hynte edhe brenda qytetit dhe do ta bënte atë shkrumb e hi, pér ta ngritur pastaj një Kartagjenë tjetër, romake.

Mua më qe dukur se e pata kuptuar tē vërtetën e asaj politike fatale tē kartagjenasve dhe lexuesit i propozoa tē kuptonte se fitorja romake nuk ishte meritë e Scipionit, as ndodhi pér t'u zgjeruar kufijtë e perandorisë së madhe e Romës, por kishte ndodhur pér shkak tē një tē keqeje brenda vetë organizimit, përkatësisht rivaliteteve tē kartagjenasve. Pra, më rezultonte se kjo e keqe ishte e karakterit politik, një verbëri politike. Unë atë e pata sublimuar kështu:

*Thonë ra Kartagjena
Se qe strateg Scipioni
Thonë ra Kartagjena
Mbi hirin e saj tē stërngritej Roma
Po Kartagjena s'kish si tē mos binte
Përderisa hijes së ret dronë ia kishte*

Në variantin përfundimtar, tē botuar në vëllimin me poezitë e mia tē zgjedhura me titull *Lulja e shpëtimit*, (2004), pas vizitës që e bëra në Kartagjenë, në vargun e fundit kam shtuar vetëm një fjalë, megjithëse kam bërë dhe një thyerje tjetërfare tē vargjeve tē fundit:

*Po Kartagjena s'kish si tē mos binte
Përderisa hijes së ret
Dronë si një fantazme ia kishte*

Megjithatë preokupimi im me fatin e Kartagjenës ka vazhduar edhe në vëllimi poetik me titull *Formula e Katanit*, tē botuar në vitin 1989. Vetë titulli i këtij vëllimi

është aktualizim i shkakut të shkatërrimit të Kartagjenës. Kësaj here e pata fokusuar ideologjinë e krimit të Marcus Porcius Katonit, i cili idenë e tij për shkatërrimin e Kartagjenës e kishte shndërruar në një propagandë çmendurake. Ai ngado që shkonte dhe çka do që të bënte, nuk e linte pa e përsëritur se Kartagjena duhej të shkatërrohej. Mund të jetë rasti i parë në historinë e njerezimit i propagandës sistematike të kalkuluar nga interesa shtetërore që me atë përsëritshmëri të fuqishme të përgatitet opinionin publik për shkatërrimin e një vendi ose të një populli.

Është e qartë se referimi ndaj kësaj urrejtje irracionale kundër një vendi te unë ishte provokuar nga aktualiteti në të cilin jetonte Kosova dhe shqiptarët në vitet e tetëdhjeta. Propaganda e regjimit të Millosheviqit ishte sistematike dhe gjithnjë e më arrogante në idenë e saj se shqiptarët duhej të shkatërroheshin ose të dëboheshin “përtej Bjeshkëve të Nemuna”. Prandaj, ideja e poezisë sime, “Formula e Katonit”, më shumë ishte përpjekje për t'i denoncuar rrënjet e asaj ideologjie kriminale të zhdukjes së popujve dhe shteteve për shkak të urrejtjes racore ose pretendimeve imperiale.

FORMULA E KATONIT

Njëherë e një kohë

Njëfarë Marcus Porcius Katoni

Shpiku njëfarë formule

Të thjeshtë për Kartagjenën

Ceterum cenzeo Carthaginam delendam

esse

Që s’ë harronte ta shqiptonte

Në senat në shtëpi publike

Në pjetore në gjumë,

Në nevojtore

Në kohën e tij

*Psikanaliza s'kishte fenerë
Për bodrumet e shpirtit
Nga ajo formulë ndjellazezë
Erërat e pikëlluara
Përhapën hirin e Kartagjenës
Në të katër anët e botës
Duke brumëzuar gjak e ëndrra
Nëpër kujtesë
Atë ditë e sot
Formula e Katonit mbeti në fuqi
Nëpër kabinete laboratorë
Salla solemne akademi
Vë retro të plotë
Dhe Kartagjenat e trilluara
I ndjek nëpër botë²⁶*

Në këtë poezi nuk kam bërë ndërhyrje në botimin përfundimtar, por e kam lënë ashtu si ka qenë në fillim. Më është dukur se këtu funksionon metafora e Kartagjenës së shkatërruar si fara e një ideologjie shkatërrimitare, e cila është e përhapur nëpër botë edhe sot

Preokupimi im me figurën e Kartagjenës, vërtet ishte shtysë që gjatë qëndrimit në Tunizi të shkonim për vizitë në rrënojat e qytetit të lashtë. Ajo histori kishte shkrepëtitur me mijëra herë nëpër imagjinatën time, por ndryshe është kur e sheh me sytë e tu një pamje reale, e ndryshe është kur atë pamje e imagjinon. Tashmë e kisha plotësisht të qartë mesazhin që na e ka dhënë Zoti që të shëtisim nëpër Tokë e t'i shohim vendet e shkatërruara për të marrë mësim për dënimin që i ka gjetur gënjeshtarët:

Thuaj: Ecni nëpër tokë e mandej shikoni se si qe përfundimi i gënjeshtarëve . (Kur'ani, el-En'am: 11)

²⁶ Këto poezi janë të përfshira në versionin përfundimtar në vëllimin *Lulja e shpëtimit*, Logos-A, Shkup, 2004.

Kodrina ku është e ekspozuar një pjesë e qytetit antik të Kartagjenës ka pamje të bukur dhe vërtet impresive. Poshtë saj është një gjelbërim i dendur, që jo vetëm që mbiijeton në atë vapë, por farfurinë në shumë ngjyra. Më tutje shtrohet deti i kaltër që në largësi sajon azimute me qiellin po ashtu të kaltër.

Në sheshin e madh janë ekspozuar dhjetëra statuja të kohës pararomake dhe të periudhës romake të Kartagjenës. Statujat janë perceptime dhe formësime artistike pagane për jetën dhe vdekjen. Stili monumental i skulpturave, i harqeve, i mureve të shtëpive dhe i mureve mbrojtëse, flet për fuqinë e madhe ekonomike dhe ambicjet që kanë ekzistuar në atë shtet. Po, të gjitha këto perceptime dhe formësime artistike janë në funksion të glorifikimit të bukurisë e të fuqisë së njeriut si esencë në vete dhe e lidhur me disa forca gjoja hyjnore, të sajuara nga vetë fantazia e njeriut dhe sipas masës dhe formës së njeriut. Duke e shikuar monumentalitetin e këtyre sajimeve, e kuptoj saktësisht se kartagjenasit me këto perceptime dhe formësime artistike e kanë sfiduar në mënyrë arrogante Krijuesin, Zotin e botëve. Ata kanë menduar se fuqia e tyre është rezultat ekskluzivisht i veprës së tyre. Dhe, në këtë pikë ata janë barazuar edhe me shumë popuj të tjera para tyre dhe pas tyre, të cilët i janë ekspozuar ndëshkimit për shkak të arrogancës së vet në raport me Krijuesin.

Përderisa ciceronia flet për stilin e shtëpive kartagjennase, dy katet e para të të cilave thotë se ishin nga druri, për ç'arsye edhe u dogjën tërësisht nga zjarri romak, e marr me mend se ato ishin të gjykuara të digjeshin jo për shkak se qenë mësyrë nga romakët, po për shkak se ato shtëpi dhe banorët e tyre qenë mbushur me mëkate të mëdha. Shkaku i vërtet i zjarrit dhe i djegies së atyre shtëpive dhe robërisë së kartagjenasve, ishin mëkatet e tyre që kishin mbërritur pikën kritike. Ndëshkimi u kish-

te ardhur në formën e pushtuesit romak, por ai ndëshkim ishte prej Zotit, të cilin ata e kishin harruar, kur kishin arritur në kulmin e fuqisë dhe të begatisë së tyre. Është e qartë se ata nuk e kanë respektuar asnjë paralajmërim që u është bërë nga Zoti:

Këtë (dërgimin e të dërguarve) ngase Zoti yt, nuk është që për shkak të mëkatit të shkatërrojë një vend, e banorët e tij të jenë të painformuar (Kur'ani, el-En'am: 131)

Prandaj, shkatërrimi që ka ardhur nga armët romake ka qenë pasojë e kokëfortësisë dhe e arrogancës, e cila i ka penguar që t'i pranojnë udhëzimet hyjnore.

Ciceronia fliste për veprat e ndryshme në galeri, madje e tregonte edhe një skelet të kohës antike, duke dhënë edhe disa shifra për gjatësinë e tij, për dhëmbët e ruajtur, për formën e kafkës etj. dhe derisa ajo fliste, unë mendoja se ndoshta pikërisht ai skelet i ruajtur me mijëra vjet dhe i ekspozuar për turistët e shumtë nga e tërë bota, e shpjegon më së miri pafuqinë reale të njeriut dhe humbjen fatale të tij, nëse ajo jetë nuk ka marrë kuptim në raport me Krijuesin. Një skelet i një njeriu pagan e tregon mjerimin e njeriut që nuk arrin ta kuptojet të vërtetën se në këtë botë është përkohësisht dhe se për aq sa është në këtë botë, duhet të sillet sipas udhëzimeve dhe obligimeve që i janë vënë nga Krijuesi i tij. Në atë rast fati i njeriut do të ishte ndryshe:

E sikur banorët e këtyre vendbanimeve të kishin besuar dhe të ishin ruajtur, Ne do t'ju hapnim begati nga qielli e toka, por ata përgënjeshtruan, andaj i dënuam me shkatërrim për atë që e merituan . (Kur'ani, el-A'rash: 96)

Vërtet nuk mund të ketë shpjegim më të arsyeshëm dhe më të qartë për shkatërrimin e shumë vendbanimeve dhe shumë popujve në botë. Pra, edhe për Kartagjenën. Andaj është e qartë se ato vendbanime dhe ata popuj Zoti nuk i ka dënuar sipas ndonjë skeme të parapër-

gatitur. Po tē ishin besimtarë dhe po tē ruheshin, Krijuesi thotë se ata do tē kishin begati nga qielli e nga toka, por meqë i kanë përgënjeshtuar argumentet e Zotit, ata i ka gjetur dënim i shkatërrimi i cili është meritë e veprimeve të vetë atyre. Pra, assesi nuk është një ndëshkim i parapërgatitur, një fatalitet i dhënë, por kjo është rezultat i vetë punës së tyre.

Megjithatë ajo që mbetet gjithnjë aktuale në këtë kontekst, ka tē bëjë me faktin se ky ligj i Allahut është i përhershëm dhe godet edhe në kohën tonë. Prandaj, tē gjithë ata që duan tē marrin mësim, më mirë është tē marrin mësim nga e kaluara e popujve dhe e vendbanimeve të zhdukura, sesa tē bëhen edhe vetë objekt i ndëshkimit hyjnor. Allahu na ka bërë tē ditur se vendbanimet e shkatëruara i ka lënë ashtu që njerëzit tē marrin mësim e tē kuptojnë se si ishte përfundimi i atyre që i kanë mohuar argumentet e Tij, sikundër na porositë ajeti 11 i kaptinës kur'anore el-En'am, tē cilin e cituam më herët.

Në kohën në tē cilën jetojmë, një numër shumë i madh i njerëzve dhe i popujve nuk besojnë se shkatërrimi i vendbanimeve dhe zhdukja nga faqja e dheut e disa popujve ka qenë vullnet i Krijuesit. Shkenca përpinqet tē sajobjë teori tē shumta për tërmetet, shtrëngatat dhe shkakat e tjera, tē cilat i interpreton si esencë në vete, pra sikur ato tē ishin tē vetëkrijuara dhe tē ishin subjekt i vëtëdijshëm për veprimet e veta, edhe pse dihet se tërmeti nuk e krijon vetveten. Nga ana tjetër është e qartë se as tërmeti nuk është jashtë kontrollit, sepse po tē ishte jastë një kontrolli tē rreptë, ai kur tē fillonte, nuk do tē dinte ose nuk do tē mund tē ndalej. Prandaj një Vullnet jashtë tij e cakton momentin e fillimit tē tij dhe momentin e frenimit tē tij, bashkë me pasojat dhe mesazhet që ai i transmeton. Edhe tërmeti është një dukuri që ndodhë në bazë tē faktorëve gjeologjikë tē cilët në lidhje

shkakësore në mënyrë të pashmangshme shpijnë deri te Vullneti i Krijuesit. Prandaj, në këtë lidhje shkakësore, edhe zhdukja e vendbanimeve dhe e popujve, është një ligj veprues në bazë në tregullave dhe ritmikës së caktuar nga Vullneti Hyjnor:

Ata nuk e besojnë atë (Kur anin). Po ligji (i dënimit) ndaj popujve më të hershëm tashmë është i provuar (se si i shkatërrroi Zoti).

Zhdukja e disa popujve të hershëm dhe mbetja e rrënojave të vendbanimeve të tyre është një argument i fuqishëm i ekzistencës dhe pranisë së ligjeve të qëndrueshme të Zosit në të gjitha zhvillimet e planetit dhe të njerëzimit në të gjitha kohët. Edhe fati i Kartagjenës është vulosur nga këto ligje të Allahut. Unë këtë unë nuk e kam kuptuar në kohën kur jam preokupuar me fatin e saj, sepse metodologjia që e kam ndjekur ka qenë e gabueshme. Por, fakti që unë nuk e kam ditur të vërtetë për zhdukjen e Kartagjenës dhe të vendbanimeve të tjera si ajo, më ka dëmtuar vetëm mua, e kurrsesi të vërtetë. E vërteta që Zoti e ka bërë argument, në natyrën e saj është e pacenueshme nga injoranca jonë. Ajo na pret, ashtu që nëse arrijmë ta kuptojmë, ajo është në të mirën tonë, ndërsa nëse nuk arrijmë ta kuptojmë, ajo prapë mbetet e njëjtë, e pandryshueshme. Në fakt, mbetet në dispozicionin e njerëzve, të atyre që kthjellohen dhe e ndjekin metodologjinë që u mundëson t'i kuptojnë të vërtetat që na i ka lënë si mesazhe e mësime Krijuesi i botëve, pikërisht për hir të mëshirës së Tij ndaj njerëzimit. Ndërkaq, ata që vazhdojnë t'i glorifikojnë qytetërimet e vdekura, politeizmin dhe mitologjitë e tyre, në vete e injektojnë deformimin e botëkuptimit për botën dhe rolin që Zoti i ka dhënë njeriut në faqen e dheut

Mesazhi i mumieve të Faraonit dhe të Leninit për ata që mendojnë

Në histori është mjaft i njohur përfundimi i turpshëm i njerëzve që ushtrojnë dhunë ndaj njerëzve dhe që me arrogancën e tyre i sfidojnë ligjet e Zotit dhe që mbeten në kujtesën e njerëzimit si shembuj për ata që mendojnë. Në mizërinë e personave që me arrogancën e tyre e kanë provokuar zemërimin e Allahut dhe ndëshkimin e Tij, pa dyshim që kryet e vendit e zënë dy persona që në këto aspekte kanë shkuar më larg se shumë të tjerrë. Këta janë Faraoni dhe Lenini. Këta dy janë dalluar në histori për arrogancën dhe mohimin e pashembullt ndaj Krijuesit të botëve. Faraoni pat arritur deri në atë pikë arrogance dhe mendjemandhësie sa e shpalli veten për zot. Ai refuzoi kategorikisht që t'i pranonte Musain dhe Harunin si të dërguar të Zotit dhe të sillej në pajtim me udhëzimet që ata i sillnin si sihariq për njerëzit. Faraoni premtoi ndëshkim për të gjithë ata që kur e panë mrekullinë me të cilën kishte ardhur Musai a.s., u penduan dhe vendosën të pranojnë besimin në një Zot. Bile, magjistarëve të vet, të cilët kur e panë mrekullinë që zbuloi Musai para tyre, u penduan dhe iu kthyen besimit, ua përshkroi mënyrat mizore se si do t'ua gjymtonte gjymtirët.

Egërsia e Faraonit pësoi disfatë kur ushtria e tij u përmbyt nga uji i detit, i cili u çà në mes për popullin e Musait, ndërsa u bashkua sërisht kur ushtria e Faraonit u fut brenda

duke i ndjekur. Por, fundi më i turpshëm i Faraonit nuk ishte vetëm humbja e ushtrisë së tij dhe vdekja e tij.

Ndëshkim Hyjnor që ra mbi Faraonin është vetë ekspozimi i trupit të tij në formë të mumies. Me shekuj trupi ka mbetur kufomë e pakallur që i trishton shikuesit. Ai trup i balsamuar ia kujton secilit pafuqinë e njeriut kundruall vdekjes. Sado që një sundimtar të jetë i fortë dhe arrogant, prapëseprapë ai vdes dhe trupi i tij e trigon qartë pafuqinë e tij. Këtë pafuqi e zbulon më së shumti një trup i balsamuar, si ai i Faraonit.

Në Kur'an jepet informatë e qartë lidhur me ndëshkimin që ra mbi Faraonin edhe në formën e mbetjes së trupit të tij si argument për njerëzit. Në ajetin 90 (të sures Junus) flitet për kalimin e beni israilëve nëpër detin e hapur dhe ndjekjen mizore të Faraonit deri në çastin kur e përfshiu përmbyssja, me ç'rast ai tha se e besonte Zotin e beni israilëve dhe se ishte nga muslimanët. Në ajetin 91 (të sures Junus) jepet qortimi se besimi ishte i vonuar, ngase Faraoni ishte njëri prej shkatërruesve, ndërsa në ajetin 92 përshkruhet saktësisht se si trupi i faraonit do të mbetet argument për brezat që do të vijnë pas tij:

Sot po të shpëtojmë ty (po të nxjerrim prej detit) me trupin tend (të vdekur), që të shërbesh si argument për ata që vijnë pas teje. Vërtet, ekziston një shumicë njerëzish që nuk hulumtojnë argumentet Tona” (Kur'ani, Junus: 92)

Trupi i vdekur i faraonit, i shpëtuar nga valët e detit të trazuar u nxor në tokë që të jetë argument për gjeneratat që do të vinin, edhe pse Allahu sérish têrheq vërejtjen se një shumicë e njerëzve nuk i hulumtojnë argumentet hyjnore. Dhe, vërtet, disa trupa të mumifikuar të faraonëve egjiptianë (Allahu ka têrhequr vërejtjen se shumica e njerëzve nuk i hulumtojnë argumentet e Tij) ekspozohen para syve të qindra dhe mijëra njerëzve, shëtisin nga një ekspozitë në tjetrën, nga një kontinent

në tjetrin, janë një atraksion turistik i rangut më të lartë. Bile, kjo shëtitje makabre shoqërohet edhe me paradokse të habitshme. Ka ndodhur që kur e kanë çuar mumien e faraonit Ramzesi III në Francë në aeroportin e kryeqytetit të Francës e kanë pritur me nderime ushtarake dhe shtetërore të nivelit më të lartë!!! Kjo vërtet tregon se sa pak mësim marrin njerëzit nga argumentet që Zoti ua ka dhënë në dispozicion. Pra, në vend se të reflektojnë e të nxjerrin mësime nga ajo që i ka ndodhur një mohuesi arrogant, pikërisht mumies së tij i bëjnë nderime.

Për t'i dhënë edhe më shumë përmasë këtij paradoksi, njerëzit bëjnë me mijëra kilometra rrugë për të shkuar në vendin ku eksposozhen trupat e faraonëve, por shumica e tyre vërtet nuk i hulumtojnë argumentet me të cilat mund të shpjegohet ruajtja e trupave të faraonëve. Eksperjtë e fushave të ndryshme e lodhin mendjen e tyre se me çfarë materiali u bë balsamimi (mumifikimi) dhe si u ruajt një kufomë e tillë me mijëra vjet. U bien kryq e tërthor hamendjeve dhe spekulimeve, por nuk arrijnë ta kuptojnë të vërtetën e plotë. E vërteta e plotë është se edhe mjetet që u përdorën për ta balsamar trupin e faraonit, shkakun e kanë te vendimi që e shpall Zoti, se trupin e faraonit do ta bëjë argument të ndëshkimit të arrogantit mosbesimtar. Pra, teknika e balsamimit nuk ishte një qëllim në vetvete, por vetëm një mjet për ta çuar në vend Vullnetin e Krijuesit të botëve.

Se cila është mumia e vërtetë e faraonit arrogant, ka hamendje, por tërheqja e vërejtjes nga Allahu për mos-hulumtmin e argumenteve nga një shumicë e njerëzve, dëftón se shkaku i mosidentifikimit të saktë është rrjedhojë e këtij moshulumtimit adekuat. Përndryshe, në Egjipt zbulohen shpesh mumie të reja, të cilat me mijë-vjeçarë kanë qenë të ruajtura. Bile, edhe në këtë fillimviti, një ekip i studiuesve japonezë, kanë njoftuar se në një

varr që ata konsiderojnë se është i lashtë së paku 3.500 vjet e kanë zbuluar një “mumie perfekte”. Pra, edhe numri i madh i mumieve, është një nga fshehtësitë e Krijuesit të botëve, me të cilat Ai e sprovon përkushtimin e njeriut ndaj të vërtetës. Përndryshe, mjafton vetëm të logjikojmë se si ishte e mundur të ndodhë ai “zbulim i njerëzve” të lashtë të Egjiptit për ruajtjen e trupave të vdekur. Pa zbulimin e asaj mjeshtërie të balsamimit, e cila edhe sot është enigmë për njerëzit, trupat do të zhbëheshin me shpejtësi. Por, edhe zbulimi i asaj mjeshtërie nga egjiptianët e lashtë është vetëm pjesë e Vullnetit Hyjnor, i cili përmbus het ashtu si dëshiron Ai vetë.

E njëjtë gjë vlen edhe në rastin e trupit të balsamuar të udhëheqësit të revolucionit komunist-ateist të tectorit, Vladimir Iliç Leninit. Ngjashmëria e veprës së Leninit me atë të faraonit, sa i përket qëndrimit ndaj Zotit, është bukur identike: Lenini udhëhoqi një revolucion ateist që e mohonte Zotin dhe ligjet hyjnore. Ideologjia e proklamuar dhe e zbatuar nga Lenini propagandonte se nuk ekzistonte Zoti dhe se e tërë historia e njerëzimit ishte produkt i luftës së klasave dhe se barazia klasore do t'i jepte fund pabarazisë. Kjo ishte një ideologji agresive dhe arrogante ndaj Zotit dhe ndaj ligjeve hyjnore. Revolucioni Bolshevik, i udhëhequr nga Lenini, eskaloi në luftë civile në të cilën vdiqën me miliona njerëz. Pas vdekjes së Leninit më 1924, ai u trashëgua nga Stalini, i cili i dha impulse edhe më të tmerrshme shkatërrimit të jetëve të njerëzve.

Pas vdekjes, Leninin e balsuan, duke e bërë objekt të vizitave të miliona vizitorëve. Sot, pas tetëdhjetë vjetëve të vdekjes së tij, mumia e Leninit e ekspozuar në Sheshin e Kuq të Moskës, shkakton polemika dhe konflikte në politikën dhe në shoqërinë ruse. Komunistët janë këmbëngulës që mumia të mbetet aty ku është,

duke e glorifikuar udhëheqësin revolucionit bolshevik, e duke u kërcënuar edhe me dhunë nëse dikujt i mbushet mendja ta largoje atë nga sheshi. Nga ana tjetër, përfaqësues të lëvizjeve liberale, si Valeria Novodvorskaja, mendojnë se “është koha të lirohem i nga kjo mumie e tmerrshme”. Ajo ka shkuar edhe më larg, duke deklaruar se “askush nuk mund të flet për asnjë lloj demokracie ose civilizimi në Rusi, përderisa Lenini gjendet ende në shezin kryesor. Nuk më intereson se a do ta hedhin në grumbullin e plehut”.²⁷

Këto debate dëshmojnë për konfliktet që i prodhon ende figura/mumia e Leninit në politikën dhe në shoqërinë ruse. Rreziku i tij është që në të ardhmen ky konflikt të shndërrohet në dhunë, nëse forcat antileniniste do të marrin masa për largimin e mumies nga sheshi, gjë që kjo tregon se çfarë krimi ka mbjellë vepra ateiste e Leninit në mendjen e shumë njerëzve.

Pra, pretendimi i ithtarëve të Leninit është se e kanë nderuar, por e vërteta është se ky është një ndëshkim dhe një argument për ata që dinë të mendojnë se sa i pafuqishëm është njeriu në përgjithësi dhe sa i mjerë është ai që e mohon Zotin dhe ligjet e Tij.

Ndëshkimi i qartë në këtë botë ndaj faraonit dhe ndaj Leninit, si dy nga liderët e pabesimtarëve, është pra evident dhe mund të shihet me sy, por ndëshkimi që u është rezervuar atyre dhe të gjithë pabesimtarëve si ata dhe pasuesve të tyre në Ditën e Gjykit, me siguri është shumë më i rëndë .

Në ditën e kijametit ai (faraoni) i prinë popullit të vet dhe i fut në zjarr. Sa i shëmtuar është ai vend i ofruar. (Kur'ani, Hud: 98)

Pra, të gjithë pasuesit e tij do të shkojnë me të në humbjen e përhershme, për shkak se nuk kanë menduar

²⁷ www.danas.co.yu, tetor 2005.

me kokën e tyre dhe nuk i janë kundërvënë të keqes që e ka promovuar dhe e ka zbatuar udhëheqësi i tyre. Ky ndëshkim nuk është vetëm ndaj pasuesve të Faraonit, po me siguri shtrihet mbi të gjithë pasuesit e udhëheqësve mohues e arrogantë, të cilët e kanë konsideruar ose do ta konsiderojnë veten për zot dhe kanë bërë ose do të bëjnë shkatërrime në tokë. Udhëheqësve të tillë nuk duhet t'u jepet as besimi e as dëgjueshmëria, sepse ata shndërrrohen në bashkëpjesëmarrës në krim dhe transformohen në humbje fatale për njeriun që nuk mendon. Udhëheqësit që e propagandojnë ateizmin, agnosticizmin ose çfarëdo ideje që nuk e pranon Zotin një, paraqesin rrezik edhe për popullin dhe shtetin, sepse ata haptas janë në konflikt me ligjet e Krijuesit të botëve. Në këtë pikë nuk ka pse të eksperimentohet, kur historia ka dhënë shembuj të mjaftueshëm për t'u bindur ata që mendojnë. Prandaj, glorifikimi i faraonit nga historianë dhe arkeologë perëndimorë, që investojnë miliona dollarë në gërmime në piramida, jo për ta gjurmuar të vërtetë e deformimeve të sundimit e të qëndrimit ndaj Zotit, por gjoja për ta zbuluar madhështinë e kohëve antike, është një shkencë mbi baza të gabueshme. Faraoni dhe koha e tij duhet të studiohen për t'i kuptuar përmasat e gabimit dhe të ndëshkimit që e ka gjetur atë dhe popullin e tij, e jo për të krijuar mite që edhe më e sforcojnë deformimin e vetëdijes njerëzore, aq sa mumia e faraonit të pritet me nderime të larta shtetërore në aeroportin e Parisit. Duke glorifikuar figura të tilla si faraoni e Lenini, shkencat humanistike dhe shoqërore, kanë ndikuar në relativizimin e fajit të kriminelëve dhe në deformimin e vetëdijes për historinë e njerëzimit. Krimet e bëra nga Tiberi, Kaligula, Neroni, Atila, Aleksandri i Madh, Xhingiskani, Car Dushani, inkuizitori Torkvemada, Ivan Grozni, Petri i Madh, Napoleon, Bizmarku, Kral Petri, Hitleri, Musoli-

ni, e deri te Millosheviqi e Sadami, i janë nënshtuar një vlerësimi selektiv, jokritik dhe të padrejtë. Po të ndalemi në historinë e re, do të shohim një pamje të çoroditur: humbësit e luftërave u janë nënshtuar akuzave e gjykimeve, ndërsa fitimtarët janë amnistuar e janë shpallur heronj, duke i fshehur krimet që i kanë bërë ose që i kanë urdhëruar. Për shembull: shkaku i fillimit të Luftës së Parë Botërore ishte atentati i terroristit serb Gavrillo Principit kundër Franc Ferdinandit më 28 qershori 1914 në Sarajevë. Edhe pse implikimi i Serbisë në këtë atentat ishte i qartë, ajo nuk u ndëshkua në fund të luftës. Në Luftën e Parë Botërore humbën jetën miliona njerëz, dëmet materiale qenë të pallogaritshme, u shkatërruan katër perandori (Austro-Hungaria, Rusia, Gjermania dhe Shteti Osman), me çka u hap kapitulli i rivaliteteve dhe i konflikteve të reja, të cilat do të sillnin kasaphanën e re të Luftës së Dytë Botërore. Në anën tjetër, meqë u gjend në anën e koalicionit fitimtar, Serbia u shpërblye me territorë të reja dhe madje me krijimin e Mbretërisë Serbo-Kroate-Slovene, nën kurorën mbretërore serbe, gjë që e bëri Serbinë fuqi ballkanike. Këtu mjafton të kujtojmë vetëm edhe shkatërrimin e qytetit të Drezdenit gjatë Luftës së Dytë Botërore nga aviacioni aleat ku humbën jetën me mijëra civilë për çka askush kurrë nuk u akuza. Po të thellohem më tej, duhet përmendur hedhjen e bombave atomike në Hiroshima dhe në Nagasaki, në fund të Luftës së Dytë Botërore, nga të cilat humbën jetën me qindra mijë civilë të pafajshëm. Me një sistem vlerësimi të tillë, rezulton se po ta fitonin Luftën e Dytë Botërore Gjermania, Italia e Japonia, kriminelë do të shpalleshin udhëheqësit e kampit tjetër të luftës. Pra, në historiografinë dhe në mendësinë perëndimore, kriteri i vlerësimit të figurave historike nuk është i drejtë, sepse nuk bazohet në drejtësinë me burim hyjnor, po thirret

në interesa koniukturale të fitimtarëve, gjithnjë sipas parimit makiavelist “Qëllimi e arsyeton mjetin”. Një sistem i tillë vlerësimi, që nuk e ka marrë mësimin e duhur nga shembulli i faraonit, bëhet gjenerator i deformimit të vetëdijes historike dhe të moralit publik.

Mesazhi i kuajve të heronjve

Qytetërimi modern perëndimor ka sajuar edhe disa simbole që shenjojnë triumfin dhe heroizmin, por që në prapavijë janë të lidhura me funksionin e totemeve të politeistëve në historinë pak më të largët. Kështu, përjetësimi i figurave të mëdha historike në formën e përmendoreve në të shumtën e rasteve është bërë brenda një klisheje ideore dhe artistike jo edhe aq kreative. Heronjtë e përmasave kombëtare, kryesisht ata të periudhës së mesjetës, po edhe të kohës më të re, zakonisht paraqiten hipur mbi kalë. Variacionet e paraqitjes (akëcili në formë më plastike, akëcili në formë më të ngurtë), nuk e shprishin imazhin e klishtetizuar të kësaj ngjizjeje të kalarësit dhe të kalit.

Po të nisim nga toka shqiptare një ekskursion në gjetje të këtyre përbajtjeve, do të gjejmë se Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, i paraqitur mbi kalë në sheshin e Tiranës (i cili e mban emrin e tij) po edhe në Krujë e në Prishtinë ku është sjellë mostra e shtatores së Krujës, heroin kombëtar të shqiptarëve e paraqesin brenda një klisheje ideore dhe artistike (pamja madhështore, luftarake, triumfale, solemne), që duket si reproduksion i ndonjë heroi kombëtar të akëcilit vend europian. Më shumë se pamja e fytyrës, e cila eventualisht do ta identifikonte gjenin shqiptar të tij ose brengën e tij për luftën me superfuqinë e atëhershme të botës, flet shpata e ngritur e cila është simbol kolektiv i kalorësve gjithandej kontinentit. Kalorës

mbi kalë gjejmë në sheshet e Londrës, Parisit, Berllinit, Moskës, Zagrebit, Beogradit, Vjenës e të Romës.

Pa u marrë me shkakun që e ka ngurtësuar këtë gjetje ideore për heronjtë (ndoshta nga Don Kishoti?), njeriu kupton se kjo punë i ka disa defekte të rënda. E para është defekti logjik. Nëse heronjtë janë paraqitur me një shkallë besnikërie, kuajt janë vetëm pjellë e imaginatës së skulptorit. Është pak e besueshme që figura e kalit të ketë lënë mbresa aq të forta te njerëzit sa ta kenë mbajtur mend edhe në detaje pamjen e tij. E dyta është defekti anatomic. Më së shpeshti heronjtë janë paraqitur në përmasa më të mëdha se kuajt, gjë që është në kundërshtim me realitetin. “Intanca artistike” që të glorifikohet kalorësi - hero kombëtar, duke i dhënë përmasa më të mëdha se të kalit të tij, është ideologji agresive e jo arti. E treta ka të bëjë me defektin moral. Heronjtë kombëtar zakonisht janë shquar për vizionin e luftërave të tyre, për drejtimin që e kanë marrë fatet e kombit si rezultat i udhëheqjes së tyre. Andaj, si pasojë e kësaj, paraqitja e tyre në formë agresive, luftarake, me shpata të zhveshura, të gatshëm për dhunë, është reduktim i rolit të tyre si vizionarë e si drejtues të fateve të kombit të tyre dhe njëherit paraqet sforcim të mesazhit të gjakut të derdhur e të dhunës me të cilën i kanë mposhtur armiqtë.

Defekti i fundit i kësaj praktike, njëherit edhe më i rëndësishmi, ka të bëjë me aspektin fetar. Sipas mësimit islam, ngritja e figurave të njerëzve dhe të kafshëve që përgjasojnë me krijesat e gjalla e me funksion idhujtarie, është mëkat, sepse është përpjekje për të imituar Krijuesin. Por, meqë të krishterët nuk duken të obliguar nga ky urdhër i Krijuesit, ata kanë ngritur statuja të panumërtë me njerëz e kuaj anekënd Europës.

Megjithatë çka në fakt simbolizon kali në këto statuja që identifikojnë me qytetërimin perëndimor, ku ai pa-

raqitet si kafsha më besnike?? Forcën? Po të jetë se e simbolizon forcën, atëherë logjikisht del se ai është më i fortë se heroi. Po të jetë ashtu, atëherë edhe meritat e tij për fitoren janë më të mëdha. Kjo do të ishte absurde. Bukurinë? Po të jetë kjo, po ashtu është bizare, sepse sado e bukur që është kjo kafshë, nuk mund të matet me bukurinë e njeriut. Fitoren? Po ta paraqesë fitoren, kjo do të thotë se është mostër e Kalit të Drunjtë të akejve. Në atë rast, më shumë se gjithçka tjetër, ai do të simbolizonte fitoren me tradhti.

Është afër mendsh që Europa, veçmas ajo mesjetare, ka qenë e njohur për aso fitore, pra për fitore me helmime, me vrasje tinëzare, me djegie në furra drurësh, me shkishërimë dhe me indulgjenca që janë shitur si artikuj ushqimorë.

Sidoqoftë, sheshet e qyteteve europiane sot janë përplot kalorës dhe kuaj të cilët u flasin europianëve për historinë e tyre, ndërsa vetë europianët u flasin të tjerëve me arrogancë e agresivitet për qytetërimin e tyre si mostër që duhet t'u imponohet të tjerëve, qoftë edhe me dhunë, siç ka ndodhur në të kaluarën në të dy Amerikat, në Azi e në Afrikë dhe sikundër ka tendenca të bëhet edhe sot e mbase edhe në të ardhmen, sepse ky qytetërim shquhet vërtet për agresion dhe ekspansion. Megjithatë, edhe kjo me siguri i ka kufijtë e saj. Shtatoret me kalorës dhe kuaj nuk mund të jenë fitimtarë të përherëshëm, e aq më pak bartës të mesazheve të përjetshme. Heronj të përjetshëm të njerëzimit janë të dërguarit e Zotit, ata që i kanë transmetuar mesazhet hyjnore, ata që e kanë konsoliduar besimin në një Zot të vetëm, ata që e kanë shpëtuar njerëzimin nga katandisja e plotë. Heronj të përjetshëm të njerëzimit janë pejgamberët: Ibrahimi, Ismaili, Is'haku, Davudi, Musai, Isai, Muhamedi e shumë të tjerë që nuk mund t'i përmendim këtu për shkak të listës së gjatë të emrave të tyre. Pa shëmbelltyrat

e tyre njerëzimi do të kaplohej nga barbaria dhe do ta humbte veten në këtë botë dhe në botën tjetër. Prandaj është gabim ajo hallakatmë me shtatore ku hipur mbi kuaj janë vendosur shtetarë, gjeneralë, luftëtarë, rebelë e aventurierë që kanë bërë vrasje e masakra, kanë bërë pushtime e kolonizime, kanë asgjësuar fise e popuj, kanë rrënuar qytete e faltore. Pikërisht ky zëvendësim i mësimmeve dhe i modeleve të të dërguarve të Zotit me tipa të dhunshëm, ka stimuluar edhe kulturën e dhunës dhe moralin e dhunës. Duke u bazuar në fuqinë materiale, pa e pasur parasysh përgjegjësinë para Krijuesit për veprimet që i bëjnë, madje pa e pasur parasysh as drejtësinë elementare dhe të vërtetën, njeriu perëndimor ka krijuar një epërsi ekonomike dhe ushtarake të qytetërimit perëndimor ndaj pjesës tjetër të njerëzimit.

Edhe heronjtë dhe kuajt e tyre janë pjesë e mesazhit të këtij imponimi.

Përfundime

Qytetërimi perëndimor, duke shpallur se është një ngjizje e shtresave të ndryshme greko-romake dhe judeo-kristiane, vetveti prezantohet si qytetërim mjaft heterogen. Kjo ndodhë edhe për arsyen se nënshtresat e tillë, veçmas ajo judeo-kristiane, kanë qenë të konfrontuarë nëpër shekuj dhe kanë prodhuar konflikte e katastrofa të rënda që nga inkvizicioni e deri te Holokausti. Në anë tjetër, është e pamundur të harmonizohet shtresa greko-romake me atë kristiane, sepse e para është pagane, politeiste, dhe produktin kulturor e qytetëruar që e ka ngjizur, e ka lindur si reaksion ndaj krishterimit mesjetar, ndërsa krishterimi nga ana e tij ende aspiron që të vlerësohet si fondamenti i tërë qytetërimit perëndimor (kërkesat e Vatikanit dhe të Polonisë e të Spanjës që në Kushtetutën Europiane të përmendej roli i krishterimit në identitetin europian, megjithatë nuk u pranuan, por ato mbeten aktive), dhe në esencë ka mbetur armiqësor ndaj paganizmit greko-romak. Edhe ndryshimet që ekzistojnë ndërmjet rajoneve dhe popujve europianë dhe amerikanë janë shumë më të mëdha sesa paraqiten në tablonë unike ku qytetërimi perëndimor pikturohet me ngjyra romantike. Dallimet ndërmjet francezëve dhe amerikanëve, dallimet ndërmjet skandinavëve e spanjollëve ose dallimet ndërmjet grekëve dhe italianëve, janë të mëdha që nga kuzhina e deri te sistemi moral i vlerave në familje. Uniteti kulturor dhe qytetëruar është prokla-

muar më bazë të fuqisë së fituar nga institucionet politike dhe ushtarake, që filluan të ndikojnë mbi Europën pas Luftës së Parë Botërore, e që veçmas u intensifikuan pas Luftës së Dytë Botërore dhe që po bëhen edhe më agresive e imponuese pas rënies së *Perdes së Hekurt*. Unifikimi i këtij qytetërimi po ndodh nën presionin e fuqishëm politiko-ushtarak dhe propagandistik të Shteteve të Bashkuara të Amerikës mbi pjesën tjeter të botës perëndimore, por pa e pasur një mesazh të thellë etik ose fetar. Tash për tash refuzimi më i zëshëm ndaj kësaj tendencë është nga Franca, e cila pretendon në ruajtjen e identitetit të vet kulturor dhe në ruajtjen e rrrezatimit si prijatare e disa ideve të qytetërimit perëndimor, që nga koncepti i shtetit-komb dhe iluminizmit. Epilogu i këtij refuzimi nuk mund të parashikohet. Nëse tendenca franceze shoqërohet edhe me rritjen e refuzimit të kulturave të tjera nationale anekënd Europës, ndoshta edhe mund të ndërpritet trendi i tashëm i imponimit të modelit kulturor amerikan në botën perëndimore.

Edhe përballë qytetërimeve të tjera, unitetin e vet sado të brishtë, si edhe rolin misionar, qytetërimi perëndimor përpinqet ta sigurojë me anë të fuqisë ekonomike, ushtarake, ideologjike dhe propagandistike. Prania e kinematografisë amerikane në të gjitha kanalet televizive dhe në të gjitha kinematë prodhon një gjendje të zbutur të refuzimit ndaj kësaj kulture dhe ndaj këtij qytetërimi që edhe në art është i dhunshëm. Nëse vendet e tjera të qytetërimeve të tjera nuk do të jenë të afta t'i rezistojnë këtij globalizimi të kulturës dhe të qytetërimit, prapëse-prapë ai nuk do të arrijë kurrë që të bëhet gjithëpërfshirës, sepse kjo është në kundërshtim me atë që e ka shpall Zoti për ekzistimin e popujve dhe të gjuhëve e të kulturave të ndryshme.

Konsolidimi më i madh i këtij qytetërimi do të ndodhte sikur ai të fillonte ta legalizonte partneritetin dhe të huazonte pa komplekse nga qytetërimet e tjera, ashtu siç konstaton dijetari Ahmet Davutoglu.²⁸

Kjo është njëra mundësi.

Mundësia tjetër dhe, për mendimin tonë më kryesorja, është që qytetërimi perëndimor të fillojë ta pranojë Islamin, duke e marrë atë si burim të ri të frymëzimeve dhe të organizimeve të veta. Po e theksoj edhe një herë se këtu mendojmë për marrjen e Islamit si Shpallje Hyjnore, e jo për marrjen e modeleve kulturore dhe qytetëruese aktuale të muslimanëve, sepse kjo nuk është e mundur. Alternativë e qytetërimit të sotëm perëndimor nuk është organizimi i sotëm social-kulturor dhe politiko-shoqëror i muslimanëve, sepse edhe ky organizim është produkt i imagjinatave njerëzore, i shartimeve me qytetërimet e tjera, me pasojat e kolonializmit dhe me ngecjen e madhe të zhvillimit e të prodhimit të vlerave morale e kulturore. Alternativa mbetet ekskluzivisht te burimi Hyjnor, te Kur'ani famëlarë, i cili do të ndihmon te që të bëhen korrigimet e mekanizmit të tashëm të qytetërimit perëndimor, duke ruajtur shumë vlera të tij, veçmas programet sociale për mbrojtjen e kategorive të dobëta, liritë dhe të drejtat e njeriut, aktivitetet paqësore të organizatave ambientaliste etj.

Islami është shpallje për të gjithë njerëzit dhe për të gjitha kohët, pra nuk është pronë e muslimanëve aktualë, e aq më pak e shteteve të sotme ku banojnë muslimanët, në të cilat ka aq pak aplikim të rregullimit hyjnor. Pra, Islami nuk është i Lindjes, por është me burim të pastër qiellor, hyjnor, dhe si i tillë duhet të pranohet.

²⁸ Shih: Ahmet Davutoglu, *Križa globale*, Logos-A, Shkup, 2005.

Po ta pranonte qytetërimi perëndimor Islamin, duke e integruar në të zhvillimin e vet teknologjik dhe intelektual, bota do të lulëzonte nga begatia e do të bëhej paqësore. Pra, pranimi i Islamit nga qytetërimi perëndimor do të ndihmonte në përftimin e paqes globale si fillim paqësor të historisë, e jo si fund të saj. Historia e njerëzimit do të rilidhej me periudhën parakabiliane, pra me një botë pa krim dhe me një vëllazërie unike ku të gjithë njerëzit e kanë statusin si pasardhës legjitimë të Ademit a.s.

Tingëllon utopike? Pa dyshim se po për veshët e atyre që nuk mendojnë dhe që nuk u besojnë mundësive që Allahu ia ka dhënë njeriut, krijesës më të zgjedhur prej Tij. Kjo pra është mundësia e dhënë për njeriun dhe e urdhëruar për njerëzimin nga Allahu, Krijuesi i botëve.

Prishtinë, tetor, 2005

Bibliografia:

1. Ahmet Davutoglu, *Križa globale*, Logos-A, Shkup, 2005.
2. *Bibla*, Drita, Ferizaj, 1994.
3. *Danas*, 20 tetor 2004, www.danas.co.yu
4. Edgar Moren, *Europa në mendje*, Ora, Tiranë, 2001.
5. *Epoka e re*, 7 dhjetor 2001.
6. *Explorer 2*, 20.IX.2005.
7. Grup autorësh, *Arapsko-islamski uticaj na evropsku renesansu*, Sarajevë, 1987.
8. Hasan Ejjub, *Katër kalifët e drejtë*, Furkan-ISM, Shkup, 2003.
9. Homeri, *Iliada*, *Odisea*, Rilindja, Prishtinë.
10. *Hutbeja lamtumirëse*, Zëri Islam, Prizren.
11. *Kur'ani*, përkthim i Sherif Ahmetit, ez-Zehra për Informacionin Arab, 1992.
12. *Letrat e Muhamedit a.s.*, Logos-A, Shkup, 2004.
13. Mark Mazover, *Ballkani: Një histori e shkurtër*, Skanderbeg Books, Tiranë, 2003.
14. Milazim Krasniqi, "Lulja e shpëtimit", Logos A, Shkup, 2004.
15. Milazim Krasniqi, *Meditime Islame*, Furkan ISM, Shkup 2005.

16. Niko Kazanzaqi, “Letërsia e udhëtimeve”, *Shekulli*, 2004
17. Simon Vizental, *Jedro nade*, Beograd, 2003.
18. Shantal Milon Delsol, *Idetë politike në shekullin XX*, Onufri, Shtëpia e Librit, Tiranë, 2000.
19. Vojçeh Zamarovski, *Heronjtë e miteve antike*, Rilindja, Prishtinë, 1985.
20. Zbigniev Brzhezhinski, *Zgjedhja: dominim global apo udhëheqje globale*, përkthim i Adnan Kikës, dorëshkrim.
21. www.danas.co.yu, tetor 2005.

Shënimë biografike

I. Shkollimi:

Milazim Krasniqi u lind më 25 tetor 1955 në Breznicë, një lokalitet afër Prishtinës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa shkollën e mesme të mjekësisë në Prishtinë. Studimet e letërsisë shqipe i kreu në Universitetin e Prishtinës, ku në vitin 1988 magjistroi me temën “Struktura e vargut të Ndre Mjedjes”. Po në Universitetin e Prishtinës e ka marrë gradën e *doktorit të shkencave filologjike* me tezën e disertacionit “Soneti në poezinë shqipe”.

II. Botimet:

Poezi

- 1982 - Imazhi gri
- 1885 - Pirg vegimi
- 1987 - Qeshje sardonike
- 1990 - Formula e Katonit
- 1994 - Kurs për pantomimë
- 1996 - Dalja e atdheut edhe nga ëndrrat
- 2004 – Lulja e shpëtimit, poezi e zgjedhur

Prozë (romane)

1998 - Fijet e shpirtit
2002 - Fotografitë e kujtimeve

Dramaturgji

1990 - Zbulimi,
Mos më merrni në qafë,
Punë Sizifi
1996 - Kur lindi partia,
1997 - Kush i bie fyellit
2001- Bryma e vdekjes
Kosovë në ndërgjegje
2003 - Monedha e Gentit
2004 - Rulet rus për Ali Pashën
2004-1999 Tragjedi shqiptare (trilogji)
Bryma e vdekjes (botim i dytë)
Një Antigonë e re
Kësulkujja e shekujve

Publicistikë

1998 - Horrat në krye të detyrës
2000 - Kosova pas 22 janarit 1998

Studime

2005 - Soneti në poezinë shqipe
2005 - Meditime islame

III. Angazhimi profesional dhe publik

1975-1980: teknik medicinal në Klinikën e Kirurgjisë të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë,

1981-1986: përkthyes po në këtë klinikë,

1987-1990: redaktor i revistës për kulturë *Fjala*,

1988-1999: sekretar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës,

1989: ndër themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës

1990-1995: kryeredaktor i revistës *Fjala*,

1995-1999: redaktor përgjegjës për Kosovë i gazetës ditore *Bota Sot*,

1999-2000: kolumnist i gazetës *Kosova Sot* dhe *Gazeta e Re*

2000-2001: nënkyetar i Partisë Qendra Liberale e Kosovës,

2001-2002: kryeredaktor i revistës *Interesi Nacional*,

2001-2005: anëtar i Bordit të Drejtoreve të Radiotelevizionit të Kosovës

2002-2005: analist te Radio Europa e Lirë,

2003-2005: bashkëpunëtor për lëndën Sociologjia e letërsisë, Publicistika letrare dhe Hyrje në gazetari në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë.

Nga marsi i vitit 2001 është tërhequr tërësisht ngajeta politike.

Jeton në Prishtinë.

Treguesi i emrave:

A

actekët, 94
agnosticizmi, 61, 126
Ahmet Davutoglu, 135
Akron, 101
Al Kaida, 18-20
Aleksandër Dyma, 35
Aleksandri i Madh, 90
Alsajmeri, 111
Andaluzia islame, 28
antisemitizmi, 51
antropologët, 93
antropologjia raciste, 35
argumente politike, 18
argumente hyjnore, 122
ariantistët, 80
Aristoteli, 54
arti antik, 53, 55, 67-9
arti shekspiran, 58
Augusti, 42

B

Bashkimi Sovjetik, 20, 89,
92, 96, 100
Beketi, 61

Bizanti, 24, 30, 80, 89, 91,
93, 96

Bizmarku, 126
bota arabe, 14, 17, 21
bota muslimane, 17, 23

C

çrregullimet psikologjike,
59

D

Dante Aligieri, 50
darwinizmi, 88
defekti psikologjik, 67
defekti anatomik, 130
defekti moral, 130
deformimi moral, 36
deislamizimi, 16
demagogjia, 96
demokracia, 22, 54, 125
demokratizimi, 21
devijimi drastik, 91, 95
devijimi doktrinar, 80
diplomacia, 95
disponimi antiislam, 77
dogma kishtare, 50, 86

doktrina binladeniste, 18
drama antiaristoteliane, 60
dukuria sociopatologjike,
67

Dh

dhunuesi i kohës, 96

E

e drejta romake, 88
Egdar Moren, 57
ekuilibri i frikës, 30
emocionet raciste, 70
epërsia racore, 73
Eskili, 51-4, 57
Europa, 16, 20, 22, 37, 45,
48-50, 56, 70-1, 73,
78-9, 82, 86, 130-1, 134
Europa konservative, 73
Europa kristiane, 16

F

faraoni, 122-6, 125, 126
fashizmi, 37, 51, 71, 81
fatalizmi, 61
feja monoteiste, 85
Fortuini, 77
Franc Ferdinand, 127
Franc Nojman, 75
Françesko Petrarkës, 50
fundamentalizmi islamik,
14, 17
fundamenti politetist, 24

G

Gerhard Armanski, 39, 40
Gilgameshin, 108
gjeopolitika, 14, 23, 89
Gjermania naziste, 89, 96
globalizimi i kulturës, 134
globalizmi, 70, 84

Gj

gjeopolitika, 14, 23, 89
Gjermania naziste, 89, 96

H

Hajderi, 77
Hamleti, 57
Hiroshima, 127
Hitleri, 79, 83, 88, 92, 126
Holokausti, 133
Horaci, 58
humanizmi, 50, 86, 87

I

ideal i deformuar, 95
identiteti islam, 17
ideologjia antihebreje, 79
Iliada, 47, 48
ilirët, 44
iluminimi kulturor, 86
imaginata poetike, 110
imoraliteti, 67, 91
imponimi global, 30
indulgjenca, 56
industria e artit, 63
infantiliteti, 107
inkët, 94

inkuizicioni, 29, 133
inkuizitorët, 81
institucionet politike, 72, 134
intanca artistike, 130
ish-Jugosllavia, 72
Izraeli, 19, 20-1, 26

J
Jul Cezari, 58

K
Kaligula, 44-5
karakteri ateist, 24
Kartagjena, 89, 96, 113-8, 120
katarsis, 54
katedrale, 16
kauza kombëtare arabe, 21
kënaqësia estetike, 61
klisheja ideore, 129
klonimi, 110
kolonizatorët anglezë, 19, 82
kolonizatorët europianë, 19, 73, 94
Komuna e Parisit, 59
komunizmi, 51, 81-2, 86, 99
konceptimi monoteist, 49
Koncili i Nikesë, 80
konflikti dramatik, 61
konvertimi fetar, 81, 92

Krijuesi i botëve, 78, 89, 94, 97, 99, 120-1, 123-4, 126, 136
kriza, 10, 17, 23, 36, 41, 61, 65, 67
kryqëzatat, 29, 50
kryqëzata globale, 17
kryqtarët, 73
kultura kristiane, 57
kultura masive, 41
kultura politeiste, 57
kultura e arenave, 69
kultura e dhunës, 132
Kushtetuta Europiane, 133

L
laicizimi, 59
Le Peni, 77
Legionet romake, 42
Lenini, 92, 121, 124-5, 126
letërsia antike, 49
letërsia dogmatike, 55
liberalizmi, 77
liritë e njeriut, 71
logjika historike, 43
lufta arabo-izraelite, 20
Lufta e Dytë Botërore, 13, 127, 134
Lufta e Ftohtë, 16, 71, 99

M

- Makbethi, 58
Manfred Verner, 111
marksizmi, 37, 86
Martin Luteri, 56
media, 33, 63, 65, 72, 78
mëkat i fillestar, 34-5
mesazhi etik, 61
mesazhi hyjnor, 51, 101,
131
mesazhi hitlerian, 76
mesazhi islam, 19
militarizimi ekstrem, 19
Millosheviqi, 127
Mirna Kostash, 61
misioni qytetërues, 45
mjerimi i globalizuar, 62
modeli kulturor amerikan,
134
modus vivendi, 28
morali i dhunës, 132
Muhamedit a.s., 28, 80-1,
91
mumia, 121-6

N

- nacionalizmi, 19, 20, 75
nacionalizmi panarab, 19
nacional-socializmi, 38
Nagasaki, 127
Napoleoni, 126
narkomania, 67
NATO, 15, 111
ndryshime kulturore, 16

- neokolonializmi, 20, 26
Neroni, 44, 90, 92, 126
Niko Kazanzaqi, 101-2

Nj

- njeriu modern, 60

O

- objekte fetare, 72
Odisea, 47, 48, 137
opinioni publik, 72
organizata terroriste, 19,
21
organizata ambientaliste,
135
Osama bin Ladeni, 15, 18
Othello, 58

P

- Pali, 79
paqja globale, 10, 24, 28,
30, 97, 136
paqja shpirtërore, 66
paranoja, 23
patologjia seksuale, 62
Perandorina e Bizantit, 80
përparimi paqësor, 45
përplasja e qytetërimeve,
13, 17, 29
piramida, 126
Pizoni, 44
poetika, 54
poezia provansale, 50
poezia andaluziane, 49

politika europiane, 70
progresi material, 67
psikanaliza, 35-6, 59
psikologja masive, 71
pushteti ekspansionist, 40
pushtimet romake, 29, 41

Q

qytetërimi islam, 28
qytetërimi postpagan, 67
qytetërimet e vdekura,
113, 120
qytetërimi modern, 129
qytetërimi perëndimor,
10, 13, 23-4, 27, 29, 40,
67-8, 87, 133-6

R

racizmi, 31, 37, 75
reformacioni, 56
regjimi autarkik, 21
Reimer Ditrih, 69
Rekonkuista, 79
relativizimi moral, 50
Rend i Ri Botëror, 84, 97
renesanca europiane, 47,
50
revolucioni totalitar, 83
Revolucioni Bolshevik,
124
revolucioni seksual, 86
revolucioni komunist-
ateist, 124
Rikardi III, 58

rilindja europiane, 56
rivaliteteti fetar, 18
rizgjimi islam, 21
romantizmi europian, 59
Ronald Regani, 99, 100,
105, 111

S

Sadami, 127
Seneka, 90
Simon Vizentali, 81
sjellja patologjike, 66
slogani propagandistik, 29
sociologja pozitiviste, 35,
38
Sofokliu, 52, 54
spastrimi etnik, 15, 72, 76
Stalini, 79, 83, 92, 124
standarde demokratike, 21

Sh

Shekspiri, 57, 63
shkenca humanistike, 126
shpallja universale, 27
Shtetet e Bashkuara të
Amerikës, 18, 21
shtetet mesjetare, 30
shteti islam, 22
shteti-komb, 134

T

teatri i absurdit, 60
teoria materialiste, 41
teoria raciste, 75

terrorizmi, 17-9, 20-1, 26
tjetërsimi, 60
toteme, 129
tragjedia antike greke, 47,
88
Turqia, 16

U

uniteti kulturor, 133
urrejtja racore, 78, 115

V

Variusi, 42
vetërealizimi, 31, 95
Vilhelm Rajh, 71
virusi antiamerikan, 23

vlera morale, 64
vlera islame, 16

Xh

xhihadi, 20
Xhingiskani, 126
Xhorxh Orvell, 71

Z

Zbigniev Brzhezhinski,
23, 83

Zh

zhvillimi linear, 110

■ Dr. Milazim Krasniqi

DHUNA DHE QYTETËRIMI PERËNDIMOR
/Islam si fillim i historisë/.

■ Boton: Logos-A

■ Biblioteka: Lexo

■ Për botuesin: Adnan Ismaili

Kryeredaktor: Husamedin Abazi

Redaktor biblioteke: Dr. Ali Pajaziti

■ Redaktor gjuhësor: Zekeria Ibrahimi

■ Redaktor artistik: Edi Agagjshi

■ Redaktor teknik: Afrim Gashi

■ Mbikëqyrës i shtypit: Imer Gogjufi

Përgatitja kompjuterike: Focus Pro - Shkup

■ Shtypi: Focus -Shkup

■ Copyright©Logos-A, 2006

■ Shënim i CIP katalogut i këtij libri gjendet

në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare

■ ISBN: 9989-58-184-3

■ www.logos-a.com.mk





ISBN 998958184-3

A standard linear barcode is positioned below the ISBN number. The barcode represents the same number: 998958184-3.

9 789989 581847

Copyrighted material